



Instituti
për
politikë
evropiane.
Shkup

KOMITETI I
HELSINKIT
PËR TË DREJTAT E NJERIUT
I REPUBLIKËS SË
MAQEDONË

RRJET

23

RAPORTI NË HIJE PËR KAPITULLIN 23

për periudhën kohore nga muaji maj i vitit 2016 deri në janar të vitit 2018

RAPORTI NË HIJE PËR KAPITULLIN 23

për periudhën kohore nga muaji maj i vitit 2016 deri në janar të vitit 2018

Botues: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë i përfaqësuar nga kryetari, Prof. Dr. Gordan Kallajxhiev

Redaktore:

Dr. Simonida Kacarska
Uranija Pirovska

Autorë:

Mr. Velimir Dellovski
Dr. Ardita Abazi Imeri
Mr. Iva Conevska
Mr. Angella Saplieva

Përktheu (në shqip):

Blerina Starova Zllatku

Përpunimi grafik dhe shtypi:

Relativ

CIP - Katalogizacija vo publikacija
Nacionalna i univerzitetska biblioteka "Св. Климент Охридски", Скопје

342.72/73(497.7)(047)
34.03(497.7)"2015/2016"(047)

RAPORTI në hije për Kapitullin 23 : për periudhën kohore nga muaji maj i vitit 2016 deri në janar të vitit 2018 / [autorë Velimir Dellovski ... и др.]. - Shkup : Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë, 2018. - 79 стр. ; 25 см

Фусноти кон текстот. - Автори: Velimir Dellovski, Ardita Abazi Imeri, Iva Conevska, Angella Saplieva. - Библиографија: стр. 74-77

ISBN 978-608-4790-26-6

1. Delovski, Vellimir [автор] 2. Abazi Imeri, Ardita [автор] 3.
Conevska, Iva [автор] 4. Saplieva, Angella [автор]

а) Човекови права и слободи - Македонија - 2016-2018 - Извештаи б) Судство - Партиски
влијанија - Македонија - 2016-2018 - Извештаи COBISS.MK-ID 106602250

Ky publikim u mundësua me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të projektit "Rrjeti 23+" të cilin e implementon Instituti për Politikë Evropiane (EPI) - Shkup dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Opinionet e prezantuara në këtë publikim janë opinione të autorëve dhe nuk i pasqyrojnë çdoherë opinionet e Bashkimit Evropian.

Lista e Shkurtesave:

- ASHMAA** – Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive
- AKMIS** – Sistemi i automatizuar i informacioneve për administrimin me lëndët gjyqësore
- ARM** - Armata e Republikës së Maqedonisë
- ZAK**- Zgjidhja Alternative e Kontesteve
- AGJPP**- Agjencia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë
- OBRM – PDUNM** - Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitetin Nacional Maqedonas
- LQMM** - Lëvizja Qytetare për Mbrojtjen e Maqedonisë
- GREKO** – Grupi i Shteteve për Luftë Kundër Korrupsionit
- KQZ**- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
- DMDHP** - Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- KSHPK** - Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
- BDI** - Bashkimi Demokratik për Integrim
- KE** - Komisioni Evropian
- KEDNJ** – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- RENAN** - Regjistri Elektronik Nacional i Akteve Normative
- EPI** - Instituti për Politikë Evropiane
- GJEDNJ** – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- BE** – Bashkimi Evropian
- LPP** - Ligji për procedurë penale
- SHGM** - Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë
- LPLLMLD** - Ligji për përcaktimin e llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit
- PRU** – Prioritet e Reformave Urgjente
- PPNKOK** - Prokuroria Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit
- PPRM** - Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë
- KP** – Kodi Penal
- KMD** - Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi
- INK** – Institucioni Ndëshkues Korrektues
- LGBTI** – komuniteti i lesbikeve, gej, biseksual, transgjinnor dhe interseksual

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

MEQR - Maqedonia – BE Qendra e Resurseve

RTVM - Radio-televizioni Maqedonas

MPPS – Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

QNBN - Qendra Ndërkombëtare për Bashkëpunim Ndërkombëtar

PTHP – Prokuroria Themelore Publike

KOA - Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit

RM – Republika e Maqedonisë

SHBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës

LSDM - Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë

PSP – Prokuroria Speciale Publike (Prokuroria Publike për Ndjekjen e Veprave Penale të lidhura dhe të cilat rezultojnë nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve)

KPKDM - Këshilli për Parandalim Kundër Delikuencës së të Miturve

TIM – Transparensi Interneshënëll Maqedoni

DSK - Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim

UFR - Unioni i Forcave të Reja të OBRM – PDUNM

DJSHQ – Sindikata e drejtorisë, jurisprudencës dhe shoqatave të qytetarëve

Përmbajtje:

Hyrje	8
Metodologjia	11
Pasqyra	12
1. Jurisprudenca në udhëkryq	13
U miratua Strategjia e reformës së sektorit të jurisprudencës.....	13
Pavarësia.....	15
Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë midis udhëheqësve dhe të udhëhequrve.....	15
Perceptimi i pavarësisë	15
Pavarësia e jashtme.....	16
Pavarësia e mbrendshme.....	21
Prokuroria Speciale Publike.....	22
Paanshmëria.....	25
Sistemi AKMIS.....	28
Përgjegjësia.....	29
Shkarkimi dhe përcaktim i përgjegjësisë.....	29
Profesionalizmi, kompetenca dhe efikasiteti.....	32
Kualiteti i drejtësisë.....	32
Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë	32
Monitorimi dhe evaluimi i aktiviteteve gjyqësore	33
Praktika gjyqësore	33
Metoda alternative për zgjidhjen e kontesteve	34
Buxheti dhe resurset.....	35
Shërbimi gjyqësor.....	36
Efikasiteti.....	36
Ekzekutimi i aktgjyqimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.....	38
2. Lufta kundër korrupsionit	40
Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.....	42
Konfiskimi i pronës.....	46
Ligji për mbrojtjen e denoncuesve.....	47
3. Të drejtat themelore	49
Të drejtat e njeriut	49
Avokati i Popullit.....	49
Gjykata Kushtetuese si mbrojtëse e lirive dhe të drejtave të njeriut?!	51
Tortura dhe llojet e tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.....	52
Burgjet dhe hapësirat e paraburgimit.....	55
Grupet vulnerable dhe parimi i mosdiskriminimit.....	58
Liria e tubimit dhe shoqërimit.....	62
Liria e shprehjes dhe pluralizmit në media.....	64
E drejta e respektimit të jetës private dhe familjare dhe komunikimeve.....	66
Garanci mbrojtëse procedurale.....	69
E drejta e lirisë dhe sigurisë.....	69
Masa kundër racizmit dhe ksenofobisë dhe gjuhës së urrejtjes.....	70
Krimi nga urrejtja.....	71
Mbrojtja e minoriteteve dhe të drejtave kulturore	72
Mbrojtja e të dhënave personale.....	72
Bibliografia	74
Ueb-faqet e shfrytëzuara:	77
Institucione.....	77
Platforma.....	77
Media.....	77

RAPORTI
NË HIJE PËR
KAPITULLIN 23

për periudhën kohore nga muaji maj i vitit 2016 deri në janar të vitit 2018

Hyrje

Projekti “Rrjeti 23+”, të cilin e implementon Instituti për Politikë Evropiane – Shkup dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, ka për qëllim t’i ofroj një kontribut të strukturuar shoqërisë civile në monitorimin dhe vlerësimin e politikave të përfshira me Kapitullin 23 nga aderimi në BE – Jurisprudenca dhe të drejtat themelore.

Ky raport i bashkon në një tërësi të vetme koherente të gjitha konstatimet, konkluzionet dhe rekomandimet, të cilat rezultuan nga monitorimi i fushave të strukturuar në Kapitullin 23 – Jurisprudenca dhe të drejtat themelore. Në të vërtetë, ky është Raporti i tretë në hije të cilin e publikon “Rrjeti 23”. Dy raportet paraprakë kishin të bëjnë me periudhën kohore tetor 2014 - korrik 2015 dhe korrik 2015 – prill 2016.

Raporti e përfshinë periudhën kohore nga fillimi i muajit maj të vitit 2016, përfundimisht me fundin e muajit janar të vitit 2018. Periudha e përfshirjes së Raportit është vazhduar, në mënyrë që korrespondoj me ciklin e ri të raporteve të Komisionit Evropian, të cilët do të publikohen në muajin mars.

Sipas kësaj, duke e pasur parasysh krizën e gjatë dhe të thellë politike dhe institucionale, në të cilën shteti u fut me publikimin e bisedave të përgjuara nga ana e opozitës së atëhershme, tani në pushtet, e udhëhequr nga Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë, duke filluar nga muaji shkurt i të vitit 2015, periudha kohore e cila është objekt i këtij raporti, në mënyrë të qartë mund të ndahet në tri etapa kryesore, si vijojnë:

- 1) Periudha para mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare më 11 dhjetor të vitit 2016;
- 2) Periudha tranzitore pas mbajtjes së zgjedhjeve, ndërkaq para konstituimit të Qeverisë së re më 31 maj të vitit 2017; si dhe
- 3) Periudha nga zgjedhja e Qeverisë së re deri në fund të muajit janar të vitit 2018.

Nga ana tjetër, hartimi i këtij dokumenti zhvillohej pikërisht në periudhën e fillimit intensiv dhe të përshpejtuar të reformave të paralajmëruara një kohë të gjatë në fushën e sundimit të së drejtës, e që është shënuar me publikimin e Planit qeveritar për reforma, i titulluar si “Plani 3-6-9”,¹ i cili përmban pasqyrë të masave dhe aktiviteteve të domosdoshme prioritare për zbatimin e reformave urgjente demokratike, prezantimin e Propozimit të organizatave qytetare për reformat urgjente demokratike,² si dhe përpilimi dhe miratimi i Strategjisë për reforma në sektorin e jurisprudencës, bashkë me Plan Veprimin shoqëruar për periudhën kohore nga viti 2017 deri në vitin 2022.³ Në mënyrë plotësuese, etapën e fundit të periudhës raportuese e shënoi cikli inkluziv reformues, i cili u iniciua me reformën e jurisprudencës e cila filloi në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, konsultimeve me organizatat qytetare në lidhje me “Planin 3-6-9-“, si dhe konsultimeve me organizatat qytetare në lidhje me Strategjinë për reforma në sektorin e jurisprudencës dhe ndryshimet e zgjidhjeve ligjore.

Mbetet të shihet nëse proceset reformatore do të kontribuojnë për evitimin e mangësive të sistemit, veçanërisht të institucioneve kryesore të jurisprudencës dhe institucioneve të tjera të pavarura dhe trupave rregullatorë, kryerja e drejtë e kompetencave të tyre kushtetuese dhe ligjore janë të një rëndësie cruciale për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Pritshmëritë,

1 Plani është i aksesshëm në: <http://vlada.mk/plan-3-6-9>

2 Propozimi i organizatave qytetare për reforma urgjente demokratike, i aksesshëm në: http://epi.org.mk/docs/Predlog%20IDR_2017.pdf

3 Strategjia është e aksesshme në linkun në vijim: <https://goo.gl/BEPkg5>

nga të gjitha këto aktivitete, kanë të bëjnë me zbatimin esencial të reformave prioritare, sa i përket sundimit të së drejtës, të identifikuar në Raportin inicial të Grupit të Ekspertëve të udhëhequr nga eksperti Rajnhard Pribe nga muaji qershor i vitit 2015,⁴ dhe të riafirmuara në Raportin e tij të dytë nga muaji shtator i vitit 2017.⁵

Fillimi i periudhës së raportimit e shënoi anulimin e vendimeve për abolicion kolektiv nga Presidenti i RM-së, të miratuara më 27 maj të vitit 2016, një precedent i paparë juridik, i cili nuk gjeneroi procedurë për përcaktimin e përgjegjësive të tij. Njëherësh, u gjetën mënyra për pengimin e drejtësisë përmes pamundësisë sistemore të punës së Prokurorisë Publike për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rezultojnë nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve Shkup, e njohur si Prokuroria Speciale Publike (PSP), ritransferimet e gjyqtarëve në Gjykatën Themelore Shkup 1 dhe në Gjykatën Supreme, si dhe përmes një sërë mënyrave të dyshimta të veprimit në rastet e profilit të lartë të korrupsionit dhe abuzimit të autorizimeve zyrtare. Kjo përshtypje, në masë evidente, ndryshoi pas zgjedhjes së Qeverisë së re, pasi që u nënvizua krijimi i një zhvillimi të caktuar pozitiv të gjendjeve në fushën e jurisprudencës.

Nga aspekti i të drejtave të njeriut, problem kryesor mbetet veprimi joadekuat i nëpunësve të autorizuar policorë, duke e pasur parasysh joefikasitetin e Sektorit për Kontroll të Brendshëm, Standarde Profesionale dhe hetime kriminale pranë MPB, si dhe moszbatimin e hetimit efektiv nga Prokuroria Publike në rastet e torturës, trajtimit jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues. Janë për t'u përshëndetur angazhimet e deritanishme nga ana e Këshillit të Evropës, në bashkëpunim me MPB dhe Prokurorinë Publike, përmes projekteve për krijimin e mekanizmit të pavarur të jashtëm për monitorimin e veprimit të paligjshëm policorë dhe përdorimit të tepruar të forcës nga ana e policisë.⁶ Në këtë drejtim, është paralajmëruar se së shpejti në agjendën e Kuvendit do të vendoset pakoja e ndryshimeve ligjore përmes të cilave duhet të sigurohet korniza ligjore për krijimin e këtij mekanizmi.

Veçanërisht shqetëson gjendja me personat e privuar nga liria, të cilët janë vendosur në institucione ndëshkuese-korrektuese dhe edukuese-korrektuese në vend. Avokati i Popullit edhe më tutje vazhdon të konstatoj gjendje të mbipopullimit të institucioneve, gjendje e cila pasqyrohet në ekzistimin e kushteve johumane për vuajtjen e masës së paraburgimit dhe dënimit me burgim.⁷

Në periudhën raportuese nuk është miratuar asnjë aktgjykim nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me të cilin konstatohet shkelja e nenit 3 nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, megjithatë edhe më tutje kemi numër të madh të aktgjykimeve të pa ekzekutuara në të cilat është konstatuar shkelja e nenit 3. Nga gjithsej 11 aktgjykime të këtilla, të miratuara nga ratifikimi i Konventës asnjëri prej tyre nuk është implementuar në tërësi, edhe përkrah paraqitjes periodike të Plan Veprimeve pranë Komitetit të Ministrave kompetent për monitorimin e ekzekutimit të aktgjykimeve nga ana e shteteve - anëtare.

4 Vlerësimi dhe rekomandimet e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë për çështje sistemore në lidhje me sundimin e së drejtës lidhur me ndjekjen e komunikimeve të publikuara në pranverën e vitit 2015.

5 Vlerësimi i rekomandimeve të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë për çështje sistemore në lidhje me sundimin e së drejtës viti 2017, të aksesshëm në: <https://goo.gl/JFhEkH>

6 Përkatesisht, ajo që filloi të zbatohet në kuadër të projektit për mbështetjen e krijimit të mekanizmit mbikëqyrës të jashtëm (<http://www.coe.int/en/web/criminal-law-coop/home-fyrom-oversight>), vazhdon të implementohet përmes projektit për fuqizimin e punës së policisë në fushën e të drejtave të njeriut (<http://www.coe.int/en/web/skopje/enhancing-human-rights-policing>). Të dy projektet realizohen si pjesë të Programit Horizontal të Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë. Më këto projekte është paraparë miratimi i modelit "Prokuroria plus", i cili nënkupton krijimin e një departamenti të posaçëm në kuadër të Prokurorisë Publike, i cili do të vepronte në rastet e veprimit joadekuat policor, me atë që planifikohet formimi i një trupi të posaçëm për mbikëqyrje të jashtme, si instancë e dytë e këtij mekanizmi, trup i cili do të përbëhej nga përfaqësues të organizatave qytetare dhe ekspertëve të fushës.

7 Shih: Raporti vjetor për nivelin e sigurimit të respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, viti 2016, i aksesshëm në: <http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2016/GI-2016.pdf>, f. 51-55.

Mes shkeljeve të numërta të të drejtave të njeriut, të konstatuara nga organizatat vendore, përfshirë këtu edhe Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, për të cilat në mënyrë më të detajuar do të bëjmë fjalë në vazhdim, si diskriminim më evident paraqitet diskriminimi mbi baza të ndryshme, veçanërisht në bazë të gjinisë, seksit, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar, si dhe sa i përket përkatësisë politike dhe partiake dhe bindjes. Në këtë drejtim kontribuon edhe pasiviteti i Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi, e që ka të bëjë edhe me jo-kompetencën të një pjese të anëtarëve të tij. Së këtejmi, edhe më tutje vazhdon prezenca e diskriminimit mbi pjesëtarët e komunitetit LGBTI, veçanërisht duke e pasur parasysh mosndëshkimin e kryerësve të sulmeve mbi Qendrën për mbështetje të LGBTI, të cilët edhe pas më shumë vitesh akoma nuk janë ballafaquar me drejtësinë. Një hap pozitiv janë ndryshimet e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, me të cilët është parashikuar që orientimi seksual të inkorporohet në bazat për diskriminim për çka vite me radhë janë angazhuar një numër i madh i organizatave qytetare.

Liria e shprehjes edhe më tej ishte e rrezikuar përmes sulmeve të shumta mbi gazetarët dhe ekipet gazetareske, me ç'rast të njëjtit u penguan në kryerjen e detyrave të tyre profesionale në interes të publikut. Nga ana tjetër, edhe gjuha e urrejtjes e cila ishte e pranishme në mediat elektronike dhe në ato të shkruara, aq më shumë e shprehur në rrjetet sociale dhe në portalet e Internetit, si edhe në protestat “Për një Maqedoni të lirë” kishte për pasojë një sërë veprash nga urrejtja, kulminacioni i të cilave u përjetua në ngjarjet në ndërtesën e Kuvendit më 27 prill të vitit 2017. Atyre u parapriu edhe nxitja e gjuhës së urrejtjes e manifestuar në të ashtuquajturën “nata e thikave”, disa ditë pas zgjedhjeve të mbajtura parlamentare më 11 dhjetor të vitit 2016, kur një numër i konsiderueshëm i përfaqësuesve të VMRO-DPMNE, në krye të të cilëve ishte kryeministri i atëhershëm Gruevski, me një retorikë të ashpër dhe agresive ndaj oponentëve dhe përfaqësuesve diplomatikë tentuan të ushtrorjnë presion mbi punën e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe ta vënë në dukje kinse instrumentalizimin politik të KSHZ sa i përket rezultatit të zgjedhjeve.⁸

Liria e tubimit u atakua përmes ndalimeve, arrestimeve dhe ndëshkimeve të aktivistëve qytetarë me gjoha të konsiderueshme për kundërvajtje banale të kryera në kontekst të të a.q. “Revolucion i Laramantë”, gjatë manifestimit të pakënaqësisë së tyre nga pushteti dhe kërkimit të dorëheqjes së Presidentit Ivanov, menjëherë pas miratimit të vendimit të tij për amnisti kolektive në pranverën e vitit 2016.

Nga ana tjetër, më 28 nëntor të vitit 2017 u bë ndalimi i një grupi prej 36 personave, me ç'rast shqetësim serioz sa i përket ligjshmërisë së ndalimit dhe arrestimit të disa deputetëve nga këndvështrimi i respektimit të procedurave përkatëse ligjore, që kanë të bëjnë me imunitetin e tyre, publikisht manifestoi edhe Avokati i Popullit.⁹

Liria e bashkimit u pengua në mënyrë esenciale përmes përpjekjeve për tua mbyll gojën organizatave qytetare mendjehapura, të cilat erdhën në shprehje pas paralajmërimeve për të a.q. “desoroizim” nga përfaqësuesit më të lartë të pushtetit shtetërorë në muajt e fundit të vitit 2016. Kjo, për pasojë kishte kontrole intensive financiare nga Drejtoria e të Ardhurave Publike, me urdhër të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nga muaji dhjetor i vitit 2016 deri në maj të vitit 2017, e që u orkestruan ndaj 22 organizatave qytetare. Edhe pse të njëjtat nuk rezultuan me konstatime për keqpërdorime gjatë punës financiare, procedurat e ngritura pranë organeve të prokurorisë publike, zyrtarisht akoma nuk kanë përfunduar e që e vë në pikëpyetje sigurinë juridike gjatë punës së tyre.¹⁰

8 <http://a1on.mk/archives/681770>, i aksesshëm më datë 17.12.2016

9 Materiale për kërkesat për përcaktimin e paraburgimit, të aksesshme në: <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=2f6ebb9c-af48-459f-8489-265b77153355>

10 Kjo u theksua nga përfaqësuesit e më shumë organizatave qytetare, të cilat morën pjesë aktive në punën e Fokus Grupit, i cili u realizua më datë 15 shtator të vitit 2017 për qëllimet e përgatitjes së këtij dokumenti.

Krahas procedurave rrjedhëse të iniciuara nga PSP, lufta kundër korrupsionit edhe më tutje është në nivel mjaft të ulët, e që manifestohet përmes tendencës së vazhdueshme të papërgjegjësisë dhe pa-ndëshkueshmërisë së bartësve të funksioneve publike, zbatimit joefikas të konfiskimit dhe implementimit të dobët të Ligjit për denoncuesit, si dhe moskryerja e kompetencave ligjore nga ana e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Ky Raport është një kontribut i organizatave qytetare në adresimin e dobësive sistemore në fushat e domenit të Kapitullit 23 dhe përcaktimin e rekomandimeve në lidhje me drejtimit kryesore në të cilët duhet të zhvillohen ndërhyrjet e iniciuara reformatore.

Metodologjia

Gjatë hartimit të këtij Raporti u zbatua metodologjia e monitorimit të fushave të cilat janë në fokusin e punës së “Rrjetit 23” – Jurisprudenca, Lufta kundër korrupsionit dhe të Drejtat themelore, e hartuar në vitin 2015 dhe tanimë e aplikuar në raportet paraprake. Ajo e përfshiu hulumtimin e burimeve zyrtare të institucioneve shtetërore dhe të jurisprudentës, analizën e raportimit mediatik për raste të veçanta në këto fusha në periudhën në fjalë, prezantuar me analiza të numërta dhe përmes brifingjeve mujore të përgatitura nga shoqatat qytetare që janë pjesë të projektit “Rrjeti 23+”, shfrytëzimit të qasjes së lirë deri te informacionet me karakter publik deri te institucionet relevante, si dhe organizimit të debateve në kuadër të target grupit me shoqata të qytetarëve, të cilat punojnë në këto fusha dhe punëtori ekspertë tematike me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe shoqatave qytetare, analizë dhe përpunim të të dhënave të fituara.

Target grupi kishte për qëllim t’i përfshij shoqatat relevante qytetare, të cilat punojnë në fushat e Kapitullit 23, me qëllim që përmes debatit të hapur dhe efektiv të shkëmbehen njohuri sa u përket gjendjeve nga përvoja e tyre të punës shumëvjeçare në këto fusha, ndërsa konstatimet e tyre ta gjejnë vendin përkatës në këtë Raport.¹¹

Punëtorja tematike e ekspertëve mundësoi të fitohet një kontribut i konsiderueshëm dhe esencial të përfaqësuesve të institucioneve relevante shtetërore dhe të jurisprudentës në finalizimin e këtij dokumenti, ndërsa një pjesë e vërejtjeve të tyre në draft-dokumentin inicial janë inkorporuar në këtë Raport në hije. Përveç përfaqësuesve të Transparensi Interneshënëll Makedonia, Institutit për të Drejtat e Njeriut dhe Koalicionit “Të gjithë për gjykim të drejtë” punëtorja përfshiu edhe përfaqësues nga Gjykata Supreme, nga Këshilli i Prokurorëve Publikë, nga Prokuroria Speciale Publike, nga Ministria e Drejtësisë, Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe nga Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.¹²

Nga ana tjetër, kontributi i ekspertëve nga administrata shtetërore dhe jurisprudenca u mundësua përmes adresimit të kërkesave për dërgimin e informacioneve me karakter publik deri tek të gjitha gjykatat themelore dhe prokuroritë publike, deri te Gjykata Supreme, Gjykata Administrative, Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Buxhetor Gjyqësor, Avokati i Popullit, Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio Vizuale, Komisioni Shtetëror për

11 Diskutimi në Fokus Grupin të datës 15 shtator 2017 u zhvillua pas përgatitjes paraprake të pyetësorit nga autorët e raportit, në kuadër të të cilit morën pjesë përfaqësuesit e shoqatave të qytetarëve, si vijojnë: Instituti për të Drejtat e Njeriut, Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë”, Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj, Qendra për Hulumtime dhe Analiza Juridike, Fondacioni Shoqëria e Hapur Maqedoni, Transparensi Interneshënëll Maqedoni, Transparencë Maqedoni, Fondacioni Metamorfozis, si dhe Shoqata Qendra për Strategji dhe Zhvillim “PAKTIS” nga Prilepi.

12 Në mënyrë plotësuese, me kontributin e vet, në punëtorinë e cila u mbajt më 7 shkurt 2018 u përfshi Dr. Millka Ristova, ish-gjyqtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë në pension.

Parandalimin e Korrupsionit, Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve, Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë. Numri më i madh i institucioneve u përgjigjën pozitivisht dhe i dërguan përgjigjet e tyre ndaj pyetjeve të parashtruara, me ç'rast dhanë një kontribut të çmuar në drejtim të hartimit të këtij Raporti.

Pasqyra

Vlen të theksohet se në mesin e numrit të madh të drejtimeve të pranuar strategjike janë edhe ato që janë pjesë përbërëse të “Propozimit të organizatave qytetare për reforma urgjente demokratike” (i njohur si dokument Blueprint)¹³ dhe në të janë inkorporuar qëllimet prioritare, masat dhe aktivitetet për 3, 6, 9 dhe 12 muajt e ardhshëm në një sërë fushash, duke e përfshirë këtu edhe jurisprudencën, luftën kundër korrupsionit dhe mediat, me ç'rast ai paraqet mbindërtim të dokumentit të atillë iniciues i përpiluar në korrik të vitit 2016. Ai u prezantua publikisht më datë 19 korrik 2017, me ç'rast Qeverisë iu sugjerua nevoja e përfshirjes së plotë të sektorit civil në reformat e mëtutjeshme të jurisprudencës.

Konstatimet nga Raporti i Grupit të Ekspertëve të udhëhequr nga eksperti Rajnhard Pribe nga muaji qershor i vitit 2015,¹⁴ në masë të madhe u afirmuan në Raportin e dytë, i cili ofron vlerësim plotësues dhe rekomandime, si dhe drejtime konkrete për proceset reformatore.¹⁵ Konstatimet dhe konkluzionet e raportit të dytë u prezantuan në gjysmën e dytë të muajit shtator të vitit 2017 pasi që në mesin e muajit korrik të vitit 2017, Pribe, bashkë me ekipin e tij të ekspertëve, realizoi edhe një vizitë në Republikën e Maqedonisë, me qëllim që të njoftohet me progresin në lidhje me Raportin e tij fillestar në fushën e jurisprudencës. Ajo që kryesisht qëndron si konkluzion në Raportin e dytë të Pribe-s konsiston me atë se akoma është evident jofunksionaliteti i institucioneve kryesore shtetërore dhe të jurisprudencës në një masë me të cilën pamundësohet zbatimi konsekuent i ligjeve dhe kompetencave ligjore.¹⁶

13 Ky dokument u përgatit nga më shumë organizata qytetare dhe ekspertë gjatë një procesi inkluziv, në të cilin morën pjesë gjithsej 146 persona, përkatësisht 73 organizata qytetare, i aksesshëm në: http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/2375/Blueprint_2017_MK-01.pdf.

14 Rekomandimet e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë për çështje sistemore në lidhje me sundimin e së drejtës sa i përket ndjekjes së komunikimeve të publikuara në pranverën e vitit 2015.

15 Vlerësimi dhe rekomandimet e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë për çështje sistemore në lidhje me sundimin e së drejtës 2017, të aksesshme në: <https://goo.gl/JFhEKH>

16 Instituti për Politikë Evropiane (EPI) në kontinuitet e ndjek statusin e përbushjes së Prioriteteve të Reformave Urgjente. Shih më shumë për statusin e plotësimit të PRU përfundimisht me muajin nëntor 2017 <http://www.merc.org.mk/status-na-realizacija-na-itni-reformski-prioriteti>

1

Jurisprudenca në udhëkryq

Nevoja për reforma në sektorin e jurisprudencës, në mënyrë të pakontestueshme, është përcaktuar në Raportin e parë dhe të dytë të Grupit të Ekspertëve të udhëhequr nga Pribe si dhe nga Prioritetet e Reformave Urgjente të përcaktuara nga ana e Komisionit Evropian. Një indikator plotësues për nevojën e reformës është edhe anketa e zbatuar në kuadër të projektit “Rrjeti 23+” sipas së cilës 47% e banorëve të RM-së konsiderojnë se situata me jurisprudencën është e keqe.¹⁷ Nga ana tjetër, Gjyqësori, Prokuroria Publike, Këshilli Gjyqësor i RM-së dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë i RM-së vlerësohen si institucione të cilat janë të varura, të njëanshme dhe joprofesionale.

Pas ngecjes dhe kthimit pas në këtë fushë, Qeveria e re filloi me aktivitete në drejtim të zbatimit të proceseve reformuese në pjesën e jurisprudencës, të përcaktuara me planin 3-6-9.¹⁸

U miratua Strategjia e reformës së sektorit të jurisprudencës

Në nëntor të vitit 2017 Qeveria e miratoi Strategjinë për reforma në sistemin e jurisprudencës për periudhën kohore të vitit 2017-2022 bashkë me Planin e Veprimit,¹⁹ përmes së cilës e njëjta duhet të operacionalizohet, pasi që e njëjta, tre herë radhazi, u dërgua për mendim dhe për konsultim me ekspertë në Bruksel.²⁰

Puna e kësaj Strategjie u ndërpre në verën e vitit 2017 kur pas një ndërprerje të gjatë dhe kthim pas në këtë fushë, në korrik të vitit 2017 ministri i Drejtësisë formoi Këshill për reforma në sektorin e jurisprudencës i përbërë nga përfaqësues të gjykatave dhe prokurorive, profesorë universitarë, ekspertë juridikë dhe nga përfaqësues të sektorit civil. Me këtë, Qeveria e re filloi me aktivitete në drejtim të zbatimit të proceseve reformatore në pjesën e jurisprudencës, të përcaktuara në planin “3-6-9” i cili përmban një sërë të masave kryesore dhe drejtime të përgjithshme në fushën e jurisprudencës, dhe më pas të përpunuara me Strategjinë.²¹

17 Më shumë për anketën, shih në: http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/public_opinion_24_04_17/Istrazuvanje-na-javno-mislenje-poglavje-23-kratka-verzija.pdf

18 Planin “3-6-9” më në detaje mund ta shfletoni në ueb faqen e Qeverisë së RM-së, ku është i aksesshë linku në vijim: <http://vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/Plan%203-6-9%20MKD.pdf>

19 Njoftimi i Ministrisë së Drejtësisë: http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1410

20 Tekstin e plotë të këtij dokumenti mund ta gjeni në këtë link: <https://goo.gl/SGLRxq>

21 Planin “3-6-9” parashikon zvogëlimin e presioneve politike mbi gjyqtarët dhe Këshillit Gjyqësor, ndryshime në Ligjin për gjykatat, shfuqizimin e Ligjit për përcaktimin e fakteve dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, si dhe transferimi i kompetencave të tij mbi Këshillin Gjyqësor përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor. Njëherësh, përmendet edhe përgatitja e një propozim Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe formimi i Grupit të Punës i cili do t’i shqyrtoj rekomandimet e Komisionit të Venecias lidhur me Ligjin për mbrojtjen e privatësisë. Ky plan e përcakton konstituimin e Këshillit për Reforma të Sektorit të Jurisprudencës dhe i parapriu formimit të Grupit të Punës për revidimin e draft-Strategjisë për reforma në sektorin e jurisprudencës, i cili gjithashtu ishte parashikuar në mënyrë eksplicite në këtë Plan.

Procesi i hartimit të Strategjisë ishte transparent dhe u zbatua me konsultime intensive me organizatat qytetare të cilat punojnë në pjesën e jurisprudencës. Si rezultat i kësaj, një pjesë e vërejtjeve dhe propozimeve të organizatave qytetare u morën në konsideratë dhe u inkorporuan në Strategjinë dhe në Planin e Veprimit, ndërsa një pjesë e tyre gradualisht u inkorporuan në zgjidhjet e reja ligjore.²²

Puna e Këshillit u shoqërua me një sërë mospajtimesh nga ana e anëtarëve, dhe si rezultat i kësaj pasuan dorëheqje të disa profesorëve universitarë të cilët kishin vërejtje se punët zhvilloheshin në mënyrë burokratike. Në janar të vitit 2018²³ u krijua Këshilli për monitorimin e implementimit të Strategjisë për reforma në jurisprudencë, me të cilin do të kryesoj kryeministri Zoran Zaev, ndërsa si anëtarë do të jenë kryetari i Gjykatës Supreme, kryetari i Gjykatës së Apelit në Shkup, kryetari i Gjykatës Themelore Shkup 1, si dhe Prokurori Publik i RM-së dhe Prokurorja Speciale Publike. Kjo përbërje shkaktoi reagime të vullshme në publik, veçanërisht për shkak të lidhjes së një pjese të anëtarëve të këtij Këshilli me pushtetin paraprak.

Miratimi i Strategjisë për reforma në sektorin e jurisprudencës 2018-2022 përmes një procesi intensiv dhe inkluziv të konsultimeve të praktikantëve juridikë, ekspertëve juridikë, ekspertëve evropian dhe përfaqësuesve të sektorit civil është një hap pozitiv në drejtim të detektimit të nevojave dhe mangësive reale në sektorin e jurisprudencës dhe në gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme.

Me paralajmërimin për krijimin e Këshillit të ri për monitorimin e implementimit të Strategjisë për reformat në sektorin e jurisprudencës, Qeveria manifeston përkushtim për zbatimin e reformave në jurisprudencë. Megjithatë, nevojitet transparencë më e madhe dhe inkluzivitet gjatë formimit të tij, me qëllim që Këshilli të mos vijë në situatë të raportit pushteti ekzekutiv-pushteti gjyqësor. Nevojitet përfshirja e më shumë palëve të interesuara, para së gjithash, të institucioneve të përfshira në Strategjinë në mënyrë që të perceptohen mendimet e ndryshme dhe t'u jepet rëndësia dhe relevanca e reformave në fjalë. Në mënyrë plotësuese duhet të përfshihen përfaqësuesit e Dhomës Ligjvënëse.

Do të jetë e nevojshme që sektori civil të përfshihet në monitorimin e vazhdueshëm të implementimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, në mënyrë që të arrihet implementimi i tyre konsekuent, në përputhje me qëllimet dhe drejtimet paraprakisht të përcaktuara strategjike.

22 Propozimet e Institutit për Politikë Evropiane janë të aksesshme në linkun në vijim: http://www.epi.org.mk/docs/EPI_StrategjiaPravosudstvo_public.pdf

23 Komunikatë e portalit Gjyqësori, e aksesshme në 23.01.2018 r. <https://goo.gl/EXmvh2>

Pavarësia

■ Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë midis udhëheqësve dhe të udhëhequrve

Funksionimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë edhe më tej ishte problematik, kështu që me arsye shtrohet pyetja nëse ata vërtetë e kanë rolin e mbrojtësve të integritetit dhe pavarësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve, apo përmes veprimit të tyre praktik u transformuan në instrument të politikanëve të fuqishëm.²⁴

Në periudhën raportuese u bë edhe zgjedhja e kryetarëve të rinj të këtyre trupave. Përkatësisht, kryetari i Këshillit Gjyqësor, Zoran Karaxhovski, u zgjodh në rrethin e dytë të votimit në prill të vitit 2016. Petar Anevski, për herë të dytë u zgjodh në muajin shtator të vitit 2016 edhe përkrah vërejtjeve nga ana e sektorit qytetar sipas të cilëve ligji nuk lejon rizgjedhje,²⁵ ndërsa më 29 gusht të vitit 2017 dha dorëheqje nga pozita për shkaqe personale dhe familjare, me ç'rast në vendin e tij u zgjodh Kole Shteriev. Diskutabile është zgjedhja e anëtarëve të këshillave dhe kualiteti i kandidatëve të përzgjedhur, dhe veçanërisht zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga radhët e “juristëve të shquar” duke e pasur parasysh atë se nga biografitë e tyre nuk mund të fitohet përshtypje se a i kanë plotësuar të gjitha elementet e “juristit të shquar”.²⁶

Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë deri në ndërrimin e pushtetit, në mesin e vitit 2017, morën qëndrim kritik ndaj Prokurorisë Speciale Publike. Kryetari i Këshillit Gjyqësor, Karaxhovski, në tetor të vitit 2016, e gjykoj dhe e vlerësoi si të kundërligjshme thirrjen e pesë gjyqtarëve nga Gjykata Administrative në seancë dëgjimore në cilësinë e personave të pandehur nga ana e PSP. Ai u bëri apel të gjitha subjekteve të involvuara të përmbahen për çfarëdo lloj tentativash për rrezikimin e pozitës dhe rolit të tyre në ndarjen e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.²⁷

■ Perceptimi i pavarësisë

Anketat relevante të opinionit publik, të realizuara nga subjekte të ndryshme, përfshirë këtu edhe organizatat qytetare, dëshmojnë mosbesim të madh të qytetarëve ndaj gjyqësorit. Së këtejmi, sipas të dhënave nga anketa e opinionit publik, të cilën e zbatoi “Rrjeti 23+”, brenda periudhës kohore 11.01.2017 – 06.02.2017, madje 50% e të anketuarve janë të mendimit se gjyqësori në Republikën e Maqedonisë nuk i plotëson standardet për integrim në Bashkimin Evropian, ndërsa 47% e të anketuarve punën e gjyqësorit e vlerësojnë si të keqe. Nga ana tjetër, si pengesë më të madhe për pengimin e reformave, 31% e qytetarëve e theksojnë korrupsionin në gjyqësor. Sipas hulumtimit, 65% e të anketuarve janë të mendimit se organizatat qytetare duhet të marrin pjesë në reformat e gjyqësorit.²⁸ Veçanërisht është interesant se hulumtimi tregoi besim më të madh të qytetarëve ndaj policisë, sesa ndaj organeve të sistemit të jurispruencës e që vetvetiu flet për perceptimin e jurispruencës nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë.

24 Vërejtje të rëndësishme për punën e Këshillit Gjyqësor janë përfshirë edhe në Raportin numër 1 për periudhën kohore nga nëntori 2016 deri në janar të vitit 2017, publikuar nga ana e Institutit për të Drejtat e Njeriut, i cili është i aksesshëm në: [http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04763/mk/IHR-lzvestaj-01-\(web\)-MK.pdf](http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04763/mk/IHR-lzvestaj-01-(web)-MK.pdf)

25 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut reagoi ashpër për këtë zgjedhje.

26 Raporti i parë i Monitorimit “Reforma në gjyqësor – nga Pribe 1 deri në Pribe 2 dhe më pas”, f. 5, i aksesshëm në: <https://goo.gl/Bqq7P6>

27 Komunikatë e Këshillit Gjyqësor, e aksesshme në: <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=464> (e aksesshme nga data 15.10.2016)

28 Hulumtimi u zbatua në modelin prej 1200 të anketuarve, përmes anketës telefonike. Të gjitha rezultatet e këtij hulumtimi janë të aksesshme në linkun në vijim: http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/public_opinion_24_04_17/Istrazuvanje-na-javno-mislenje-poglavje23-celosno.pdf

Hulumtimi i fundit, i cili u zbatua mbi gjithsej 288 të anketuar, të punësuar në administratën shtetërore dhe në gjyqësor, të cilët punojnë në fushën e Kapitullit 23, përmes punës në terren brenda periudhës kohore 12.10.2017 dhe 13.12.2017 tregoi se madje 80% e të anketuarve besojnë se organizatat qytetare duhet të marrin pjesë në procesin e reformave, ndërsa 47% e tyre janë të mendimit se institucionet kanë kapacitete që t'i realizojnë reformat. Vetëm 11% theksojnë se gjendja e përgjithshme në sektorin e jurisprudencës është e mirë, ndërsa 54% e qytetarëve gjendjen e vlerësojnë si të keqe. 62% janë të mendimit se qytetarët nuk kanë besim në sistemin e jurisprudencës, ndërsa më shumë se gjysma e të anketuarve theksuan se zvogëlimi i ndikimit të pushtetit ekzekutiv mbi pushtetin gjyqësor (55%), përkatësisht rritja e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatave (53%) janë mënyrat më përkatëse të cilat do të ndihmonin në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj jurisprudencës. Një indikator pozitiv nga ky hulumtim është se madje 69% e të anketuarve pajtohen se reformat e propozuara nga BE janë adekuate dhe të aplikueshme.

Nga ana tjetër, nga analiza e proceseve të monitoruara gjyqësore e realizuar nga Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë” rezultoi konkluzioni për mbështetje evidente ndaj numrit më të madh të standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë, duke i përfshirë edhe ato të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me përjashtime të vogla dhe me mundës për përmirësime të mëtejshme.²⁹

■ Pavarësia e jashtme

Niveli i ulët i pakënaqshëm i pavarësisë së gjyqësorit nga lidhjet politike dhe lidhjet e tjera, nënvizuar në shumë raporte dhe analiza të organizatave qytetare, të cilat janë pjesë të projektit “Rrjeti 23+”, vazhdoi t'i karakterizoj gjendjet e përgjithshme në fushën e jurisprudencës gjatë gjithë periudhës kohore të raportit. Në Raportin e dytë të Grupit të Ekspertëve, të udhëhequr nga Pribe edhe një herë u theksua se është ndërprerë kontrolli dhe keqpërdorimi i sistemit të jurisprudencës nga një numër i vogël i gjyqtarëve në pozita të fuqishme, të cilët edhe më tutje kanë vazhduar të ushtrojnë presione mbi kolegët e tyre më të rinj dhe të njëjtit, përmes fuqisë së tyre i kanë emëruar, vlerësuar, disiplinuar dhe shkarkuar kolegët e tyre nga pozitat më të ulëta ndaj të cilëve ushtrojnë presion për shkak të realizimit të qëllimeve të caktuara politike.³⁰

Hapa konkret për përforcimin e pavarësisë së jurisprudencës u ndërmorën me procesin e përgatitjes së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor³¹, i cili filloi me formimin e Grupit të Punës³² me vendim të ministrit të Drejtësisë nga data 31.08.2017.³³ Ndryshimet e propozuara ligjore janë në drejtim të përmbushjes së Prioritetëve të Reformave Urgjente dhe në drejtim të rekomandimeve të përfshira në raportet e Pribe-s që u publikuan në ENER në muajin janar të vitit 2018.

Ndryshimet e Ligjit për gjykata më së shumti kanë të bëjnë me bazat e përgjegjesisë disiplinore, masat disiplinore dhe ndryshimet sa u përket kritereve për hyrje në gjyqësor. Ndryshimet e Ligjit për Këshillin Gjyqësor kanë të bëjnë me procedurën për përgjegjësi disiplinore dhe me vlerësimin e gjyqtarëve përmes inkorporimit të kritereve kualitative për vlerësimin e gjyqtarëve. Megjithatë, një

29 Analiza e plotë, e cila më së shumti fokusohet mbi të drejtën e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit, parimin e gjykimit në afat të arsyeshëm, publikun, prezumimin e pafajësisë, armët e barabarta, respektimin e të drejtave minimale të mbrojtjes, si dhe mbi të drejtën e ankesës, e aksesshme në: http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Megunarodni-standardi_fer-i-pravico-sudenje.pdf

30 Vlerësimi dhe rekomandimet e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë për çështje sistimore në lidhje me sundimin e së drejtës viti 2017, të aksesshme në: <https://goo.gl/JFhEkH>

31 Ndryshimet e Ligjit për Këshillin Gjyqësor, filluan në fillim të muajit gusht 2017 me formimin e Grupit të Punës, i cili do të punojë në këto ndryshime dhe në përgatitjen e Ligjit për ndërprerjen e vlefshmërisë së Ligjit për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Hapjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjesisë së Gjyqtarit. Shih më shumë në: <https://goo.gl/KPQrWX>

32 Në Grupin e Punës morën pjesë përfaqësues të kastës së gjyqtarëve, Këshilli Gjyqësor, përfaqësues të organizatave joqeveritare. Përfaqësuesi i EPI gjithashtu mori pjesë në Grupin e Punës.

33 Pasqyrë faktografike e statusit të implementimit të masave të parapara në Planin 3-6-9 përfundimisht me datë 15.11.2017, f. 11, e aksesshme në: <https://goo.gl/KPQrWX>

pjesë e organizatave qytetare dhe të publikut profesionist janë të mendimit se nevojitet precizim shtesë, sa u përket bazave për përgjegjësinë e gjyqtarëve, si dhe riprecizimin e kriterëve kualitativë për vlerësimin e gjyqtarëve, para së gjithash, edhe sa i përket kompleksitetit të lëndëve, si dhe duke i pasur parasysh kriteret për zgjedhjen e gjyqtarit në gjykatë më të lartë të specifikuar në nenin 41 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor gjatë vlerësimit të gjyqtarëve. Në mënyrë plotësuese nevojitet të bëhet riprecizimi i profesionalizmit të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, përkatësisht precizimi i kriterëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dhe përkufizimi i nocionit "jurist i shquar". Nevojiten të bëhen edhe ndryshime ligjore, sa i përket inkorporimit të përgjegjësisë së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, përkatësisht të Këshillit të Prokurorëve Publikë.

Sa i përket zgjedhjet së prokurorëve publikë është bërë diskrepancë të kushteve të cilat duhet t'i përmbush Prokurori Publik i RM-së dhe Prokurori Publik në Prokurorinë e Lartë Publike, për të cilët nuk nevojitet të kenë stazh pune si prokuror publik me rezultate të konfirmuara gjatë punës.³⁴

Zgjedhja dhe avancimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë

Gjatë vitit 2016 dhe 2017, Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë vazhduan të zgjedhin gjyqtarë, përkatësisht prokurorë publikë pa kurrfarë ndryshimesh esenciale në mënyrën e përzgjedhjes. Zgjedhja e gjyqtarëve kryesisht zhvillohej pa debat përmbajtjesor, me prezantim shumë të shkurtër të biografisë së kandidatëve dhe pa arsytim për (mos) zgjedhjen e kandidatëve me numër më të madh të pikëve ose me numër të njëjtë të pikëve.³⁵ Gjithashtu, kishte kritika edhe sa u përket transferimeve të përkohshme të gjyqtarëve në gjykatat e tjera, ashtu siç ishte vendimi i Këshillit Gjyqësor nga muaji nëntor i vitit 2016 për transferimin e përkohshëm për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të 5 gjyqtarëve nga qytete të tjera në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup.³⁶ Më së shpeshti, gjyqtarë të njëjtë përkohësisht janë transferuar më shumë herë.³⁷ Kritika plotësuese kishte edhe për mënyrën e avancimit të gjyqtarëve, si dhe për zgjedhjen e kryetarëve të tyre.³⁸ Reagim të ashpër kishte edhe Këshilli Drejtues i Shoqatës së Gjyqtarëve i cili i bëri thirrje Këshillit Gjyqësor të RM-së t'i respektojë normat ligjore dhe parimet e vendosura gjatë zgjedhjes dhe avancimit të gjyqtarëve, si dhe t'i arsyetojë vendimet e miratuara me qëllim të transparencës më të madhe gjatë punës së Këshillit.³⁹

Për shkak të skadimit të mandatit të kryetarëve të Gjykatës Supreme, Gjykatës Themelore Shkup 1 dhe Gjykata Themelore në Gjevgjeli, Këshilli Gjyqësor në fund të vitit 2016 e filloi procedurën për zgjedhjen e kryetarëve të rinj. Për shkak të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 11 dhjetorit të vitit 2016, u emëruan vetëm kryetarë UD, zgjedhja e të cilëve nga Këshilli Gjyqësor u shoqërua me kritika të konsiderueshme nga publiku profesionist dhe nga kasta e gjyqtarëve. Me praktikat e këtilla, u vunë në pikëpyetje parimet themelore të veprimit të Këshillit Gjyqësor si institucion i pavarur.⁴⁰

34 Ekzistojnë mendime në publikun ekspert në të cilat theksohet nevoja e ndryshimit të kësaj zgjidhjeje.

35 Raporti i parë i monitorimit "Reformat në gjyqësor – nga PRIBE 1 deri në Pribë 2" dhe më pas, f. 1, i aksesshëm në: <https://goo.gl/Bqq7P6>

36 Njoftim i Këshillit Gjyqësor, <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=466>, i aksesshëm 28.11.2016.

37 Raporti i parë i monitorimit "Reformat në gjyqësor – nga PRIBE 1 deri në Pribë 2" dhe më pas, f. 1, i aksesshëm në <https://goo.gl/Bqq7P6>

38 Deklaratat e gjyqtarëve dhënë në emisionin "360 shkallë" <http://360stepeni.mk/article/454/unapredovanje-po-zasluzgi-ili-po-nekoe-novo-tefterche>

39 Reagimi i Këshillit Drejtues të Shoqatës së Gjyqtarëve, i aksesshëm në: <http://www.akademik.mk/uo-na-zdruzhenieto-na-sudii-sudskiot-sovet-da-gj-pochituva-zakonskite-normi-pri-izborot-i-unapredovaneto-na-sudiite/>

40 Këto konstatime të Institutit për Politikë Evropiane (EPI) janë përfshirë në brifingun e tij të titulluar si "Statusi i Prioritetëve të Reformave Urgjente" të datës 30 maj 2017, të aksesshëm në http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04771/mk/Status-na-ltni-reformski-prioriteti_Maj2017_MK.pdf, si dhe në dokumentin "Raporti i Pribë dy vjet më vonë: Qeveri e re dhe mundësi të reja për zgjidhjen e problemeve të vjetra", f. 3 http://epi.org.mk/docs/1.%20Izvestajot%20na%20Pribë%20dve%20godini%20potoa_MK.pdf.

Së këtejmi, në mbledhjen e 240-të në dhjetor të vitit 2016, Këshilli Gjyqësor për kryetar UD të Gjykatës Supreme e zgjodhi Snezhana Bajlozova, e cila ishte gjyqtare në Gjykatën Supreme vetëm dy muaj në bazë të rezultateve nga vlerësimi i saj gjatë kohës kur ishte gjyqtare e Gjykatës së Apelit Shkup. Në mbledhjen e 248-të të Këshillit Gjyqësor, në mars të vitit 2017 për kryetar të ri – të vjetër të Gjykatës Supreme u zgjodh gjyqtari Jovo Vangelovski,⁴¹ që shkaktoi kundërshtime të mëdha duke e pasur parasysh faktin se në bisedat e përgjuara, Vangelovski bisedonte për kompletimin e dokumenteve gjyqësore me ish ministrin e Transportit dhe Lidhjeve në lidhje me lëndën “Global” në të cilën i dyshuari i parë ishte lideri i LSDM Zoran Zaevi.

Gjatë zgjedhjes së Stojançe Ribarev për gjyqtar UD në Gjykatën Themelore Shkup 1 kontestues ishte fakti se ai erdhi nga Gjykata Supreme ku ishte zgjedhur në muajin shtator të vitit 2016, me ç’rast dominoi mendimi se nuk ekziston bazë ligjore për zgjedhjen e tij. Zgjedhja e tij u bë pas dorëheqjes së Tatjana Mihajlova, e që u shkaktua edhe nga reagimet e gjyqtarëve në lidhje me kalendarin e ri vjetor të gjyqësorit.

Pas përfundimit të zgjedhjeve lokale, në nëntor të vitit 2017, pasoi zgjedhja e re e kryetarëve të gjykatave, e cila la hapësirë për dyshime nëse gjyqësori përfundimisht është çliruar nga prangat e pushtetit ekzekutiv. Në mbledhjen e 266-të, Këshilli Gjyqësor mori vendim për zgjedhjen e gjyqtarit Ivan Gjolev për kryetar të ri të Gjykatës Themelore Shkup 1.⁴² Në mbledhjen e radhës, të 267-të, Këshilli miratoi vendime për zgjedhjen e kryetarëve të rinj të Gjykatës së Apelit në Shtip, si dhe të gjykatave themelore në Kumanovë, Tetovë dhe Resnjë, ndërsa kandidati për kryetar të ri të Gjykatës Themelore Dibër nuk e fitoi shumicën e nevojshme të votave nga ana e Këshillit.⁴³

Zgjedhja e gjyqtarëve në gjykatat më të larta u ekspozua në kritika si në periudhën para formimit të qeverisë së re në shtator të vitit 2016, ashtu edhe gjatë zgjedhjes së fundit të gjyqtarëve nga ana e Këshillit Gjyqësor, pas zgjedhjeve të mbajtura lokale në nëntor të vitit 2017. Ndaj zgjedhjes së fundit reagon një pjesë e gjyqtarëve të paraqitur për këto pozita,⁴⁴ veçanërisht për shkak të faktit se për herë të parë u anashkalua neni i Ligjit për gjykata kështu që nuk u zgjodh kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Apelit në Shkup me numër më të madh të pikëve.

Gjatë periudhës së raportimit u zgjodhën edhe 3 prokurorë publikë në Prokurorinë Publike të RM-së, 4 prokurorë publikë në prokuroritë e larta dhe 18 prokurorë publikë në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit.⁴⁵ Zgjedhja e fundit e prokurorëve publikë u bë më datë 31.01.2018, me ç’rast u zgjodhën 8 prokurorë publikë në Prokurorinë Publike për Krim të Organizuar dhe Korrupsion Shkup nga 15 kandidatë të paraqitur.⁴⁶

Pas shkarkimit të prokurorit publik shtetëror, në gusht të vitit 2017, Qeveria në mbledhjen e 36-të miratoi konkluzion që t’i propozoj Kuvendit që për Prokuror të ri Publik ta emëroj Lubomir Joveski-in, anëtar i Këshillit të Prokurorëve Publikë, në bazë të biografisë së tij profesionale, si dhe në bazë të mendimit pozitiv të Këshillit të Prokurorëve Publikë,⁴⁷ kështu që më 25 dhjetor të vitit 2017 ai u zgjodh për Prokuror Publik shtetëror. Megjithatë, mbetet e paqartë se sipas cilave kriteret u udhëhoq ajo gjatë përzgjedhjes së tij, duke e pasur parasysh numrin e madh të kandidatëve për këtë funksion, si dhe duke e pasur parasysh mungesën e transparencës së mjaftueshme të procedurës në fjalë.

41 Njoftim i Këshillit Gjyqësor, <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=500>, I aksesshëm në dhjetor të vitit 2016.

42 Njoftim i Këshillit Gjyqësor, i aksesshëm në: <https://goo.gl/rACFu3>

43 Njoftim i Këshillit Gjyqësor, i aksesshëm në: <https://goo.gl/YPc6eA>

44 Deklarata u dha për emisionin “360 shkallë” <http://360stepeni.mk/article/454/unapreduvanje-po-zaslugi-ili-po-nekoe-novo-tefterche>

45 Raporti i parë i monitorimit “Reformat në gjyqësor – nga PRIBE 1 deri në Pribe 2” dhe më pas”, i aksesshëm në: <https://goo.gl/Bqq7P6>

46 Komunikatë e Këshillit të Prokurorëve Publikë, e aksesshme në: <http://www.sjorm.gov.mk/Soopstenija.aspx?soopstenie=10>

47 Komunikatë e Qeverisë për mbledhjen e 36-të, e aksesshme në: <http://vlada.mk/node/13644>

Vlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë

Pavarësia e pozitës së gjyqtarëve mund të rrezikohet edhe si pasojë e kritereve jopërkatëse për notimin, vlerësimin dhe avancimin e mëtutjeshëm të tyre. As në periudhën e raportimit nuk u ndër-morën angazhime të konsiderueshme në drejtim të rishikimit të metodologjisë ekzistuese për notimin e gjyqtarëve, me ç'rast do të inkorporoheshin kritere kualitative si kritere kyç për notimin e punës së tyre dhe bazë për përcaktimin e përbushjes së kushteve për avancimin e tyre në pozita më të larta në hierarkinë gjyqësore (avancim në karrierë sipas meritës). Në vend të kësaj, pika e referimit dominant, gjatë matjes së performancës së gjyqtarëve, mbeti vetëm norma e arritur, përkatësisht ballafaqimi me numrin e përafërt të lëndëve që duhet t'i zgjidh gjyqtari në nivel mujor si kriter kuantitativ, i cili nuk e merr parasysh kualitetin e shpërndarjes së drejtë, e që duhet të jetë një komponentë i rëndësishëm gjatë vlerësimit të punës. Aq më shumë, Këshilli Gjyqësor për çdo vit merr vendim me të cilin e përcakton numrin e përafërt të lëndëve që duhet t'i zgjidh gjyqtari në nivel mujor edhe atë në bazë të Ligjit dhe Rregullores së punës, megjithatë, nuk është miratuar rregullore me të cilën përcaktohet metodologjia e kompleksitetit të materies në të cilën bën pjesë lënda gjatë përcaktimit të numrit të përafërt të lëndëve të cilat duhet t'i zgjidh gjyqtari në nivel mujor.⁴⁸

Këshilli Gjyqësor bëri notim të jashtëzakonshëm të kandidatëve për kryetarë të gjykatave, me ç'rast mbledhjet e notimit të gjyqtarëve, sipas rregullit, ishin të fshehta. Këshilli Gjyqësor nuk e pranoi kërkesën të njërit nga kandidatët për kryetar të Gjykatës Themelore Shkup 1 që Këshilli Gjyqësor ta rishikoj vendimin për notimin e jashtëzakonshëm të kandidatëve për kryetarë të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit Shtip, Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup dhe Gjykatës Themelore në Tetovë duke e shpallur këtë iniciativë të gjyqtarit si të pabazë, me ç'rast konkludoi se nuk ka shkaqe për rishqyrtimin e atij vendimi.⁴⁹

Në dhjetor të vitit 2016, Këshilli Gjyqësor miratoi aktvendim për notimin e jashtëzakonshëm edhe të Lidija Nedelkova, kryetare e Gjykatës Supreme. E pakënaqur nga aktvendimi, ajo, deri te Këshilli Gjyqësor paraqiti kërkesë për notim të sërishëm, e cila në janar të vitit 2017 u refuzua si e pabazë. Ish-kryetarja e Gjykatës Supreme ngriti procedurë administrative në të cilën kërkonte të anulohet aktvendimi i Këshillit Gjyqësor dhe shqiptim të masës së përkohshme – ndalim për ndërmarrjen e mëtutjeshme të veprimeve për zgjedhje të kryetarit të Gjykatës Supreme, meqë gjatë notimit të jashtëzakonshëm është shkelur parimi i transparencës së procedurës, veprim i kundërligjshëm me të cilin janë penguar ose kufizuar të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë. Megjithatë, sipas Gjykatës Administrative, notimi i jashtëzakonshëm i Këshillit Gjyqësor është bërë në përputhje me nenin 9 paragrafin 3 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, procedura është zbatuar në përputhje me nenin 38 paragrafin 4 të Rregullores së Këshillit Gjyqësor, ndërsa gjyqtarës nuk i janë cenuar të drejtat në të cilat është thirrur.⁵⁰

Në vazhdimin e mbledhjes së 262 të Këshillit Gjyqësor të mbajtur më datë 20.09.2017 u morën vendime në lidhje me kërkesat e paraqitura për notim të sërishëm të punës së kryetarëve të gjykatave për vitin 2015 dhe 2016, por edhe më tutje vazhdoi praktika e kritikuar paraprakisht e përgjashimit të publikut nga notimi.⁵¹

Sa i përket notimit të prokurorëve publikë edhe pse Këshilli i Prokurorëve Publikë miratoi Rregullore për notimin e prokurorëve publikë sipas së cilës notimi bëhet çdo dy vjet, megjithatë në praktikë notimi i këtyre nuk bëhet rregullisht dhe nuk jep rezultate përkatëse.⁵²

48 Raporti i parë i monitorimit "Reformat në gjyqësor – nga PRIBE 1 deri në Pribe 2" dhe më pas", i aksesëm në: <https://goo.gl/Bqq7P6> Edhe pika e rendit të ditës në të cilën u shqyrtua kjo iniciativë nuk ishte e hapur për publikun.

50 Vendimet e Gjykatës Administrative USPI. nr.5/2017 dhe USPI.nr.6/2017 janë të aksesshme në linqet si vijojnë: <http://www.uskopje.mk/Odluki.aspx?odluka=20263> dhe <http://www.uskopje.mk/Odluki.aspx?odluka=20264>.

51 Komunikatë e Këshillit Gjyqësor, e aksesshme në: <https://goo.gl/1PLX4M>

52 Punëtori ekspertësh për Raportin në hije, e zhvilluar më datë 07.02.2018.

Mobiliteti i gjyqtarëve

Me transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve nga gjykatat themelore në shtet në Gjykatën Themelore Shkup 1 dhe të shtatë gjyqtarëve nga gjykatat e apelit nga brendia e vendit në Gjykatën e Apelit Shkup, Këshilli Gjyqësor kishte ndikim të drejtpërdrejtë mbi strukturën e gjyqtarëve të cilët vendosnin për lëndët e proflit të lartë të cilat i inicioi Prokuroria Speciale Publike. Në mënyrë plotësuese, zgjedhja e kryetarëve UD të Gjykatës Themelore Shkup 1 dhe të Gjykatës Supreme nga ana e Këshillit Gjyqësor u shoqërua me kritika të konsiderueshme nga publiku profesionist dhe nga kasta gjyqësore. Në këtë rast u vunë në pikëpyetje parimet themelore të veprimit të Këshillit Gjyqësor si institucion i pavarur.⁵³ Njëkohësisht, mobiliteti i gjyqtarëve ishte njëra nga kritikrat kryesore në Raportin e Pribe nga muaji shtator i vitit 2017.⁵⁴

Periudhën raportuese e karakterizuan edhe ritransferimet masive të gjyqtarëve në Gjykatën Themelore Shkup 1 që filluan në vjeshtën e vitit 2016 nga ish-kryetari, gjyqtari Vlladimir Paņevski që të vazhdojnë në shkurt të vitit 2017 kur UD kryetarja Tatjana Mihajlova mori vendim për transferimin e përafërsisht 20 gjyqtarëve nga departamenti penal në atë të kundërvajtjeve, pa kurrfarë konsultimi me të njëjtët. Një pjesë e gjyqtarëve u transferuan në pozita më të ulëta e që u nënkuptua si degradim i tyre i qëllimshëm me prapavijë të caktuar, meqë ata ishin prej të rrallëve që morën vendime pozitive pas kërkesave për kontroll ose masës paraburgim të PSP, përfshirë këtu edhe 15 gjyqtarë të cilët përmes peticionit e kritikonin punën e Paņevski-t. Disa media këtë veprim e interpretuan si cenim të pavarësisë së punës së gjykatës, ndërkaq gjykata në këtë reagoi duke pohuar se kryetarja UD ka vepruar në kuadër të autorizimeve të saja ligjore dhe se nuk bëhet fjalë për kurrfarë “pastrimi” të gjyqtarëve “të papërshtatshëm”, por për një pjesë të aktiviteteve në kuadër të Kalendarit vjetor.⁵⁵ Përfundimisht, një numër i konsiderueshëm i gjyqtarëve paraqitën kundërshtime në Gjykatën Supreme në lidhje me Kalendarin vjetor, e cila pranoi 7 nga gjithsej 8 kundërshtime, ndërkaq gjyqtarët, kundërshtimet e të cilëve u miratuan, i kthyen në vendet e tyre të vjetra të punës dhe pas kësaj pasoi dorëheqja e Mihajlovës.

Kryetari i sapoemëruar i Gjykatës Themelore Shkup 1, Stojançe Ribarev vazhdoi me praktikë të ngjashme gjatë menaxhimit me gjykatën, i cili filloi me miratimin e Kalendarit të ri vjetor kontrovers për punën gjatë vitit 2017.⁵⁶ Ai në publik u prit me reagime të vullshme që kishin të bëjnë me caktimin e gjyqtarëve në procedurën paraprake në Departamentin për Krim të Organizuar ku do t'i procesuonjë lëndët e PSP-së personave për të cilët ekzistonin dyshime për relacione të afërta me partinë e atëhershme në pushtet VMRO-DPMNE. Nga ana tjetër, në llogari të avancimit të këtyre të gjyqtarëve, të cilët ishin përfshirë në bisedat e përgjuara dhe në publikë të apostrofuara si frenues të punës së PSP, u bë një degradim i ashpër i gjyqtarëve me përvojë dhjetëvjeçare në materien penale përmes transferimit të tyre në pozita më të ulëta, si dhe të gjyqtarëve të cilët kanë marrë vendime pozitive sa u përket kërkesave për kontroll dhe kundërshtime të PSP-së. Megjithatë, në prill të vitit 2017, Gjykata Supreme i hodhi poshtë të gjitha 17 kundërshtimet e gjyqtarëve nga Gjykata Themelore Shkup 1 të cilët nuk ishin të kënaqur nga transferimi.⁵⁷ Pas zgjedhjes së Ivan Xhlev për kryetar të Gjykatës Themelore Shkup 1, pasoi transferim i ri, i cili u miratua në dhjetor të vitit 2017,

53 Këto konstatime të Institutit për Politikë Evropiane (EPI) janë përfshirë në brifingun e tyre të titulluar si “Statusi i reformave urgjente” më datë 30 maj 2017, të cilat janë të aksesshme në, http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04771/mk/Status-na-ltni-reformski-prioriteti_Maj2017_MK.pdf, si dhe në dokumentin “Raporti i Pribe dy vjet më vonë: Qeveri e re dhe mundësi të reja për zgjidhjen e problemeve të vjetra”, f. 3 http://epi.org.mk/docs/1.%20Izvestajot%20na%20Pribe%20dve%20godini%20potoa_MK.pdf.

54 2017 Vlerësimi i rekomandimeve të Grupit të Ekspertëve të Nivelit Lartë për çështje sistimore për Sundimin e së drejtës 2017, i aksesshëm në: <https://goo.gl/Gga4Ad>

55 Raporti i monitorimit të punës së Këshillit Gjyqësor, i aksesshëm në: [http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04763/mk/IHR-Izvestaj-01-\(web\)-MK.pdf](http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04763/mk/IHR-Izvestaj-01-(web)-MK.pdf)

56 Komunikatë për agjendën e re vjetore, e aksesshme në këtë link: <http://www.oskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=598> (vizita më datë 02.04.2017)

57 Komunikatë për publikun e Gjykatës Supreme, e aksesshme në: <https://goo.gl/gWsn2U>

me të cilin kuadrot me përvojë të cilët para dy vitesh pa arsytim u transferuan në departamentin e kundërvajtjeve u kthyen t'i gjykojnë lëndët nga fusha e krimit të organizuar.

Përveç vendimeve për ritransferimin e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore Shkup 1, mëdyshje të mëdha në publik shkaktuan edhe ritransferimet e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të cilat ndodhën pas ndërrimit të udhëheqësisë së saj. Veçanërisht ishte kontrovers vendimi i Gjykatës Supreme, të muajit prill të vitit 2017, me të cilin u hodh poshtë kundërshtimi i gjyqtarëve Lidija Nedellkova kundër vendimit të kryetarit të Gjykatës Supreme, Jovo Vangelovski që ajo si ish-kryetare e Gjykatës të transferohet në seksionin për gjykim në afat të arsyeshëm, ndërsa në vendin e saj ishte caktuar gjyqtarja Snezhana Bajlozova, ekspertiza primare i të cilës është materia civile. Në të vërtetë, moskompletimi i Këshillit Penal të Gjykatës Supreme ishte njëra nga pengesat që kjo gjykatë të caktoj mbledhje publike në të cilën do të vendoset nëse aktvendimet për paraburgim të miratuar nga gjykata më të ulëta janë të ligjshme dhe nëse lënda për paraburgimin e biznesmenit Sead Koçan do të kthehet në rigjykim tek gjyqtari i procedurës paraprake. Transferimi i saj pasoi disa muaj pas pushimit të mandatit të saj, përkatësisht pasi që në nëntor të vitit 2016 ajo për herë të parë në karrierën e saj publikisht u prononcua për gjendjet e përgjithshme në gjyqësor, me ç'rast kishte vështrim kritik edhe ndaj punës së Këshillit Gjyqësor, por edhe ndaj veprimit të Gjykatës Themelore Shkup 1 në lidhje me lëndët e PSP.⁵⁸

■ Pavarësia e mbrendshme

Vëmendje të posaçme mediatike zgjuan ngjarjet në Gjykatën Themelore Shkup 1 edhe atë jo vetëm nga aspekti i veprimit ndaj lëndëve të PSP por edhe nga aspekti i marrëdhënieve të brendshme midis gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore, të cilët në kontinuitet ishin çrregulluar.

Kështu, në muajin nëntor të vitit 2016, një ditë pas publikimit të Raportit të KE në të cilin është nënvizuar se Republika e Maqedonisë shënon hapa retrograde në zbatimin e reformave në gjyqësor, Gjykata Themelore Shkup 1 publikoi komunikatë⁵⁹ me të cilën u transmetua deklarata e kryetarit Pançevski, me të cilën ai plotësisht i hedhë poshtë të dhënat e kallëzimit penal të paraqitur nga gjyqtari Ivan Gjolev se ka kryer vepër penale “Pranim të shpërblimit për ndikim të kundërligjshëm” si të pabazuara dhe njoftoi se ka paraqitur kallëzim penal kundër tij për “Kallëzime të rrejshme të veprës penale”. Kjo, nga publiku u vlerësua si cenim të pavarësisë dhe autonomisë së gjyqësorit.

Në janar të vitit 2018 kishte letërkëmbime dhe reagime mediatike për shkak të paraqitjes së kallëzimit penal kundër ish-kryetares së Gjykatës Supreme, Nedelkova nga kryetari aktual Vangelovski në të cilat merrnin pjesë edhe dy gjyqtarët. Sipas Vangelovski-t, Nedelkova në emër të Departamentit për vepra penale pranë Gjykatës Supreme të cilën atëherë e udhëhiqte, pa mbajtur mbledhje ka lëshuar urdhër për veprimin e Gjykatës Themelore Shkup 1 në lidhje me rastet e PSP, me ç'rast ka bërë dhe ka përdorur falsifikat.⁶⁰

Matja e lirë gjyqësore si garanci e pavarësisë u cenua si pasojë e miratimit dhe zbatimit të Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit (LPLLMLD). Ky Ligj hasi në kritika të shpeshta nga publiku profesionist, e që ishte nënvizuar edhe në analizën e realizuar nga Këshilli për Parandalim Kundër Delikuencës së të Miturve (KPKDM) në kuadër të “Rrjetit 23+” e prezantuar gjatë muajit korrik të vitit 2017, e cila kishte për qëllim të përcaktohet ndikimi i këtij Ligji mbi politikën e përgjithshme penale në vend. Sipas analizës, implikimet nga LPLLMLD, kryesisht kanë të bëjnë

58 Intervistë në emisionin “360 shkallë” në produksion të televizionit të Shkupit ALSAT-M, e emituar më 31 nëntor të vitit 2016, është plotësisht e aksesshme në linkun në vijim: <https://www.youtube.com/watch?v=GPwTqIHhsaE>

59 Komunikatë e Gjykatës Themelore Shkup 1, e aksesshme në: <http://www.osskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=580>, i aksesshëm në: 30.11.2016.

60 Shkarkuar në datën 30.01.2018 <https://goo.gl/zGxepH>

me pranimin e shpeshtuar të fajit në seancën kryesore; zbatimin e shpeshtuar të procedurave për lëshimin e urdhërit penal; sanksionimin më të butë për vepra më të rënda penale; sanksionimin më të rreptë për vepra më të lehta penale; pabarazinë e praktikës. Në këtë bazë, hulumtuesit rekomanduan ndërhyrje përkatëse ligjore, duke e përfshirë edhe shfuqizimin e plotë të këtij Ligji, si dhe ndryshimet përkatëse në nenin 39 paragrafin 3 të KP.⁶¹

Gjykata Kushtetuese e publikoi aktvendimin, me të cilin e anuloi Ligjin për përcaktimin e llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit, me arsyetimin se ky Ligj seriozisht e cenon pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe e ka shkelur parimin e ndarjes së pushtetit dhe në këtë rast është bërë përzjerja e pushtetit ligjvënës me atë gjyqësor, e që në të vërtetë duhet të jenë pushtete të pavarura. Përveç kësaj, në aktvendim theksohet se Ligji është në kundërshtim me vlerësimin e lirë të parashikuar me Ligj të provave dhe bindjes gjyqësore, e që në këtë mënyrë është formalizuar, me ç'rast nuk është mbajtur llogari për individualizimin e dënimit. Për gjyqtarët konstitucionalistë, zgjidhjet që i përmban Ligji janë në kundërshtim me Kushtetutën e RM-së dhe sundimin e së drejtës, ndërkaq në këtë drejtim bën fjalë edhe analiza⁶² e profesorëve të të drejtës penale, Buzharovska dhe Nanev, në të cilën thirret edhe referati i Gjykatës.⁶³

Prokuroria Speciale Publike

Për dallim nga Raporti për punën e saj gjatë gjashtë muajve të parë,⁶⁴ me ç'rast Prokuroria Speciale Publike (PSP) raportoi se është vendosur kompetencë reale në gjithsej 30 lëndë kundër 80 personave, sipas Raportit të tretë gjashtëmujor, i cili iu dërgua Këshillit të Prokurorëve dhe Kuvendit të RM-së, përfundimisht me datën 15.03.2017, PSP ka zhvilluar procedura parahetimore kundër 112 personave, ndërsa 50 persona kanë qenë subjekt të procedurave hetimore. Deri atëherë është analizuar përmbajtja e 272.950 audio regjistrimeve (skedarëve), përkatësisht janë përpunuar 45% nga numri i përgjithshëm i audio regjistrimeve të cilat i ka në dispozicion PSP.⁶⁵

Megjithatë, PSP edhe në tremujorin e parë të vitit 2017 u pamundësua që plotësisht dhe papengesë t'i kryej kompetencat e saj ligjore për procesimin e të gjitha lëndëve të cilat rezultuan nga të ashtuquajturat "bomba", ndërsa mungoi edhe bashkëpunimi i nevojshëm me shumicën e strukturave relevante shtetërore. Kjo periudhë, u shënua me opstrukcione dhe mosbashkëpunim me PSP nga ana e organeve kompetente shtetërore, siç është Ministria e Punëve të Brendshme, por edhe me frenimin e procedurave në Gjykatën Themelore Shkup 1. Përveç kësaj, u dënuan edhe prokuroret e PSP me dënim në para me nga 2.000 euro të shqiptuara për kinse "mosrespektim elementar të gjykatës" gjatë seancës gjyqësore të mbajtur në rastin e përdorimit të dhunës në Komunën Qendër.⁶⁶

61 Analiza është e aksesshme në linkun në vijim: <http://www.merc.org.mk/aktivnost/24/analiza-na-primenata-na-zakonot-za-odreduvanje-na-vidot-i-visinata-nakaznata>. Nevoja për shfuqizimin e këtij ligji u konstatua edhe në analizën e Shoqatës "PAKTIS" nga Prilepi, e titulluar: Analiza e ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit, <http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/PACTIS-analiza-na-Zakon-za-odmeruvanje-na-kaznata.pdf>. Për nevojat e kësaj analize u hartuan pyetësorë të cilët iu dërguan gjyqtarëve, prokurorëve publikë dhe avokatëve të jurispruencës së: Prilepit, Manastirit dhe Ohrit. Kjo analizë tregoi se për shfuqizimin e këtij ligji janë deklaruar 80% e gjyqtarëve të anketuar, 86% e prokurorëve të anketuar dhe 93% e avokatëve.

62 Kjo analizë është hartuar në kuadër të projektit "Rrjeti 23+" dhe është e aksesshme në: http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Analiza_Primena-na-ZOVOVK_SPPMD-Juni-2017.pdf

63 Referati është i aksesshëm në: <http://www.ustavensud.mk/domino/WEBSUD.nsf>

64 Raportin e plotë mund ta lexoni në linkun në vijim: <http://www.jonsk.mk/%D0%B4%D0%BE%D0%BA%D1%83%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82%D0%B8/>.

65 Raporti i tretë për punën e PSP është i aksesshëm në linkun: <http://www.jonsk.mk/wp-content/uploads/2017/03/III-iz-vestaj.pdf>

66 Komunikatë e Gjykatës Themelore Shkup 1, <http://www.osskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=592>, e aksesshme në 28.02.2017

Raporti i Gjykatës Themelore Shkup 1 ndaj PSP u vu në dukje edhe përmes qëndrimit të saj publik me të cilin pres-konferencat televizive të PSP u kualifikuan si spektakle në të cilat nuk respektohet prezumimi i pafajësisë dhe ligjshmëria e procedurave,⁶⁷ dhe përmes opstrukcioneve të numërta si refuzimi të lëshohet urdhër për kontrollin e sistemeve kompjuterike tek operatori i telekomunikacioneve, e që ishte arsyetuar me kinse paqartësinë dhe joprecizitetin e kërkesës.⁶⁸ Pastaj, një numër i madh i propozimeve të paraqitura për shqiptimin e masës paraburgim për personat e pandehur në veprat të cilat rezultuan nga materialet e përgjuara u refuzuan, veçanërisht kur bëhej fjalë për funksionarë të lartë shtetërorë. Nga ana tjetër, gjykata lëshoi vetëm një urdhër për kontroll në lidhje me procedurën hetimore të lëndës “Titanik”, ndërsa të gjitha kërkesat e tjera për lëshimin e urdhrave për kontrollin e ish-funksionarëve të lartë dhe funksionarëve aktual u refuzuan.

Propozimet e paraqitura për përcaktimin e masave për sigurimin e prezencës dhe masave të kujdesit për ish-shëfën e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, Sasho Mijallkov dhe ish-kryeshefën e Drejtorisë së Pestë së MPB, Goran Grujovski, në lëndët “Target”, dhe “Tvrdina” që kanë të bëjnë me përgjimin e paligjshëm dhe shkatërrimin e pajisjes së DSK Këshilli penal i hodhi poshtë si të pabaza dhe sipas detyrës zyrtare përcaktoi masa kujdesi. Pakënaqësi të veçanta në publik nxitën aktvendimet e Këshillit të Gjykatës Supreme nga data 26.07.2017, me të cilat u hodhën poshtë ankesat e mbrojtësve të Goran Grujovski-t dhe Nikolla Boshkovski-t dhe aktvendimet e konfirmuara të Gjykatës së Apelit Shkup për përcaktimin e masës arrest me burg prej 30 ditësh. Për ekspertët ishte kontrovers miratimi i veprimit sunspensiv të ankesës, me ç’rast u la hapësirë që të pandehurit të arratisen, dhe prandaj u kërkua edhe përgjegjësi nga gjyqtarët për veprimin e këtillë, e që në të vërtetë është një abuzim evident i ligjit në dëm të drejtësisë.

Edhe në lëndën “Titanik” kolegji penal i hodhi poshtë kërkesat për përcaktimin e arrestit me burg për ish-kryeministrin Nikolla Gruevski, për ish-ministren e Punëve të Brendshme Gordana Jankullovska, për shëfën e kabinetit të ish-kryeministrit, Martin Protugjer, për ish-sekretarin e përgjithshëm të Qeverisë, Kirill Bozhinovski dhe për ish-ministrin e Transportit dhe Lidhjeve, Mile Janakievski, dhe të gjithë këtyre personave ua shqiptoi masën e kujdesit.⁶⁹ I ngjashëm ishte veprimi i gjykatave edhe sa i përket biznesmenit Sead Koçan, i pandehur në lëndën “Trust”, në të cilën në fund iu përcaktua garanci përkatëse.⁷⁰

Gjykata e Apelit Shkup ishte e përmbajtur në shqiptimin e arrestit me burg ndaj ish-bartësve të funksioneve shtetërore, përfshirë këtu edhe Elizabeta Kançevska Milevska, ish-ministre e Kulturës dhe ish-nënkryetarin e Qeverisë për Çështje Ekonomike, Vladimir Peshevski.

Opstrukcionet dhe praktika e gjykatave, sa u përket propozimeve të PSP, për mos-shqiptimin e arrestit me burg, e që është një precedent i llojit të vet për procedurat e krimit dhe korrupsionit të organizuar i orientuar drejt parandalimit të zbatimit të drejtësisë. Pas ndërrimit të pushtetit ndihet tendencë pozitive në drejtim të tejkalimit të gjendjeve paraprake dhe realizimit të bashkëpunimit më të mirë me PSP, veçanërisht në aspektin e sigurimit të dokumenteve dhe provave në përputhje me Ligjin për procedurë penale. Edhe në raportin e katërt për punën e PSP për periudhën kohore nga data 15.03.-15.09.2017 është nënvizuar se ajo që e dallon këtë periudhë nga periudhat e kaluara është pikërisht paraqitja e akuzave për shumicën e procedurave të hapura hetimore, përkatësisht

67 Komunikatë e Gjykatës Themelore Shkup 1, <http://www.osskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=570>, e aksesshme në 02.11.2016

68 Komunikatë e PSP, e aksesshme në: <http://www.jonsk.mk/2016/11/24/побарани-дополнителни-информации-од/> Në muajin prill të vitit 2017, në hapësirat e “Telekomi të Maqedonisë” u mbajt një takim punë në nivel më të lartë me përfaqësuesit e kësaj kompanie, e që ishte hapi i parë konkret i bashkëpunimit pas njoftimeve të shumta mediatike se për dallim nga operatorët e tjerë mobil, vetëm Telekomi ka refuzuar të jetë pjesë e hetimit të PSP. (<http://www.jonsk.mk/2017/04/24/одржана-работна-средба/>)

69 Komunikatë e Gjykatës Themelore Shkup 1, <http://bit.ly/2hVx6X>, e aksesshme më datë 07.07.2017

70 Komunikatë e Gjykatës Themelore Shkup 1, <http://alturl.com/swpce>, e aksesshme më datë 20.05.2017

se gjithsej janë paraqitur 18 akuza për 19 lëndë kundër 120 personave për 168 vepra penale, prej të cilave në periudhën raportuese janë hapur 7 procedura të reja hetimore kundër gjithsej 25 personave fizikë dhe janë ndërmarrë veprime hetimore ndaj 4 personave juridikë.⁷¹

Shfrytëzimi i “bombave” si provë

Në periudhën e raportimit u konstatuan veprime të ndryshme të gjykatave vendore në lidhje me atë nëse materialet e përgjuara në të ashtuquajturat “bomba” duhet të shfrytëzohen si prova në procedurat e iniciuara nga PSP, e që e vë në pikëpyetje paanshmërinë në ndarjen e drejtë të drejtësisë, si dhe sa i përket sigurisë juridike.

Së këtejmi, Gjykata e Apelit Shkup dy herë lejoi që bombat, përkatësisht provat e siguruar nga materialet e përgjuara, të trajtohen si prova në procedurën penale edhe atë në lëndën për Komunën Qendër,⁷² si dhe në lëndën “Trista”,⁷³ me ç’rast i mori në konsideratë ankesat e PSP dhe i modifikoi vendimet e Gjykatës Themelore Shkup 1 me të cilën, në këto raste, provat janë veçuar nga dokumentet si prova të siguruar në mënyrë të paligjshme.

Nga ana tjetër, Gjykata, penale në shtator të vitit 2017, i veçoi bisedat e përgjuara nga provat në “Toplik”, “Tender” dhe “Tortura”, me arsyetimin se janë siguruar në mënyrë të paligjshme dhe me shkeljen e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë e që i bën të papërdorshme në procedurat në fjalë.⁷⁴

Gjykata Supreme organizoi mbledhje të përgjithshme, me qëllim që të miratohet mendim parimisht i drejtë në lidhje me atë nëse “bombat” e opozitës mund të përdoren si provë në procedurë gjyqësore⁷⁵ megjithatë, edhe krahas arsyetimit të prezantuar nga ana e ish-gjyqtarës së pranishme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Mirjana L Lazarova Trajkovska, se materialet e siguruar në mënyrë jolegale mund të jenë prova në procedurat gjyqësore, si dhe angazhimi i saj që Gjykata Supreme të mos vihet në pozitë të ligjvënësit dhe të lejoj qasje individuale ndaj çdo rasti,⁷⁶ nuk u miratua vendimi për këtë çështje, e që në mënyrë plotësuese mund të ndikoj në besimin ndaj Gjykatës Supreme.

Është i domosdoshëm fuqizimi i mëtutjeshëm i pavarësisë së gjyqësorit duke e përfshirë edhe Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin e Prokurorëve Publikë, përmes një procesi përkatës dhe transparent dhe përmes vendimeve të justifikuar për emërimin dhe avancimin e gjyqtarëve, si dhe zbatimi i procedurave të qarta për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave dhe për transferimin e gjyqtarëve. Në këtë drejtim është edhe një pjesë e madhe e elementeve të Strategjisë për reforma në sektorin e jurisprudencës të cilat, mes tjerash, parashikojnë deprofesionalizim të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe përgjegjësi të tyre më të madhe. Deprofesionalizimi nuk është parashikuar në draft-ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Këshillin Gjyqësor.

Në drejtim të rritjes së pavarësisë së gjyqësorit janë edhe ndryshimet e propozuara ligjore të Ligjit për gjykata dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor. Në mënyrë plotësuese nevojitet precizimi i profesionalizmit të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, përkatësisht precizimi i kriterëve për zgjedhjen e anëtarëve të

71 Raport për aktivitetet e Prokurorisë Publike për Ndjekjen e Veprave Penale të lidhura dhe të cilat rezultojnë nga përbajtja e ndjekjes së komunikimeve të paligjshme për periudhën prej gjashtë muajsh (për periudhën nga data 15.03.2017 deri më datë 15.09.2017) i aksesshëm në: www.jonsk.mk/wp-content/uploads/2017/09/ИЗВЕШТАЈ-15.09.2017.pdf

72 Komunikatë e Gjykatës së Apelit Shkup, e aksesshme në: <https://goo.gl/vB4PEy>

73 Komunikatë e Gjykatës së Apelit Shkup, e aksesshme në: <https://goo.gl/ZFAZYn>

74 Komunikatë e Gjykatës Themelore Shkup I, e aksesshme në: <https://goo.gl/ar8mge>

75 Deklaratë e kryetarit të Gjykatës Supreme Jovo Vangelovski, e aksesshme në: <http://makfax.com.mk/daily-news/вангеловски-не-сe-откажува-и-покрај-од/>

76 Ibid.

Këshillit Gjyqësor të cilët zgjidhen nga Kuvendi i RM-së, si dhe përkufizimi i nocionit “jurist i shquar”. Nevojiten edhe ndryshime ligjore në lidhje me inkorporimin e përgjegjësisë së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, përkatësisht të Këshillit të Prokurorëve Publikë.

Sa i përket zgjedhjes së prokurorëve publikë është bërë diskrapancë të kushteve që duhet t'i plotësojë Prokurori Publik i RM-së dhe Prokurori Publik i Prokurorisë së Lartë Publike për të cilët nuk nevojitet të kenë stazh si prokurorë publikë me rezultate të konfirmuara gjatë punës.

Edhe pse Këshilli i Prokurorëve Publikë ka miratuar Rregullore për notimin e prokurorëve publikë, sipas së cilës notimi bëhet çdo dy vjet, megjithatë, në praktikë notimi i këtillë i prokurorëve publikë nuk realizohet rregullisht dhe nuk jep rezultate përkatëse. Duhet të përmirësohet kualiteti i notimit të prokurorëve publikë. Në mënyrë plotësuese, duhet të bëhet precizimi i kriterëve të propozuara kualitative për notimin e gjyqtarëve, para së gjithash edhe varësisht nga kompleksiteti i lëndëve, si dhe të merren parasysh kriteret për zgjedhjen e gjyqtarit në gjykatë më të lartë të specifikuar në nenin 41 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor gjatë notimit të gjyqtarëve.

Është i domosdoshëm fuqizimi i pavarësisë financiare në formën e përqindjes së rritur nga bruto prodhimi vendor, e që do të akordohej për gjyqësorin, në mënyrë që të arrihet përqindja e përcaktuar ligjore prej 0,8% nga BPV, e cila do të akordohej për pushtetin gjyqësor ose ndryshimi i kësaj dispozite në drejtim të akordimit të përqindjes optimale prej 0,5% nga BPV për financimin e gjyqësorit, konform analizave në këtë fushë. Në mënyrë plotësuese nevojitet të ndërpritet praktika që përmes rishikimit të buxhetit, të shkurtohet buxheti i pushtetit gjyqësor.

Duhet të përhëndetet orientimi strategjik të cilin e përmban Strategjia për reforma në sektorin e jurispruencës, për inkorporimin e PSP si prokurori e veçantë në kuadër të PPRM, e cila do të ishte kompetente për gjithë territorin e shtetit dhe përveç lëndëve të cilat rezultojnë nga ndjekja e paautorizuar e komunikimeve do të kishte edhe kompetencë të zgjeruar, në mënyrë që t'i përfshij edhe veprat e tjera penale të korrupsionit me profil të lartë (white-collar crime). Megjithatë, duhet të jemi shumë të kujdesshëm, me qëllim që të shmanget cilado qoftë mbivendosje e padëshiruar të kompetencave të saj me ato të PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Së këtejmi, mbetet sfida për garantimin e pavarësisë së plotë dhe paanshmërisë së gjyqtarëve të cilët do të zgjidhen që të veprojnë në atë seksion special, duke i pasur parasysh përvojat e deritanishme negative.

Paanshmëria

Paanshmëria e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe e jurispruencës në tërësi u vu në pikëpyetje edhe atë disa herë. Fillimisht, njëanshmëria e Prokurorisë Publike e cila manifestohej vetëm gjatë procedurimit të pjesëtarëve të opozitës dhe sektorit qytetar përkundrejt qasjes pasive, sa u përket sugjerimeve për keqpërdorime dhe vepra të kryera penale nga përfaqësuesit e partisë së atëhershme në pushtet VMRO-DPMNE për një periudhë të gjatë kohore. Reagimet në lidhje me njëanshmërinë e Prokurorisë Publike ishin adresuar sa u përket reterimeve parahetimore dhe paraburgimeve në lidhje me ngjarjet në Kuvend më 27 prill.

Si ilustrim, hetimi kundër kryetarit të Komunës Qendër, Andrej Zhernovski për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar” dhe për “Mosekzekutimin e vendimit gjyqësor” në lidhje me objektin e ndërtuar pa leje PTHP Shkup 1 e filloi sipas kallëzimit të hartuar po atë ditë kur shembej ndërtesa pa leje e kryetarit të Gjykatës Themelore Shkup 1, Vladimir Pançevski.

Perceptimi në publik për instrumentalizimin evident të PPRM për qëllime politike u përforcua kur PTHP Shkup hapi procedurë kundër LSDM për keqpërdorimin e mjeteve financiare në fushatën

zgjedhore të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare,⁷⁷ në shkurt të vitit 2017, përkatësisht thuhet se në kohën e njëjtë kur PSP u dërgoi thirrje rreth 200 personave në Ohër, kryesisht anëtarë dhe simpatizantë të VMRO-DPMNE, të japin deklaram si dëshmitarë në kuadër të procedurës parahetimore, në të cilën hetohen donatorët dhe donacionet e partisë dhe keqpërdorimet eventuale në lidhje me të njëjtat. Informacionet në lidhje me atë se në muajin mars të vitit 2017 PPRM ka hapur dy procedura të reja hetimore për parregullsi zgjedhore për zgjedhjet presidenciale të vitit 2014 dhe për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura në dhjetor të vitit 2016 në publik e gjeneruan perceptimin e veprimit selektiv si kundërpeshë të hetimeve për parregullsi zgjedhore që i zhvillonte PSP kundër ish-funksionarëve të lartë qeveritarë, gjithashtu për mashtrime zgjedhore. Po atë muaj, Prokuroria Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (PPNKOK) nxori Urdhër për zbatimin e procedurës hetimore kundër bartësit të funksionit të lartë në Komunën e Strumicës,⁷⁸ si vazhdim të veprimeve parahetimore në lidhje me punën e Komunës, të cilat u zbatuan në vitin 2016, derisa paraprakisht në vllugun e zgjedhjeve parlamentare në dhjetor të vitit 2016 PPNKOK bëri kontroll në shtëpinë e kryeshefit të SPB Kumanovë, nga i cili kontroll rezultoi se është i afërt me LSDM. Nga ana tjetër PPNKOK si të pabazë e hodhi poshtë kallëzimin penal për pranimin e shpërbllimit si ndikim të kundërligjshëm kundër kryetarit të Gjykatës Themelore Shkup 1, Pançevski të paraqitur nga gjyqtari në gjykatën e njëjtë, duke publikuar se kundër parashtruesit është ngritur kallëzim penal për veprën e kryer Kallëzim i rrejshëm i veprës penale.⁷⁹

Në janar të vitit 2017, PSP e revokoi propozim akuzën në lëndën “Puç” në të cilën i akuzuari i katërt ishte lideri i opozitës Zoran Zaev, e cila lëndë iu dorëzua PSP nga Prokuroria Publike e RM-së. Zaevi ishte akuzuar për veprën dhunë ndaj përfaqësuesve të organeve më të larta shtetërore.

Të gjitha këto lëndë të lartpërmendura iniciuan çështje serioze në aspektin e respektimit të parimeve të paanshmërisë dhe jo-selektivitetit në punën e organeve gjyqësore dhe të prokurorive publike, me çka edhe një herë u konfirmua besimi edhe ashtu i ulët i qytetarëve ndaj jurisprudencës në Republikën e Maqedonisë.

Veprimet në lidhje me ngjarjet në Kuvend të datës 27 prill 2017

Hyrja e turmës në Kuvend, më 27 prill të vitit 2017, në të cilën kishte edhe persona të maskuar, bartës të funksioneve si kryetarë komunash dhe drejtorë të ndërmarrjeve publike, çoi në shkeljen e drejtpërdrejtë të dispozitave të Kushtetutës dhe të më shumë ligjeve (Ligji për polici, Ligji për tubime publike, Kodi Penal).⁸⁰ Këto ngjarje ishin një test i madh për paanshmërinë në funksionimin e PPRM. Mosveprimi i nëpunësve policorë, në rastin konkret, ishte rezultat evident i urdhrat të paligjshëm dhe keqpërdorimit të pozitës zyrtare. Në këtë aspekt, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut apeloj për përgjegjësinë e kryerësve, por edhe të eprorëve urdhërdhënës.⁸¹

Menjëherë pas ngjarjeve, Prokuroria Themelore Publike Shkup e njoftoi publikun se ka identifikuar 15 persona të involvuar në trazirat të cilat ndodhën në Kuvend, si dhe se janë marrë në pyetje një

77 Komunikatë e Prokurorisë Publike të RM-së, e aksesshme në: <http://jorm.gov.mk/?p=3852>

78 Komunikatë e Prokurorisë Publike të RM-së, e aksesshme në: <http://jorm.gov.mk/?p=3901>

79 Komunikatë e Prokurorisë Publike të RM-së, e aksesshme në: <http://jorm.gov.mk/?p=3701>

80 Ajo që u nënvizua nga ana e mediave dhe organizatave qytetare dhe që është evidente edhe nga videot e shumta është se pikërisht nëpunësit e autorizuar policorë, të cilët ishin të angazhuar për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike dhe sigurisë së personave të pranishëm në sallën e Kuvendit, në të vërtetë lejuan hyrje papengës në sallën e Kuvendit, si pararojë e ngjarjeve të dhunshme brenda në Kuvend. Së këtejmi, hyrja iu lejua edhe personave të cilët ishin të maskuar me “fantomka” në kokë dhe mbanin sende të forta dhe të mprehta për rrezikimin e integritetit fizik të të pranishmëve. Si pasojë e kësaj, u lënduan gjithsej 109 persona, në mesin e të cilëve qytetarë, 22 nëpunësve policorë dhe dhjetëra deputetë (nga të cilët njëri me lëndime më të rënda trupore).

81 Reagimi i KHM për ngjarjet në Kuvend, i aksesshëm në: <http://mhc.org.mk/announcements/576?locale=mk#.WcBBjcgjHIU>

numër i madh i personave, në mesin e të cilëve edhe pjesëtarë të policisë,⁸² ndërsa për katërbëdhjetë persona është propozuar paraburgim.⁸³

Kryerësit e identifikuar u dyshuan për tre lloje të veprave penale, edhe atë Pjesëmarrje në turmë me çka do të pengohet personi zyrtar në kryerjen e veprimit zyrtar, Pjesëmarrje në turmë me çka do të kryhet vepër penale dhe Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm. Përkundrejt kësaj, Raporti i posaçëm për këto ngjarje, i hartuar nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, vë në dukje se në të vërtetë janë kryer gjithsej 28 vepra të ndryshme të rënda penale të cilat janë përcaktuar me Kodin Penal dhe i njëjti kishte për qëllim që t'u ndihmoj organeve kompetente të jurisprudencës dhe, para së gjithash, PPRM në kualifikimin e këtyre veprave penale.⁸⁴

Ajo që në mënyrë plotësuese e zvogëloi besimin në procesin e përcaktimit dhe sanksionimit të kryerësve ishte fakti se gjatë kohës së seancës kryesore në Gjykatën Themelore Shkup 1 të mbajtur më 23 maj të vitit 2017 të gjithë nëntë personat e akuzuar për të cilët PTHP Shkup paraqiti propozim akuzë për Pjesëmarrje në turmë me çka do të pengohet personi zyrtar në kryerjen e veprimit zyrtar nga neni 384 paragrafi 1 të Kodit Penal e pranuan veprën dhe pas kësaj, gjykata menjëherë iu shqiptoi dënime të kushtëzuara me burgim, ndërsa asnjë të akuzuari nuk iu shqiptua dënim efektiv me burgim.

Në periudhën në vijim PTHP Shkup ngriti procedura kundër më shumë personave për të cilët ekzistonin baza të dyshimit për vepra të kryera penale Shkaktim të rrezikut të përgjithshëm, Përpunim, mbajtje dhe tregtim të palejuar me armë apo me materie⁸⁵ shpërthyesë dhe Dhunë, me çrast për disa prej tyre përcaktoi edhe paraburgim. Me aktgjykim me dënim dhe shqiptim të dënimit me burgim sipas aktakuzës së paraqitur për Dhunë të ashpër u dënua i pandehuri i cili gjatë ngjarjeve në dhomën ligjvënëse e sulmoi deputeten e atëhershme Shekerinska.⁸⁶

Kthesë e plotë në veprimet e deriatëhershme të Prokurorisë Publike u bë me ndalimin e 36 personave, në mesin e të cilëve edhe disa deputetë imuniteti i të cilëve u ishte hequr, gjë e cila ndodhi më datë 28.11.2017, pasi që PTHPNKOK nxori Urdhër për zbatimin e procedurës hetimore kundër 36 personave për shkak të dyshimit të bazuar për vepër të kryer penale.⁸⁷ Për të gjithë këta persona u përcaktua masa e paraburgimit, por ajo që lë përshtypje është se për dallim nga inkriminimet paraprake “më të lehta” të cilat kishin të bëjnë me pjesëmarrjen në turmë, kësaj radhe të gjithë këta persona ngarkoheshin me rrezikim terrorist të rendit kushtetues dhe sigurisë, vepër për të cilën në nenin 313 të Kodit Penal parashikohet dënim me burgim prej më së paku dhjetë vitesh. Kjo hodhi dyshime plotësuese mbi paanshmërinë dhe konsistencën e veprimit të organeve të prokurorisë publike, nga aspekti i periudhës së kaluar të gjatë shtatë mujore nga ngjarjet deri në ndërmarrjen e veprimeve më konkrete për zbatimin e procedurës hetimore, si dhe duke e pasur parasysh rëndësinë e inkriminimeve.

82 Komunikatë e Prokurorisë Publike të RM-së, e aksesshme në: <http://jorm.gov.mk/?p=4002>

83 Komunikatë e Prokurorisë Publike të RM-së, e aksesshme në: <http://jorm.gov.mk/?p=4006>

84 Për këqyrje në listën e detajuar të veprave penale për të cilat Komiteti i Helsinkit konstatoi se janë kryer në bazë të këqyrjes në materialet relevante audio dhe video dhe dëshmime të personave të involvuar. Shikoni Raportin e posaçëm për vepra të identifikuar dhe vepra të mundshme penale të kryera gjatë kohës së dhunës në Kuvend, më datë 27 prill të vitit 2017, i aksesshëm në: http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/2282/Poseben_izvestaj_Sobranie_27_04_17.pdf

85 Komunikatë e Prokurorisë Publike të RM-së, e aksesshme në: <http://jorm.gov.mk/?p=4053>

86 Komunikatë e Prokurorisë Publike të RM-së, e aksesshme në: <http://jorm.gov.mk/?p=4184>

87 Komunikatë e Prokurorisë Publike të RM-së, e aksesshme në: <http://jorm.gov.mk/?p=4416>

■ Sistemi AKMIS

Veprimi etik dhe i paanshëm i disa gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave u vu në dyshim serioz në kontekstin e keqpërdorimeve të mundshme të sistemit AKMIS për shpërndarjen automatike të lëndëve nëpër gjykata, veçanërisht në lidhje me shpërndarjen e lëndëve të cilat rezultuan nga bisedat e përgjuara në kompetencë të PSP, të cilat iu dhanë për vendimmarrje vetëm disa gjyqtarëve nga Gjykata Themelore Shkup 1. Një hap pozitiv në drejtim të përcaktimit të mangësive dhe keqpërdorimeve të mundshme të këtij sistemi është potencimi i nevojës për shpërndarjen e lëndëve pa ndikime të jashtme, si dhe Strategjia e hartuar për reforma në sektorin e jurisprudencës.

Këto dyshime fuqishëm ishin shprehur edhe në Raportin e dytë të ekspertëve të Pribes.⁸⁸ Sipas tij, ka mundësi që i njëjti të jetë manipuluar në më shumë mënyra, edhe atë: 1) transferimi i gjyqtarëve “të papërshtatshëm” në departamente të tjera në rastet kur duhet të shpërndahen lëndë sensitive; 2) pushim mjekësor ose mungesë tjetër nga puna në periudhën e shpërndarjes së lëndëve të këtilla nga ana e gjyqtarëve të cilët kanë dashur t’u shmangen presioneve; 3) mundësia që dallimet e procedurave të cilat zhvillohen sipas LPK të vjetër dhe të ri, të shfrytëzohen në mënyrë që të lehtësohet manipulimi i sistemit, si dhe 4) keqpërdorimi i sistemit përmes qasjes direkte të personave të autorizuar, siç janë kryetarët e gjykatave.

Duke e pasur parasysh se asnjëherë nuk është bërë monitorim rrënjësor mbi funksionimin e sistemit AKMIS, Grupi i Ekspertëve propozoi të bëhet një monitorim i këtillë, pa ndërhyrje të politikës dhe nëse është e nevojshme me pjesëmarrjen e institucioneve dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë. Në bazë të kësaj, në Ministrinë e Drejtësisë u formua një Komision i veçantë për Shqyrtimin e Keqpërdorimeve të Mundshme të Sistemit AKMIS. Pas përfundimit të këqyrjes në funksionalitetin e sistemit informatikë dhe monitorimit të zbatimit të dispozitave të Rregullores gjyqësore nëpër gjykata, përkatësisht në sistemin AKMIS për vitin 2016 dhe 2017, zbatuar më datë 5 dhe 10 tetor të këtij viti në Gjykatën Themelore Shkup 1, më datë 9 nëntor në Gjykatën e Apelit Shkup dhe më 17 nëntor në Gjykatën Supreme, u prezantua Raporti përfundimtar,⁸⁹ i cili në janar të vitit 2018 iu dërgua PPRM për procedim të mëtutjeshëm.⁹⁰

88 Vlerësim dhe rekomandime nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë për çështje sistimore për sundimin e së drejtës 2017, f. 5

89 Shkarkuar më datë 30.01.2018, <https://goo.gl/Jz398e>

90 Në mungesë të hetimit zyrtarë dhe të dhënat nga i njëjti, dyshimet rreth parregullsive dhe paligjshmëri në funksionimin e Gjykatës Themelore Shkup 1 në kohën e kryesimit të gjyqtarit Vladimir Pançevski në mënyrë plotësuese u rritën në publik pas bastisjes së kryer në zyrat e tij, si dhe në shtëpinë e tij gjatë muajit tetor 2017 nga ana e ekipit të PSP në kuadër të procedurës parahetimore në të cilën të dyshuar janë Pançevski dhe dy persona të informatikës, ndërsa në lidhje me keqpërdorimin e sistemit kompjuterik gjatë ndarjes së lëndëve, dhe sidomos të atyre të PSP, shih: http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04801/mk/Mreza-23-mesecen-pregled-oktomvri-2017_MKD.pdf

Përgjegjësia

■ Shkarkimi dhe përcaktim i përgjegjësive

Këtë që e thamë më lartë e imponon nevojën për paanshmëri dhe përgjegjësi më të madhe gjatë veprimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, përmes respektimit më të madh të standardeve etike profesionale të juristëve dhe përcaktim të përgjegjësive së tyre disiplinore në procedurë përkatëse dhe të ndershme.

Gjatë periudhës së analizës gjithsej u shkarkuan 18 prokurorë publikë. Nuk ka prokurorë publikë të shkarkuar sipas procedurës së zbatuar për përcaktimin e përgjegjësive për shkelje të kryer më të rëndë disiplinore. Nuk është miratuar asnjë vendim, me të cilin nuk është konfirmuar vendimi i shkallës së parë të Prokurorit Publik të RM-së për shkarkimin e prokurorëve publikë sipas procedurës së zbatuar për përcaktimin e përgjegjësive për shkelje të kryer më të rëndë disiplinore. Nuk janë miratuar vendime për largimin e përkohshëm nga funksioni prokurorë publik, ndërsa janë miratuar 36 vendime për pezullimin e funksionit.⁹¹

Pakënaqësia shumëvjeçare nga mënyra e ushtrimit të funksionit të Prokurorit Publik, Marko Zvërlovski rezultoi me shkarkimin e tij nga shumica e sapoformuar parlamentare më 17 gusht të vitit 2017 me arsyetimin se një gjë e këtillë propozohet "...për shkak të ushtrimit të kundërligjshëm, jo në kohë dhe në mënyrë të pamjaftueshme profesionale të funksionit... për shkak të mosparaqitjes së kërkesës për ngritjen e procedurës penale për raste të parapara me ligj dhe për shkak të cenimit të reputacionit të funksionit".⁹² Paraprakisht, Këshilli i Prokurorëve Publikë me shumicë të votave (8 kundrejt 1) e pranoi propozimin e Qeverisë për shkarkim pa i arsyetuar shkaqet për këtë.⁹³ Në mbledhjen e njëjtë për u.d. Prokuror Publik, Këshilli e zgjodhi Liljana Spasovska, zëvendësen e Zvërlovskit.⁹⁴ Qeveria në mbledhjen e 36-të miratoi Konkluzion që t'i propozoj Kuvendit për prokurorë të ri publik ta emëroj Lubomir Joveski, anëtar i Këshillit të Prokurorëve Publikë në bazë të biografisë së tij profesionale, si dhe në bazë të mendimit pozitiv të Këshillit të Prokurorëve Publike,⁹⁵ dhe pas kësaj, më 25 dhjetor të vitit 2017 ai u zgjodh për Prokuror Publik Shtetëror.

Pas numrit të madh të shkarkimit të gjyqtarëve gjatë viteve të kaluara, në vitin 2016 vazhdoi tendenca e numrit të pakonsiderueshëm të lëndëve në të cilat Këshilli Gjyqësor konstatoi përgjegjësi disiplinore të gjyqtarëve për shkak të shkeljes së rëndë disiplinore, ushtrim joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit. Kështu, gjatë vitit 2016 Këshilli Gjyqësor ka vepruar ndaj tri kërkesave për ngritjen e procedurës së këtillë, të paraqitura nga Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësive së Gjyqtarit (në tekstin në vijim: Këshilli i Fakteve).⁹⁶ Reagime nxiti edhe vendimi i Këshillit Gjyqësor për heqjen e imunitetit të pesë gjyqtarëve nga Gjykata Administrative të akuzuar në lëndën "Titanik 2", e cila është në kompetencë të PSP që ka të bëjë me parregullsitë zgjedhore të zgjedhjeve lokale të vitit 2013.⁹⁷ Në mënyrë plotësuese në dhjetor të vitit 2018, Këshilli Gjyqësor edhe një herë e shkarkoi gjyqtarin e Apelit, Mitrinovski, për të cilin Gjykata e Strasburgut vendosi se procedura e shkarkimit të tij në vitin 2011 nuk ka qenë e ligjshme.⁹⁸ Këshilli veproi sipas udhëzimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e

91 Raporti i parë i monitorimit "Reforma në gjyqësor – nga Pribe 1 deri në Pribe 2 dhe më pas", f. 5, i aksesshëm në: <https://goo.gl/Bqq7P6>

92 Materialet nga seanca plenare e Kuvendit të RM-së, të aksesshëm në: <https://goo.gl/jpdX5y>

93 <http://www.24vesti.mk/soveto-na-javni-obviniteli-go-prifati-predlogot-za-razreshuvanje-na-zvrlovski>, i aksesshëm në datën 13.06.2017

94 Deklaratë e Anevski-it, e aksesshme në: <http://telma.com.mk/vesti/anevski-podnese-ostavka-od-lichni-prichini>, e shkarkuar në datën: 30.08.2017 r.

95 Komunikatë e Qeverisë për mbledhjen e 36-të, e aksesshme në: <http://vlada.mk/node/13644>

96 Raport vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016, f. 9, i aksesshëm në linkun: <https://goo.gl/AH38UL>

97 Komunikatë e Këshillit Gjyqësor, e aksesshme në: <https://goo.gl/7fXRR4>

98 Komunikatë e Këshillit Gjyqësor, e aksesshme në: <https://goo.gl/cZvZJP>

Njeriut dhe në bazë të kërkesës së aplikuesit e përsëriti procedurën pasi që Gjykata e Strasburgut vlerësoi se paraqitësi i iniciativës për shkarkimin e Mitrinovski, kryetari i Gjykatës Supreme Vangellovski, ka marrë pjesë edhe gjatë votimit si anëtar i Këshillit, me ç'rast vendimi për shkarkim ka qenë i njëanshëm.⁹⁹

Përveç Këshillit Gjyqësor edhe Këshilli i Fakteve vazhdoi të punoj në mënyrë jotransparente, pa i publikuar komunikatat për seanca publike dhe i njëjti akoma nuk ka ueb faqe të vet meqë Këshilli Buxhetor Gjyqësor nuk ka realizuar prokurim publik adekuat për një gjë të këtillë.¹⁰⁰ Ky Këshill u formua në vitin 2015 me detyrë që të veprojë në bazë të ankesave dhe parashtresave kundër gjyqtarëve si organ i veçantë hetues në drejtim të ndarjes së fazave të caktuara në procedurën e përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarit (ngritje të procedurës, zbatim të hetimit dhe vendimmarrje për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit). Meqë formimi i tij, që në fillim, nga ana e publikut profesionistë u vlerësua si një veprim i panevojshëm, ndërkaq kjo u konfirmua edhe gjatë punës së tij të deritanishme, në përputhje me planin “3-6-9”, si dhe konform Strategjisë për reforma në sektorin e jurisprudencës u parashikua suspendimi i tij.¹⁰¹

Në këtë drejtim, Kuvendi më 11 janar të vitit 2018¹⁰² e miratoi Ligjin për anulimin e Ligjit për Këshillin e Përcaktimit të Fakteve dhe Ngritjes së Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit. Qëllimi kryesor i Ligjit është kthimi i kompetencës për zbatimin e procedurës disiplinore të Këshillit Gjyqësor, duke mbajtur llogari për vërejtjet dhe udhëzimet e institucioneve ndërkombëtare në pjesën e reformave të sistemit të jurisprudencës. Në përputhje me ndryshimet në pjesën e inicimit të procedurës kundër gjyqtarëve të caktuar nga ana e Këshillit Gjyqësor, do të tentohet që anëtarët e Këshillit Gjyqësor të cilët e kanë ngritur procedurën, si “akuzues” të mos involvohen në miratimin e vendimit si “gjyqtarë”. Zgjidhja e këtillë është në përputhje me qëndrimin e Komisionit të Venecias, si dhe me praktikën e vendosur të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.¹⁰³ Në mënyrë që të mos kemi dyshime (pa u prezantuar publikisht nga kryetari i Këshillit Gjyqësor të RM), në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare duhet të shtohet një dispozitë në lidhje me procedurat e ngritura për përgjegjësi disiplinore dhe për shkarkimin e gjyqtarit nga ana e Këshillit për Përcaktimin e Fakteve për Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit të cilat në datën e anulimit të tij 18.01.2018 kanë qenë në fazë të procedimit në KGJRM, do të vazhdojnë të zhvillohen sipas rregullave të procedurës të parashikuara në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KGJRM nr. 197/2017.

Një hap drejt avancimit të standardeve etike në sistemin gjyqësor është edhe vendimi i Këshillit Drejtues të Shoqatës së Gjyqtarëve i datës 25.01.2018 t'i zgjedh anëtarët e trupit këshillëdhënës për etikën gjyqësore i cili është parashikuar në kuadër të Kodeksit të etikës gjyqësore të gjyqtarëve. Ky trup ka karakter këshillëdhënës për çështje që kanë të bëjnë me cenimin e parimeve të Kodeksit të gjyqtarit dhe numëron 7 (shtatë) anëtarë.¹⁰⁴

99 E shkarkuar nga: <http://www.sudstvo.mk/2017/12/29/митриновски-разрешен-по-втор-пат/>, e aksesshme 09.01.2018

100 Raporti i parë i monitorimit “Reforma në gjyqësor – nga Pribe 1 deri në Pribe 2 dhe më pas”, f. 5, i aksesshëm në: <https://goo.gl/Bqq7P6>

101 Në drejtim të shfuqizimit të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe marrjen e kompetencave të tij nga ana e Këshillit Gjyqësor ishin edhe deklaratat e ministrit të Drejtësisë, të cilat u postuan në këtë link: <https://www.plusinfo.mk/vest/121365/na-sudskiot-sovet-kje-mu-se-vratat-site-nadleznosti>.

102 Mbledhja e Kuvendit të RM-së, 11.01.2018, <https://goo.gl/zm7nkp>

103 Para qasjes së suspendimit të tij, Këshilli për Fakte deri te Këshilli Gjyqësor paraqiti propozim me të cilin kërkoi të shkarkohet Këshilli penal pesë-anëtarësh i Gjykatës Supreme, i cili vendoste për paraburgimin e biznesmenit Sead Koçan për shkak të veprimit joprofesional dhe të pandërrjegjshëm të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit në Shkup dhe të Gjykatës Supreme. <https://goo.gl/E9JXoR>

104 Komunikatë e Shoqatës së Gjyqtarëve, e aksesshme në: <https://goo.gl/NMCKaB>

Vendimet e Këshillit Gjyqësor, përkatësisht Këshillit të Prokurorëve Publikë me të cilët përcaktohet përgjegjësia disiplinore dhe shkarkimi i gjyqtarëve, përkatësisht të prokurorëve publikë duhet të arsyetohen në mënyrë të qartë dhe në masë të kënaqshme.

Në drejtim të rritjes së përgjegjësisë së gjyqësorit janë edhe ndryshimet e propozuara ligjore të Ligjit për gjykata dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor. Megjithatë, një pjesë e organizatave qytetare dhe publiku profesionistë janë të mendimit se nevojitet precizim plotësues të bazave për përgjegjësinë e gjyqtarëve.

Nevojitet zbatim konsekuent të kodekseve etike të gjyqtarëve, prokurorëve dhe të punësuarve në prokuroritë publike. Në mënyrë plotësuese, gjyqtarët dhe prokurorët publikë duhet të përmbahen nga deklarata publike të cilat e vënë në pikëpyetje paanshmërinë e gjyqtarëve, përkatësisht të prokurorëve publikë.

Heqja e imunitetit të gjyqtarëve duhet të jetë masë e nevojës së fundit e cila do të zbatohet në raste jashtëzakonisht të rralla.

Duhet të sigurohet shpërndarje e paanshme e lëndëve (veçanërisht kur bëhet fjalë për raste penale sensitive të profilit të lartë) përmes garantimit të funksionimit papengës të sistemit AKMIS. Nevojitet realizimi i kontrollit të rregullt dhe revizionit mbi funksionimin e tij, me qëllim që të parandalohen keqpërdorimet e çdo lloji të sistemit.

Profesionalizmi, kompetenca dhe efikasiteti

Kualiteti i drejtësisë

Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë

Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë (AGJPP) në vazhdimësi e avancohet dhe modernizon kurikulën e vet dhe kualitetin e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, edhe pse ekziston nevoja për përmirësimin e të njëjtave.¹⁰⁵ Në bazë të evaluimit të trajnimeve hartohet edhe programi kuadër, i cili u dërgohet gjykatave, Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë, me qëllim që të perceptohen nevojat reale të trajnimeve. Për përmirësimin e kualitetit të trajnimeve, nevojitet që Akademia të ketë në dispozicion ligjërues/lektor të përhershëm të cilët do të punojnë në përbërjen e saj dhe do të përgatisin materiale për ligjëratat dhe studimet e rastit. Sipas Akademisë, ndryshimet e Ligjit për AGJPP duhet të bëhen në mënyrë paralele me ndryshimet e Ligjit për gjykatat. Në këtë mënyrë, do të rregullohej angazhimi i punës së praktikientëve (gjyqtarë) të cilët do të punojnë në AGJPP për një periudhë kohore të caktuar si ligjërues, me ç'rast nuk do të kenë problem të avancohen në karrierë. Problemi i angazhimit të ligjëruesve të cilët do të punojnë në kuadër të AGJPP, para së gjithash, ka të bëjë me praktikientët dhe jo me profesorët.¹⁰⁶

105 Sipas njoftimeve të marra nga Akademia, vetëm gjatë periudhës nga maji 2016 deri në gusht të vitit 2017 janë realizuar dhe zhvilluar 336 trajnime dhe këshillime me pjesëmarrjen e 7920 personave, nga të cilët 3329 gjyqtarë, 1109 prokurorë publikë dhe 2208 nëpunës gjyqësorë dhe nëpunës të prokurorive publike, me shënimin se nëse një person merr pjesë në më shumë trajnime, kjo do të konsiderohet disa herë në varësi nga numri i trajnimeve dhe këshillimeve të vizituara. Për nevojat e trajnimit janë angazhuar 25 ligjërues në fushën juridike-civile dhe 33 në fushën juridike-penale. Pasqyra e detajuar e evaluimit të trajnimeve është dhënë në raportet vjetore të AGJPP.

106 Raporti i monitorimit të dytë për PRU në pjesën e jurispruencës, i aksesshëm në: - <http://epi.org.mk/docs/Vtor%20monitoring%20izvestaj%20-%20itni%20reformi%20vo%20sudstvoto.pdf>

Roli i Akademisë në zgjedhjen e kandidatëve të rinj për gjyqtarë dhe prokurorë publikë u problematizua me fillimin e vonuar të trajnimit fillestar të gjeneratës së 6-të prej 37 dëgjuesve në mars të vitit 2017,¹⁰⁷ ndërsa si rezultat i procedurave të zbatuara sipas ankesave para Gjykatës Administrative. Më 30 gusht të vitit 2016, Akademia shpalli konkurs dhe bëri thirrje për pranimin e 60 dëgjuesve, kandidatë për prokurorë publikë, në përputhje me ndryshimet ligjore të vitit 2015, e që nxiti situata kontroverze në publik me vet faktin që në konkurs u paraqitën rreth 30 kandidatë si dëgjues për të cilët ka baza për dyshim se kanë dorëzuar diploma të falsifikuara për njohjen e gjuhëve të huaja. Në dhjetor të vitit 2017 Këshilli Drejtues i AGJPP e anuloi konkursin.¹⁰⁸ Për tejkalimin e këtyre problemeve,¹⁰⁹ tek publiku profesionist ekzistojnë mendime se duhet të bëhen ndryshime ligjore në drejtim të kufizimit të origjinës së certifikatave për njohjen e gjuhës vetëm për testuesit e autorizuar në shtet ose testi i gjuhës të jetë në kuadër të provimit pranues në AGJPP.

Këshilli Drejtues e ndryshoi dy herë rregulloren për trajnimin fillestar, e cila u miratua në shkurt të vitit 2017 në pjesën e mësimin teorik, para se të zbatohet provimi i kontrollit të njohurive të gjeneratës së gjashtë të dëgjuesve.¹¹⁰ Me këto ndryshime u lehtësua mënyra e fitimit të pikëve dhe dhënies së testit të njohurive. Në kundërshtim me Rregulloren u publikuan studime të rastit me pyetje të ofruara. Edhe më tutje, dhënia elektronike e provimit lë hapësirë për dyshime, sa i përket asaj se a e arrin qëllimin e vlerësimit të aftësive praktike të dëgjuesve.¹¹¹

Buxheti i AGJPP për vitin 2017 ishte 41.125.000,00 denarë, ndërsa pas rishikimit të Buxhetit u zvogëlu në 38.415.000,00, në vend që i njëjti të rritet, që është e nevojshme për shkak të implikimeve financiare të cilat rezultojnë nga dispozitat ligjore të vitit 2015, si dhe për shkak të rritjes së kualitetit të trajnimeve dhe përmirësimit të mundësive teknike dhe infrastrukturore. Njëkohësisht, nevojitet rritja e kompensimit të anëtarëve të Këshillit programor, duke e pasur parasysh vëllimin dhe përgjegjësinë e punës së tyre.¹¹² Ndryshimet e propozuara të Ligjit për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, të publikuara në ENER në janar të vitit 2018¹¹³ më së shumti kanë të bëjnë me kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë anëtarët e organeve të AGJPP.

Në draft - Strategjinë e reformës së sektorit të jurisprudencës, sa i përket Akademisë ishte parashikuar një përqindje e caktuar e kuadrove për gjyqtarë dhe prokurorë publikë të zgjidhen nga radhët e juristëve me përvojë dhe jo vetëm nga AGJPP. Për dallim nga kjo me Raportin e fundit të Grupit të Rajnhard Pribe rekomandohet se Akademia duhet të mbetet burimi i vetëm i kuadrove në mënyrë që të mos përsëriten keqpërdorimet nga e kaluara. Në versionin final të Strategjisë është parashikuar rekrutimi i kuadrove nga rang lista e të diplomuarve në AGJPP.¹¹⁴ Megjithatë, Strategjia parashikon analizë për krijimin eventual të programit të ri për trajnim të veçantë fillestar për praktikientë me përvojë shumëvjeçare, që do t'i përfshinte edhe bashkëpunëtorët profesionistë me përvojë, si dhe për trajnime të vazhdueshme përmes ridefinimit të programeve dhe metodave për realizimin e trajnimeve. Në këtë Strategji është parashikuar edhe inkorporimi i kritereve të reja ligjore sa i përket përbërjes së organeve drejtuese dhe udhëheqëse të AGJPP, si dhe ekipim kadrovik dhe teknik dhe sigurimin e kushteve përkatëse hapësinore.¹¹⁵

107 Komunikatë e AGJPP, e aksesshme në: <http://www.jpacademy.gov.mk/novosti/aae---6----->

108 Komunikatë e AGJPP, e aksesshme në: <http://www.jpacademy.gov.mk/novosti/10444>

109 Raporti i monitorimit të dytë për PRU në pjesën e jurisprudencës, i aksesshëm në: <http://epi.org.mk/docs/Vtor%20monitoring%20izvestaj%20-%20itni%20reformi%20vo%20sudstvoto.pdf>

110 <http://www.jpacademy.gov.mk/za-akademijata-mk/zakon-i-podzakoni-akti>

111 Raporti i monitorimit të dytë për PRU në pjesën e jurisprudencës, i aksesshëm në: <http://epi.org.mk/docs/Vtor%20monitoring%20izvestaj%20-%20itni%20reformi%20vo%20sudstvoto.pdf>

112 Ibid.

113 Propozim ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë <https://goo.gl/EpM7XF>

114 Strategjia për reforma në sektorin e jurisprudencës për periudhën kohore 2017 – 2022 me Plan Veprim, f. 7

115 Ibid. f. 15

Në përputhje me Strategjinë janë propozuar ndryshime ligjore sa u përket kritereve të reja ligjore për përbërjen e organeve drejtuese dhe udhëheqëse të AGJPP. Ndryshimet e propozuara janë veçanërisht të rëndësishme nëse merret parasysh se mandatet e anëtarëve të KD të AGJPP dhe të drejtorëve kanë skaduar. Në mënyrë plotësuese, kriteret për njohjen e gjuhës angleze të anëtarëve të Këshillit programor kontribuon në deficitin e ligjëruesve të kualifikuar nga të gjitha nivelet e gjyqësorit dhe Akademisë.

Sa i përket ekipimit kadrovik,¹¹⁶ edhe pse në vitin 2016 u zgjerua sistematizimi në 47 vende pune, në AGJPP ka gjithsej 18 të punësuar prej të cilëve 16 nëpunës administrativë dhe 2 të punësuar në përputhje me LMP, ndërsa në 9 vitet e fundit janë zbrazur 15 vende pune të cilat akoma nuk janë plotësuar.¹¹⁷

AGJPP vendosi praktikë që të dërgoj gjyqtarë, prokurorë publikë, kandidatë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë, si dhe përfaqësues të organeve dhe shërbimit profesional të Akademisë, të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vizita studimore, në trajnime ndërkombëtare, shkëmbime, takime, punëtori dhe konferenca ndërkombëtare.¹¹⁸ Akoma nuk i ka zgjedhur kandidatët nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë pas konkursit të shpallur më datë 12.04.2016 për dërgimin e 2 kandidatëve në një qëndrim 6-mujor dhe punë në GJEDNJ, edhe pse që në vitin 2016 ishte përgatitur lista e gjyqtarëve dhe prokurorëve pas dhënies së pikëve të kandidatëve nga ana e Këshillit Drejtues të AGJPP dhe e njëjta listë u dërgua në Strasburg.¹¹⁹

Monitorimi dhe evaluimi i aktiviteteve gjyqësore

Praktika gjyqësore

Pas vonesës njëvjeçare, Gjykata Supreme përfundimisht e lëshoi në përdorim portalin gjyqësor elektronik <http://www.sud.mk/> në të cilin duhet të publikohen të gjitha vendimet gjyqësore, por ai në të vërtetë është jofunksional, ka një numër të vogël të vendimeve, ndërsa nuk dihet nëse vendimet e aksesshme janë të plotfuqishme, të modifikuara, të shfuqizuara ose të anuluar. Për këtë shkak, ky portal nuk kontribuon në drejtim të avancimit të praktikës gjyqësore dhe sigurisë juridike.

Në përputhje me anketën e fundit¹²⁰ e cila u realizua për publikimin e vendimeve gjyqësore dhe për funksionalitetin e ueb portalit sud.mk. në të cilën u anketuan 224 avokatë, u konstatua se pjesa më e madhe e vendimeve gjyqësore nuk zbatohen në kohë. Sipas 55% të të anketuarve, gjykatat rrallëherë ose asnjëherë nuk i publikojnë vendimet gjyqësore në afatet ligjore. Sipas 30% e të anketuarve, portali www.sud.mk nuk është funksional për kërkime dhe njoftime, por është më i mirë nga portalet e veçantë të gjykatave. Me ato nuk pajtohen 32.5% e avokatëve, të cilët janë përgjigjur se më të mirë kanë qenë portalet e veçanta të gjykatave. Për atë se portali është funksional për kërkime dhe njoftime u përgjigjën 21.4% e të anketuarve. Megjithatë, nuk duhet të neglizhohet e

116 Për shkak të deficitit të kuadrit nuk ka specializim të punës, nuk ka seksione të plotësuar. Në mënyrë plotësuese nuk avancohen të punësuarit dhe nuk janë të stimuluar. AGJPP ka pajisje teknike, por e njëjta është e vjetruar dhe ka shpenzime të mëdha për riparim dhe amortizim. Nevojitet godinë e re, salla për trajnim fillestar nuk është e përshtatshme për nevojat e dëgjuesve të trajnimit fillestar. Nevojiten furnizime dhe vëllim më i madh i literaturës dhe hapësirës për lexim. Raporti i dytë i monitorimit, i aksesshëm në: <http://epi.org.mk/docs/Vtor%20monitoring%20izvestaj%20-%20itni%20reformi%20vo%20sudstvoto.pdf>.

117 Ibid.

118 Raporti vjetor i AGJPP për vitin 2016, i aksesshëm në: <https://goo.gl/rjHn4f>

119 Raporti i dytë i monitorimit të PRU në pjesën e jurisprudencës, i aksesshëm në: <http://epi.org.mk/docs/Vtor%20monitoring%20izvestaj%20-%20itni%20reformi%20vo%20sudstvoto.pdf>

120 Shih më shumë: Raporti i parë i monitorimit "Reformat në gjyqësor – nga Pribe 1 deri në Pribe 2 dhe më pas, f. 8-9, i aksesshëm në: <https://goo.gl/BqQ7P6>

dhëna se 15.6 % e të anketuarve janë përgjigjur se nuk janë të njoftuar me portalin, përkatësisht se i njëjti nuk azhurohet rregullisht dhe se duhet të jetë i aksesshëm për kërkime përmes google.com. Në vitin 2016 instanca më e lartë gjyqësore në shtet ka miratuar 6 mendime juridike parimore e që është një hap pozitiv nga aspekti i barazimit të praktikës gjyqësore vendore.¹²¹ Pastaj, kjo gjykatë ka qenë aktive edhe në fushën e legjislacionit, kështu që në mbledhjen e gjyqtarëve dhe në mbledhjen e përgjithshme, me iniciativë të vet ka shqyrtuar dhe ka dërguar konkluzione në lidhje me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për gjykatat dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë. Nga ana tjetër, Ministria e Drejtësisë vetëm në një rast ka kërkuar mendim nga mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme në lidhje me ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores gjyqësore, ndërsa nga kjo ministri si propozuese e ligjeve nuk është kërkuar mendim nga mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme për cilindo qoftë propozim ligji.

Metoda alternative për zgjidhjen e kontesteve

Zbatimi i mënyrave alternative për zgjidhjen e kontesteve në Republikën e Maqedonisë është në nivel të pakënaqshëm. Pavarësisht nivelit të zbatimit të mënyrave alternative monitorim të punës së institucioneve dhe personave të cilët merren dhe i mbështesin këto metoda të zgjidhjes së kontesteve, në mënyrë që të perceptohet gjendja momentale në këtë fushë. Monitorimi, i cili është në drejtim të promovimit dhe zhvillimit të zgjidhjes alternative të kontesteve, para së gjithash, e përfshinë praktikimin e ndërmjetësimit nga ana e ndërmjetësuesve të licencuar, veprimin e gjykatave në pjesën e zbatimit të dispozitave të Ligjit për ndërmjetësim, Ligjit për procedurë kontestimore dhe Ligjit për marrëdhënie detyimore, veprimi i pajtuesve gjatë zgjidhjes së kontesteve të punës, arbitrave në procedurat e arbitrazhit dhe veprimi i të gjitha palëve të interesuara, të cilat kanë marrë pjesë në zgjidhjen e kontesteve përmes zbatimit të metodave alternative.¹²²

Edhe krahas ndryshimeve të Ligjit për ndërmjetësim, kemi një shfrytëzim të pamjaftueshëm¹²³ të këtij koncepti dhe akoma ekziston mungesë e ndërmjetësuesve të licencuar, para së gjithash, për shkak të provimit kompleks dhe joadekuat për ndërmjetësues.¹²⁴ Kjo mungesë përsëritet me vite të tëra edhe në raportet e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë. Nevojitet promovim më i fuqishëm i ndërmjetësimit nga institucionet kompetente me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit institucional të gjykatave në RM dhe me institucione të tjera shtetërore.¹²⁵ Në Strategjinë e reformave të sektorit të jurisprudencës¹²⁶ janë parashikuar ndryshime ligjore, në pjesën e provimit për ndërmjetësues, me qëllim të rishikimit të tij, që të merren parasysh kompetencat dhe aftësitë e nevojshme të cilat ata duhet t'i posedojnë; inkorporimin e dërgesës elektronike gjatë ndërmjetësimit, harmonizimin e mbajtjes së regjistrave për procedurat e ndërmjetësimit, të cilët i mban Ministria e Drejtësisë dhe ndërmjetësuesit; si dhe përdorimi i shpeshuar i ndërmjetësimit nga ana e organeve publike përmes mundësimit të presupozimeve dhe stimulimit të organeve publike t'i zgjidhin situatat e tyre kontestuese përmes ndërmjetësimit. Është detektuar edhe nevoja e promovimit të përfitimeve nga ndërmjetësimi me qëllim të përforcimit të vetëdijes, në përputhje me Direktivën e KE për ndërmjetësim në kontestet civile dhe tregtare nga vitet 2008 dhe Direktivën për ndërmjetësim në kontestet e konsumatorëve.

121 Këto dhe të gjitha të dhënat e tjera në lidhje me punën e Gjykatës Supreme janë prezantuar më poshtë në këtë Raport janë marrë nga ana e tij në përgjigjen e kërkesës për qasje në informata me karakter publik drejtuar Komitetit të Helsinkit.

122 Raporti tematik i projektit "Monitorimi i sundimit në fushën e drejtësisë (JuDGMeNT)", i aksesshëm në: <https://goo.gl/u9wMqT>

123 Kanë përfunduar mbi 1000 lëndë të ndërmjetësimit, nga të cilat 80% janë vullnetare dhe jo të detyrueshme.

124 Strategjia për reforma në sektorin e jurisprudencës për periudhën kohore 2017-2022, e aksesshme në: <https://goo.gl/SGLRxq>

125 Raporti tematik i projektit "Monitorimi i sundimit në fushën e drejtësisë (JuDGMeNT)", i aksesshëm në: <https://goo.gl/u9wMqT>

126 Strategjia për reforma në sektorin e jurisprudencës për periudhën kohore 2017-2022, e aksesshme në: <https://goo.gl/SGLRxq>

Në dhjetor të vitit 2017 Qeveria e RM-së mori vendim, me të cilin u emërua kryetari i ri dhe anëtarët e Këshillit për sigurimin, monitorimin dhe vlerësimin e kualitetit të punëve të ndërmjetësimit.¹²⁷ Në muajin e njëjtë, Gjykata Kushtetuese mori vendim me të cilin shfuqizohet neni 2 i Rregullores për dhënie e provimit për ndërmjetësues, i cili ka të bëjë me përcaktimin esesioneve të provimit përgjatë një viti kur i nënshtrohen provimit për ndërmjetësues.¹²⁸ Sipas Gjykatës Kushtetuese, me nenin e cekur të Rregullores, ministri i Drejtësisë i ka tejkaluar autorizimet ligjore, me ç'rast është cenuar sundimi i së drejtës si vlerë themelore e rendit kushtetues në RM, me ç'rast Gjykata vlerësoi se neni 2 i Rregullore nuk është në përputhje me nenin 8 paragrafin 1 alinën 3 dhe nenin 51 të Kushtetutës dhe me nenin 59 paragrafin 1 pikën v) të Ligjit për ndërmjetësim.¹²⁹

■ Buxheti dhe resurset

Nga aspekti i pavarësisë së gjyqësorit, vëmendje të veçantë meriton çështja e pavarësisë së tij financiare. Në Raportin për punën e Këshillit Buxhetor Gjyqësor dhe për realizimin e buxhetit gjyqësor për vitin 2016, i paraqitur në Kuvend në qershor të vitit 2017 u theksua se buxheti i miratuar për vitin 2016 nuk ka qenë i mjaftueshëm për përmbushjen e nevojave të pushtetit gjyqësor, me ç'rast shfrytëzuesit individual nuk kanë pasur mundësi të realizojnë një numër të caktuar të obligimeve të cilat janë të garantuara me ligj.

Në analizën e përpiluar nga Shoqata e Punonjësve Financiar – SHPF në kuadër të projektit “Rrjeti 23+” në mënyrë të detajuar është trajtuar problemi i financimit të pushtetit gjyqësor. Me Ligjin për buxhetin gjyqësor, miratuar në vitin 2003, është rregulluar se mjetet për pushtetin gjyqësor duhet të jenë më së paku 0,8% nga bruto prodhimi vjetor i RM-së, shumë kjo e cila sipas ndryshimeve dhe plotësimeve të atij Ligji në vitin 2010 duhej të arrihej që në vitin 2015. Megjithatë, analiza e SHPF dëshmon se niveli i mjeteve të planifikuara/realizuara nuk i tejkalon 0,38% të BPV. Sipas Raportit të SHPF, buxheti ideal gjyqësor do të ishte në lartësi jo më pak se 0,5% nga Buxheti i RM-së.¹³⁰

Për nevojat e këtij Raporti më 11.09.2017 deri në Këshillin Gjyqësor u dërgua Kërkesë për qasje në informatat me karakter publik në lidhje me buxhetin e përgjithshëm për gjyqësorin për vitin 2016 dhe 2017. Pas kësaj, pranuar njoftim se buxheti përfundimtar për gjyqësori, pas rishikimit të buxhetit në vitin 2017, ka qenë 1.865.111.000 denarë, e që është një reduktim i konsiderueshëm në krahasim me buxhetin prej 1.892.431.000 denarë të vitit 2016. I njëjti i përfshinë buxhetet e veçanta të Këshillit Gjyqësor, Këshillit për Përcaktimin e Fakteve, Gjykatës Supreme, katër gjykatat e apelit, të gjitha gjykatat themelore, Gjykatën Administrative dhe Gjykatën e Lartë Administrative, si dhe Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.

127 “Gazeta Zyrtare e RM” nr. 182/17

128 Megjithatë, sipas nenit 59 paragrafit 1 pikës V) të Ligjit për ndërmjetësim, Këshilli për sigurimin, ndjekjen dhe vlerësimin e kualitetit të punëve të ndërmjetësimit, në bazë të parimit të autonomisë dhe profesionalizmit i përcakton sesionet e provimeve për dhënie e provimit për ndërmjetësues.

129 “Gazeta Zyrtare e RM” nr. 193/17

130 Analiza është e aksesshme në linkun në vijim: http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/01238/mk/Analiza_ZFR.pdf

■ Shërbimi gjyqësor

Gjatë vitit 2016 janë realizuar 97 punësime të reja, ndërsa nga Ministria e Financave janë siguruar mjete për punësimin e 69 personave në administratën gjyqësore me kohë të caktuar dhe të 28 personave plotësues me kohë të pacaktuar. Krahas kësaj, edhe më tej shënohet mungesë e kuadrit përkatës, profesional në gjykata e që u nënvizua në Raportin vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor për vitin 2016.¹³¹

Në muajin nëntor të vitit 2016, Inspeksioni i punës i kontrollonte të dhënat e një nëpunësi gjyqësor nga Gjykata Themelore Shkup 1, i cili pohonte se është degraduar në shërbim për shkak se ka marrë pjesë në Revolucionin e Laramantë. Në kundërshtim me pohimet, Gjykata ua ka sqaruar inspektorëve se nëpunësi është avancuar por edhe krahas kësaj, veprimet e nëpunësit kanë rezultuar me çrregullimin e marrëdhënieve ndër njerëzore dhe për këtë është ngritur procedurë disiplinore e cila mund të rezultojë edhe me përgjegjësi penale. Në muajin e njëjtë, 11 nëpunës gjyqësorë të punësuar në Gjykatën e njëjtë nga Këshilli Gjyqësor dhe nga Këshilli për Fakte kërkuan të ndërmarrin masa kundër kryetarit të gjykatës Pançevskit. Të gjitha këto ngjarje hodhën edhe një njollë të errët mbi kredibilitetin e kësaj Gjykate dhe mbi statusin e nëpunësve gjyqësorë në përgjithësi.

Sipas iniciativës së Sindikatës së punëtorëve nga drejtoria, organet e jurisprudencës dhe shoqatave të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë (DOJSH) dhe procedurës paraprakisht të ngritur për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të Ligjit për shërbimin gjyqësor, Gjykata Kushtetuese e shfuqizoi nenin 144 të ligjit, i cili i obligonte nëpunësit gjyqësorë të paraqesin certifikata për njohjen e gjuhës së huaj dhe programeve kompjuterike.¹³² Sipas Gjykatës Kushtetuese, ligjvënësi marrëdhënien e punës tanimë të themeluar e determinon me kushte të reja të cilat janë ngritur në shkallë të përgjithshme pa u mbajtur llogari se në kohën kur i punësuarit e ka themeluar marrëdhënien e punës ato kushte nuk kanë qenë të parapara.

Duke e pasur parasysh gjendjen e vështirë dhe pamundësinë për realizimin e të drejtave të shërbimit gjyqësor, erdhi deri në grevë gjatë vitit 2016, e cila zgjati 62 ditë, dhe për këtë gjë grevistëve iu shkurtuan 40% nga paga. Një vit më vonë, në mars të vitit 2017, DOJSH dhe Shoqata e Administratës Gjyqësore (SHAGJ) kërkuan dorëheqje nga Kryetari i Këshillit Gjyqësor meqë Këshilli dhe Ministria e Drejtësisë nuk e morën në konsideratë kërkesën e vetme të grevistëve – të punësuarit nëpër gjykata të marrin shtesë në pagë.

■ Efikasiteti

Pas zvarritjeve të gjata, Raporti vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016 u shqyrtua dhe miratua në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik të vitit 2017. Në këtë Raport janë përfshirë të dhënat për punën e Këshillit Gjyqësor në aspekt të numrit të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë të shkarkuar, procedurave për përcaktimin e kryerjes joprofesionale të profesionit, vlerësimit të punës së gjyqtarëve, informacioneve për veprim ndaj parashtresave nga ana e qytetarëve dhe të dhënave të tjera për punën e gjykatave në RM. Sa u përket lëndëve të vjetra, numri më i madh i lëndëve të cilat janë më të vjetra se 7 dhe 10 vjet ka në Gjykatën Themelore Shkup 2, Gjykatën Themelore Shkup 1 dhe në Gjykatën Themelore të Kumanovës.¹³³

131 Raporti vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor për vitin 2016, f. 23 dhe 24 të Raportit.

132 Komunikatë e Sindikatës së DOJSH, e aksesshme në: http://www.upoz.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=428:-144-&catid=1:latest-news

133 Raporti i monitorimit të parë "Reforma në gjyqësor – nga Pribe 1 deri në Pribe 2 dhe më pas, f. 8-9, i aksesshëm në: <https://goo.gl/Bq7P6>

Sipas të dhënave të prezantuara në Raportin vjetor që kanë të bëjnë me azhurnitetin e gjykatave vendore, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë¹³⁴ nuk ka qenë azhure dhe efikase gjatë trajtimit të lëndëve, kështu që nuk i ka zgjidhur të gjitha lëndët e prapambetura, madje nuk ka arritur të përballet edhe me prurjen e lëndëve të sapo pranuar, dhe për këtë kjo gjykatë e ka rritur numrin e lëndëve të prapambetura për 157. Për dallim nga kjo Gjykatë, Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë Administrative u treguan si efikase në zgjidhjen e lëndëve.

Analiza e mëtutjeshme e Këshillit Gjyqësor, sa u përket situatave me lëndët, sipas juridiksioneve të gjykatave të apelit dëshmon se me përjashtim të juridiksionit të gjykatës së Apelit - Gostivarit, e cila vlerësohet si jo azhure dhe joefikase, tre juridiksionet e tjera të gjykatave të apelit kanë pasur sukses ta zgjidhin numrin e lëndëve dhe ta reduktojnë numrin e lëndëve të prapambetura e të pazgjidhura nga vitet paraprake.

Veçanërisht duhet të theksohet si pozitiv vendimi i Këshillit Gjyqësor përmes kryetarëve të gjykatave të ndërmerren masa në drejtim të reduktimit të lëndëve të prapambetura në gjykata, të cilat janë kategorizuar në tre grupe, edhe atë si: lëndë më të vjetra se tre vjet, shtatë dhe dhjetë vjet. Në këtë kuptim, përmes kryetarëve të gjykatave, gjyqtarët të cilët veprojnë ndaj lëndëve, për të cilat procedura ka zgjatur më shumë se shtatë vjet, përkatësisht më shumë se dhjetë vjet, janë ngarkuar të përpilojnë plan me projeksion për zgjidhjen e çdo lënde. Theksohet se si rezultat i kësaj gjatë vitit 2016 janë zgjidhur 56,28% të lëndëve më të vjetra se 3 vjet, 43,56% të lëndëve më të vjetra se 7 vjet dhe 24,32% të lëndëve më të vjetra se 10 vjet, me çka në masë të konsiderueshme është reduktuar numri i lëndëve të prapambetura gjyqësore në nivel të shtetit.¹³⁵

Sa u përket lëndëve për gjykim në afat të arsyeshëm, numri i të cilave është tregues për efikasitetin, përkatësisht kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore, gjatë vitit 2016, departamenti për gjykim në afat të arsyeshëm në procedurë e sipër ka pasur gjithsej 818 (në të dyja shkallët e vendimmarrjes), prej të cilave 633 (77,3%) në shkallë të parë dhe 185 lëndë (22,6%) në shkallë të dytë (vendimmarrje sipas ankesës). Nga numri i përgjithshëm i lëndëve (818) gjatë vitit 2016 janë zgjidhur 490 lëndë, ndërsa në 170 prej tyre, kërkesa për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm është miratuar. Nga ana tjetër, shuma maksimale që është u është shqiptuar në emër të kompensimit të drejtë për shkak të cenimit të konstatuar të kësaj të drejte është 120.000,00 denarë (në shkallë të parë), përkatësisht 100.000,00 denarë (në shkallë të dytë), ndërsa shuma minimale ka qenë 3.000,00 denarë (në shkallë të parë), ose 5.000,00 denarë (në shkallë të dytë). Kompensimi i shqiptuar i përgjithshëm për cenimin e së drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm ka qenë 3.032.900,00 denarë (në shkallë të parë), përkatësisht 901.850,00 denarë (në shkallë të dytë) ose në të dyja shkallët e vendimmarrjes bashkërisht shuma e shqiptuar është 3.934.750,00 denarë, që i ka përfshirë si shumë të kompensimit të drejtë, si edhe shpenzimet e procedurës sipas kërkesës së paraqitur për gjykim në afat të arsyeshëm.

Në vitin 2017, përfundimisht me fundin e muajit gusht, në Gjykatën Supreme të RM gjithsej janë paraqitur 391 kërkesa për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm, prej të cilave 262 në shkallë të parë dhe 129 në shkallë të dytë. Në të dyja shkallët e vendimmarrjes gjithsej u zgjidhën 327 lëndë, prej të cilave 221 në shkallë të parë dhe 106 në shkallë të dytë, sipas ankesës së paraqitur.

134 Raporti vjetor për punën e KGJRM, i aksesshëm në: file:///C:/Users/Asus%20Notebook/Downloads/izvestaj_zarabotata_nassrm_2016.pdf

135 Pasqyra tabelore e këtyre të dhënave statistikore mund të shihet në faqen 19 të Raportit vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor për vitin 2016.

Ekzekutimi i aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Byroja për përfaqësimin e RM para GJEDNJ vazhdoi të bëjë përpjekje në drejtim të ekzekutimit të aktgjykimeve të miratuara në Strasburg, të cilat kanë të bëjnë me përgatitjen e plan veprimeve të detajuar dhe raporteve të cilët i përmbajnë masat e veçanta dhe të përgjithshme për implementimin e aktgjykimeve. Duke e pasur parasysh mosfunksionimin e Komisionit Ndërsektorial për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ dhe mos-çaktimi i mbledhjeve që nga muaji mars i vitit 2016, edhe pse ministri i Drejtësisë i cili udhëheq me këtë Komision ka obligim ligjor që të thërras mbledhje në çdo tre muaj, megjithatë i gjithë procesi është bllokuar. Në praktikë nuk është vërejtur ndonjë ndërhyrje më e rëndësishme në dispozitat ligjore të cilat janë konstatuar si burim i cenimeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, madje as ndryshime të tjera të rëndësishme në praktikën gjyqësore dhe administrative. Edhe më tutje, ekzekutimi i aktgjykimeve të GJEDNJ, kryesisht kanë të bëjë me pagesën e dëmshpërblimit monetar të shqiptuar me të njëjtët.

Në këtë kuptim, problem paraqet edhe pamundësia për përsëritjen e procedurave kontestuese vendore, në të cilat është bërë cenimi i Konventës. Një rast i këtillë, me më shumë aktgjykime të cilat e imponojnë nevojën e përsëritjes së procedurës gjyqësore vendore, si dhe aktgjykimet në të cilat tanimë është përcaktuar cenim i nenit 6 të GJEDNJ duke e pasur parasysh padrejtësinë e procedurës për shkarkimin e gjyqtarit. Edhe Këshilli Gjyqësor në Raportin e tij vjetor për vitin 2016 thekson se deri te ai janë adresuar gjashtë kërkesa për përsëritjen e procedurës me rastin e aktgjykimeve të miratuara të GJEDNJ, por për shkak të mospranimit të rekomandimit nga Komisioni Ndërsektorial në pesë raste Këshilli Gjyqësor e ka lejuar përsëritjen e procedurës, e cila është në rrjedhë e sipër vetëm për një rast për të cilin është pranuar rekomandimi.¹³⁶ Përkatesisht, bëhet fjalë për rastin e ish-kryetarit të Gjykatës së Apelit në Shkup, Jordan Mitrinovski, të cilit me aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut iu përcaktua shkelje të nenit 6 të GJEDNJ në procedurën e shkarkimit të tij nga ana e Këshillit Gjyqësor.¹³⁷ Megjithatë, përveç në këtë rast, as në pesë rastet e tjera në të cilat aplikantët, gjithashtu gjyqtarë të shkarkuar në mënyrë të padrejtë, kërkuan një gjë të këtillë, por nuk erdhi deri në përsëritjen e plotë të procedurës para Këshillit Gjyqësor në përputhje me standardet e përcaktuara të Konventës Evropiane dhe praktikës së Gjykatës së Strasburgut.

Duhet të bëhen ndryshime në Ligjin për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë në lidhje me kriteret për hyrjen e kandidatëve në trajnimin fillestar në AGJPP. Kjo, para së gjithash, ka të bëjë me kushtet për njohjen e gjuhës së huaj, si dhe me barazimin e kushteve për pranimin e dëgjuesve në trajnimin për gjyqtarë dhe prokurorë publikë, meqë me ndryshimet e Ligjit nga muaji dhjetor i vitit 2015 u bë një disbalanc midis zgjedhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë.

Është e domosdoshme analiza për krijimin e programit të ri për trajnim të veçantë fillestar për praktikantët me përvojë shumëvjeçare, si dhe për trajnimet e vazhdueshme përmes ridefinimit të programeve dhe metodave për realizimin e tyre. Me këtë do të përfshiheshin edhe bashkëpunëtorët profesionistë me përvojë si dhe praktikantët e tjerë me përvojë shumëvjeçare.

Nevojitet të rritet buxheti i AGJPP, për shkak të implikimeve financiare të cilat i ofrojnë zgjidhjet ligjore nga viti 2015, si dhe për shkak të faktit se AGJPP çdo vit buxhetor futet në borxhe.

Duhet të ndërpritet dhënia në mënyrë elektronike të provimeve të pjesës praktike.

136 Raporti vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016, f. 10.

137 Pasi kërkesa e tij për përsëritjen e procedurës vendase sipas aktgjykimin të GJEDNJ u mor në konsideratë, diskutimi para Këshillit Gjyqësor nga maji i vitit 2017 u shty në kohë të pacaktuar, me kërkesë të avokatëve të tyre për shkak të gjendjes së përkeqësuar shëndetësore, dhe për këtë shkak ai nuk mori pjesë në diskutim.

Kohëzgjatja e stazhit në GJEDNJ të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë nacional duhet të rritet për më së paku një vit, me qëllim që të fitojnë përvoja praktike të cilat do të mund t'i përvetësojnë.

Është e domosdoshme të përforcohet dialogu efektiv i ministrit të Drejtësisë me Sindikatën e punëtorëve të administratës, me organet e jurisprudencës dhe shoqatat e qytetarëve (DOJSH) me qëllim të përmirësimit esencial të statusit të nëpunësve gjyqësorë.

Nevojitet përmirësimi i funksionalitetit të portalit gjyqësor sud.mk, si dhe publikimi i aktgjykimi në portalin gjyqësor në afatin e përcaktuar me ligj, respektimi i udhëzimit për anonimizimin e aktgjykimeve si dhe të nënvizohet nëse të njëjtat janë të plotfuqishme ose jo.

Promovimi dhe përforcimi i vetëdijes publike për zgjidhjen alternative të kontesteve veçanërisht të ndërmjetësimit, me qëllim të shkarkimit të punës së gjykatave. Është e domosdoshme të zbatohet monitorim mbi punën e institucioneve dhe personave të cilët merren dhe i mbështesin këto metoda të zgjidhjes së kontesteve, në mënyrë që të perceptohet gjendja momentale në këtë fushë. Duhet të bëhen ndryshime në Ligjin për ndërmjetësim për shkak të tejkalimit të dobësive në këtë fushë.

Nevojitet aktivitet i bashkërenditur i ministrit të Drejtësisë me organet kompetente shtetërore në drejtim të ekzekutimit më të mirë dhe më efikas të aktgjykimeve të GJEDNJ të miratuara sa i përket Republikës së Maqedonisë, ndërkaq duke e pasur parasysh monitorimin standard dhe/ose të përforcuar mbi implementimin e tyre të cilës të njëjtit i nënshtrohen nga ana e Komitetit të Ministrave pranë Këshillit të Evropës nga njëra anë, si dhe nevojës për shmangien e cenimeve individuale, si dhe ndryshimeve të legjislacionit dhe anulimit të praktikave negative sistemore të cilat janë në linjën e cenimit të të drejtave të njeriut, nga ana tjetër.

2 Lufta kundër korrupsionit

Gjatë gjithë periudhës së raportimit pjesa më e madhe e organeve shtetërore kompetente për parandalimin dhe pengimin e korrupsionit, në të vërtetë e mbronin korrupsionin e lartë.

Përmes një numri të madh të hetimeve dhe procedurave të ngritura nga ana e PSP u zbardhën praktikat e mundshme korruptive të personave bartës të funksioneve publike, me ç'rast interesim të veçantë zgjoi edhe lënda "Titanik" në të cilën si të dyshuar janë ish-funksionarë të lartë të VMRO-DPMNE për parregullsi zgjedhore, lënda "Talir" në të cilën u hap hetimi që ka të bëjë me financimin e kundërligjshëm të partisë politike VMRO-DPMNE, si dhe lënda "Tenk" që ka të bëjë me furnizimin e automjetit zyrtar "Mercedes" me vlerë prej përafërsisht 600 mijë euro, por edhe shumë lëndë të tjera.

Megjithatë, me opstruksionet ndaj punës së PSP organet kompetente shtetërore në të vërtetë e pamundësuan zbatimin efikas të drejtësisë dhe e zvarritën momentin e nxjerrjes së rezultateve konkrete nga lufta kundër korrupsionit. Në këtë kuptim, edhe hulumtimi i zbatuar nga ana e Institutit për Politikë Evropiane dhe Komitetit të Helsinkit në kuadër të projektit "Rrjeti 23+" dëshmoi se madje 60% e të anketuarve mendojnë se gjendja momentale me luftën kundër korrupsionit është e keqe,¹³⁸ ndërsa sipas hulumtimit të zbatuar me nëpunësit shtetërorë,¹³⁹ 46% e tyre e japin vlerësimin e njëjtë. Së këtejmi, ata për një gjë të këtillë e locojnë shkakun në zbatimin jokonsekuent, joobjektiv dhe selektiv të ligjit. Madje 44% e tyre janë të mendimit se Republika e Maqedonisë nuk është e përgatitur për tu anëtarësuar në BE nga aspekti i luftës kundër korrupsionit, ndërsa dyfish më shumë (88%) besojnë se reformat në këtë fushë janë të rëndësishme për anëtarësimin tonë në BE.

Edhe nga vlerësimi i Sistemit Nacional për Integritet (SNI) të cilin e zbatoi Transparensi Interneshë-nëll-Maqedoni (TIM) rezulton se edhe krahas asaj që Republika e Maqedonisë ka kornizë të mirë juridike për luftë kundër korrupsionit, megjithatë vërehet zbatim i dobët i ligjeve anti-korrupsion, institucionet përgjegjëse për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit nuk udhëhiqen në mënyrë efektive, madje nuk janë edhe mjaftueshëm të pavarura që ta luftojnë korrupsionin, ndërkaq të njëjtave u mungon edhe integriteti.¹⁴⁰

Si shembull konkret, në të cilin dështoi veprimi i mekanizmave mbikëqyrës, mund të përmendet skandali me anëtarët e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) të cilët morën më shumë kompensime për vëllimin e tyre më të madh të punës për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të caktuara por të pa mbajtura në prill të vitit 2016, si dhe gjatë zbatimit të zgjedhjeve parlamentare në dhjetor të

138 Rezultatet e anketës janë të aksesshme në: http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/public_opinion_24_04_17/Istrazuvanje-na-javno-mislenje-poglavje-23-kratka-verzija.pdf

139 Rezultatet e anketës janë të aksesshme në: <http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/Poglavje-23-Anketa-na-administracija.pdf>

140 Transparensi Interneshë-nëll Maqedoni, Sistemi Nacional për Integritet – nota për Maqedoninë, maj 2006, f. 28, i aksesshëm në: http://www.transparency.mk/images/stories/NIS_mk.pdf

vitit 2016 e që hasi në kritika të ashpra nga publiku dhe e gjithë kjo rezultoi me dorëheqjet e tyre në muajin dhjetor të vitit 2016.¹⁴¹

Edhe pse Raporti i rrethit të katërt të evaluimit të Komitetit GREKO pranë Këshillit të Evropës, u miratua në mbledhjen e 62-të plenare të GREKO-s, të mbajtur më 6 dhjetor të vitit 2013, Republika e Maqedonisë akoma nuk ka ndërmarrë aktivitete në drejtim të implementimit të një pjese të rekomandimeve të theksuara në Raport. Përkatësisht, me Raportin e GREKO-s për vlerësimin e implementimit nga 1 korriku i vitit 2016, i publikuar më 12 tetor të vitit 2016, i cili ka të bëjë me luftën kundër korrupsionit në Kuvendin e RM-së, në gjyqësor dhe prokurorinë publike,¹⁴² është konstatuar se Republika e Maqedonisë në nivel të kënaqshëm ka zbatuar vetëm tre nga gjithsej nëntëmbëdhjetë rekomandime, dhjetë janë zbatuar pjesërisht, ndërsa gjashtë rekomandime nuk janë zbatuar fare.

Katër prej rekomandimeve për të cilat mungon implementimi i rekomandimeve të GREKO-s kanë të bëjnë me parandalimin e korrupsionit tek anëtarët e Kuvendit të RM-së, ndërsa dy rekomandimet e tjera të pazbatuara kanë të bëjnë me gjyqësorin dhe prokurorinë publike.¹⁴³ Me njërin rekomandohet që në sistemin e vlerësimit të arritjeve të gjyqtarëve të përfshihen më shumë kritere kualitative dhe të evitohen të gjitha zvogëlimet automatike të notave të gjyqtarëve si rezultat i ndryshimit të vendimeve të tyre, ndërsa me rekomandimin tjetër rekomandohet që gjatë përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve publikë të bëhet definimi i qartë i kundërvajtjeve, ndërsa spektri i sanksioneve të aksesshme të zgjerohet në mënyrë që të sigurohet proporcionalitet më i mirë, duke siguruar se shkarkimi i prokurorëve është i mundshëm vetëm për raste serioze të sjelljes së pandërgjegjshme. Në Raportin e GREKO-s si pjesërisht i zbatuar vlerësohet edhe rekomandimi për ndërmarrjen e masave përkatëse në lidhje me përforsimin e pavarësisë, paanshmërisë dhe integritetit të gjyqtarëve-porotë, mes tjerash, përmes trajnimit të tyre për çështje etike, parandalim të korrupsionit dhe për konfliktin e interesit, si dhe përfshirja e obligimit që gjyqtarët-porotë t'i përmbahen Kodeksit të etikës së gjyqtarit, i cili u miratua nga Shoqata e Gjyqtarëve.¹⁴⁴

Pikërisht korrupsioni në fushën e jurisprudencës është ai i cili veçanërisht mund të na shqetësojë nëse kemi parasysh rëndësinë e veçantë të kësaj kaste në ndërtimin e sistemit të sundimit të së drejtës, por edhe në luftën faktike kundër korrupsionit të bartësve të dy pushteteve të tjera.

Edhe pse gjyqtarët, si edhe bartësit e tjerë të funksioneve shtetërore dhe publike, u nënshtrohen obligimeve të njëjta të parashikuara me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit dhe në këtë drejtim janë të obliguar ta deklarojnë pronën e tyre dhe të informojnë në kohë për ndryshimet e të njëjtës, gjyqtarët, si dhe shumica e funksionarëve të tjerë, në përgjithësi e respektojnë obligimin për deklarimin e pronës së tyre, por në masë të madhe nuk i azhurnojnë deklaratimet e tyre, ndërsa KSHPK akoma nuk ka krijuar mekanizëm për ndjekjen e saktë të ndryshimeve të pronës së gjyqtarëve.¹⁴⁵

141 <http://www.24vesti.com.mk/ostavki-vo-dik-ostana-samo-salija-jakupi-si-odi-od-moralni-prichini-boneva-poradi-hajka-protiv-nea>, i aksesshëm në 14.12.2017

142 Fourth Evaluation Round- Corruption Prevention in respect of members of Parliament, judges and prosecutors, Compliance report „the former Yugoslav Republic of Macedonia” (https://www.ecoi.net/file_upload/1.226_1478595492_greco4-2016-8-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-en.pdf).

143 Kjo notë u prezantua edhe përmes Komunikatës për media – Republika e Maqedonisë edhe më tutje nuk i plotëson rekomandimet e vlerësimit të Katërt të GREKO që e përfshinë Kuvendin, Gjyqësorin dhe Prokurorinë Publike, publikuar më datë 22.12.2017 në ueb faqen e Transparensi Interneshënëll Maqedoni, http://www.transparency.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=1244&Itemid=57

144 Të dhënat e sublimuara nga Raporti i GREKO për Republikën e Maqedonisë janë marrë nga qëndrimet e "Transparensi Interneshënëll Maqedoni" të publikuara në Komunikatë në ueb faqen e tyre http://www.transparency.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=1221&Itemid=57

145 Transparensi Interneshënëll Maqedoni, Sistemi Nacional për Integritet – nota për Maqedoninë, maj 2006, f. 96, i aksesshëm në: http://www.transparency.mk/images/stories/NIS_mk.pdf

Në mënyrë plotësuese, Republika e Maqedonisë në aspekt historik dhe global shënoi rënie më të madhe në rang listën e Indeksit për perceptimin e korrupsionit.¹⁴⁶ Për vitin 2016,¹⁴⁷ Maqedonia ishte në vendin e 90 me 37 pikë, e që është rënie për 24 vende, në krahasim me vitin 2015, kur ishte në vendin e 66 sipas Indeksit të perceptimit të korrupsionit. Nëse bëjmë një krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor, pas Republikës së Maqedonisë është vetëm Kosova edhe atë në vendin e 95.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit

Madje edhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), i cili është zgjedhur nga Kuvendi dhe konform Ligjit duhet të jetë i pavarur, ballafaqohet me probleme të konsiderueshme në lidhje me llogaridhënien, integritetin dhe transparencën, e që kontribuon për rolin e tij të parëndësishëm në luftën kundër korrupsionit. Nga ana tjetër, janë evidente mangësitë dhe mospasja e kapacitetit të mjaftueshëm në sistemin e mbikëqyrjes mbi pushtetin ekzekutiv nga ana e Prokurorisë Publike, e që është rezultat i mosekzistimit të plotë të vullnetit politik për luftimin e korrupsionit. Megjithatë, si shtyllë më e fuqishme në luftën kundër korrupsionit vlerësohet Enti Shtetëror i Revizionit i cili ka kapacitete të mjaftueshme për realizimin e mandatit të tij ligjor.¹⁴⁸

Komisioni për Sistem Politik dhe Marrëdhënie midis Bashkësive e shqyrtoi Raportin vjetor për punën e KSHPK në vitin 2016 në gjithsej 4 mbledhje gjatë muajit qershor të vitit 2017. Kritika për punën e KSHPK kishte si nga ana e deputetëve ashtu edhe nga përfaqësuesit e organizatave qytetare të cilat morën pjesë në mbledhje. Platforma e organizatave qytetare për luftë kundër korrupsionit i bëri apel Komisionit për Sistem Politik dhe Marrëdhënie midis Bashkësive të miratoj Konkluzion me të cilin Kuvendit do t'i propozoj që të mos e miratoj raportin vjetor për punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHKP) për vitin 2016.¹⁴⁹

Platforma konsideron se edhe pse me strukturën e tij Raporti vjetor e respekton zbatimin e kompetencave të KSHPK, megjithatë, ai nuk ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse për aktivitetet që janë ndërmarrë ose ato që nuk janë ndërmarrë gjatë vitit 2016, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligjin për parandalimin e korrupsionit, në Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave, Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve dhe në Kodin Zgjedhor. Njëra nga vërejtjet kryesore, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë ka të bëjë me sektorin civil, konsiston me atë se në Raportin vjetor nuk është prezantuar lënda, me ç'rast KSHPK kërkoi procedim kompetent nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë, Drejtoria e të Ardhurave Publike (DAP) dhe nga Drejtoria për Zbulim Financiar kundër 21 shoqatave dhe fondacioneve dhe një partie politike.¹⁵⁰

Edhe pas ndërrimit të pushtetit, KSHPK, ballafaqohet me sfida të ngjashme sa i përket mosrealizimit të kompetencave të tij ligjore, përfshirë këtu edhe publikimin dhe azhurnimin e ueb faqes zyrtare të tij të deklarimit të plotë të gjendjes pronësore përmes fletë-anketave të funksionarëve të emëruar dhe sapo të zgjedhur, së këtejmi duke pasur mundësinë e këqyrjes edhe në ndryshimet e krijuara tek ish-bartësit e funksioneve të larta shtetërore dhe publike.

146 Deklaratë e kryetares së Transparensi Interneshënill Maqedoni, e aksesshme në: <https://goo.gl/afxvng> (shkarkuar më date 15.02.2017)

147 Corruption perception index 2016, i aksesshëm në: https://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2016

148 Transparensi Interneshënill Maqedoni, Sistemi Nacional për Integritet - nota për Maqedoninë, maj 2006, f. 29-30, i aksesshëm në: http://www.transparency.mk/images/stories/NIS_mk.pdf

149 Shkresë nga Platforma e organizatave qytetare për luftë kundër korrupsionit deri te anëtarët e Komisionit për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Midis Bashkësive, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, e aksesshme në: <https://goo.gl/geC5Lj>

150 Komunikatë e Platformës së organizatave qytetare për luftë kundër korrupsionit, e aksesshme në: <https://goo.gl/8fhV1u>

Në mbledhjen publike, të mbajtur më 4 janar të vitit 2017, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit i hodhi poshtë kundërshtimet e paraqitura nga Koalicioni i udhëhequr nga Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë për shkeljen e Kodit Zgjedhor (neni 8-a) në lidhje me punësimet dhe ndërtimin e objekteve publike në periudhën e fushatës zgjedhore. Sipas vendimeve të miratuara dhe të publikuara të KSHPK, kundërshtimet janë hedhur poshtë meqë konkurset janë publikuar para shpalljes së zgjedhjeve, ose e kanë marrë pëlqimin e KSHPK ose janë paraparë mjete në Buxhet për aktivitetet e ndërmarra gjatë fushatës.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në mbledhjen e mbajtur më 29 gusht të vitit 2017, njëzëri vendosi të hap procedura për tre kundërshtime kundër Sekretariatit të Përgjithshëm pranë Qeverisë dhe Agjencisë për Punësime të Qytetit të Shkupit për ngritjen e procedurave disiplinore, suspendim dhe përjashtim nga puna pas shpalljes së zgjedhjeve lokale. Komisioni, në të tre rastet, konstatoi se ekziston bazë për ngritjen e procedurave, me ç'rast njoftoi se do të paraqes kërkesë deri te Sekretariati i Përgjithshëm dhe deri te Agjencia për Punësime që t'u dërgojnë dokumentacion përkatës, siç tha kryetari Igor Tanturovski, sa më shpejtë që është e mundur, ndërsa më së voni për 15 ditë. Sipas tij, tridhjetë e dy persona të punësuar në Qeveri kanë paraqitur kundërshtim kundër Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë.¹⁵¹

Problemi me punësimet partiake në nivel shtetëror është analizuar nga Instituti ZIP në studimin "Kush punëson, partia ose komuna", i përpiluar në kuadër të projektit "Rrjeti 23+". Në analizë theksohet se kur zbatohet Ligji për punësime në sektorin publik për personelin teknikë dhe ndihmës, procesi i punësimit është më fragjil ndaj korrupsionit. Edhe pse pjesëmarrja më e madhe e Agjencisë për Administratë në procesin e punësimit është një hap pozitiv për reduktimin e korrupsionit gjatë punësimit, megjithatë, në komunat dhe veçanërisht në mjediset më të vogla, punësimet partiake vazhdojnë.¹⁵²

Nga ana tjetër, njëanshmëria e tij ishte evidente dhe erdhi në shprehje edhe përmes vendimit të KSHPK të miratuar në mbledhjen e mbajtur më 15 gusht të vitit 2017, me të cilin kishin marrë qëndrim se nuk është e ligjshme ndërprerja e marrëdhënies së punës të Prokurorit Publik Marko Zvërlevski, meqë gjatë kohës së zgjedhjeve, nuk mund të punësohet ose shkarkohet ndonjë person në institucionet shtetërore dhe publike. Anëtarët e Komisionit për Parandalimin e Korrupsionit njëzëri konkluduan se Zvërlevski nuk duhet të ndërrohet gjatë kohës së shpalljes së zgjedhjeve, meqë kjo gjë paraqet shkelje të Kodit Zgjedhor.

Njëkohësisht, mendimi i tyre iu dorëzua edhe Komisionit të Kuvendit menjëherë pas përfundimit të mbledhjes së KSHPK. Sipas Kryetarit të Komisionit, Igor Tanturovski, mendimi i këtyre është identik me prononcimet e deritanishme të Komisionit në situata të ngjashme, në përputhje me nenin 8 të Kodit Zgjedhor i cili është mjaft i qartë. Anti-korrupsionarët u prononcuan një javë pasi që VMRO-DPMNE kërkoi prej tyre ta interpretojnë zbatimin e nenit 8, sipas të cilit gjatë kohës së zgjedhjeve të shpallura ndalohet procedura e punësimit të personave të rinj ose ndërprerja e marrëdhënies së punës së funksionarëve shtetërorë.

Marrë në përgjithësi, puna e Komisionit mund të vlerësohet si pasive, selektive dhe pamjaftueshëm transparente. Sipas përgjigjes së KSHPK ndaj Kërkesës për informacione me karakter publik dërguar nga Komiteti i Helsinkit, e cila kishte të bëjë me më shumë çështje nga fushëveprimi i punës së Komisionit, në lidhje me numrin e parashtrësive për korrupsion, të cilat i ka pranuar Komisioni gjatë vitit 2017, përfundimisht me datë 31.08.2017, deri te KSHPK janë paraqitur gjithsej 46 denoncime për dyshim për ekzistimin e korrupsionit, nga të cilat 44 janë paraqitur nga persona fizikë

151 Komisioni kundër Korrupsionit ngriti procedura për disiplinore, për suspendim dhe përjashtim nga puna pas shpalljes së zgjedhjeve, artikulli i aksesshëm në: <http://www.libertas.mk/antikoruptsiska-povede-postapki-za-di/>, shkarkuar më 04.09.2017

152 Analiza është e aksesshme në: <https://goo.gl/V7MkDB>

ndërsa 2 denoncimet e tjera nga shoqata të qytetarëve ose nga persona të tjerë juridikë. Gjatë kësaj periudhe ndaj denoncimit të paraqitur për ekzistimin e dyshimit për korrupsion, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, për shkak të kontrollit të të dhënave të denoncimit dhe për shkak të përcaktimit të gjendjes faktike, për 148 lëndë ka miratuar Konkluzion për veprim të mëtutjeshëm nga institucionet kompetente, përkatësisht ka dërguar kërkesë për sigurimin e informacioneve apo dokumenteve relevante ose për ndërmarrje të veprimeve nga ana e institucioneve të tjera kompetente.

Për më tepër, sipas njoftimit të pranuar, në periudhën e njëjtë kohore, Komisioni para organit kompetent nuk ka iniciuar procedura sipas iniciativës së tij për shkak të dyshimit për ekzistimin e korrupsionit dhe as që ka paraqitur iniciativë për ngritjen e procedurës për përgjegjësi penale kundër personave të zgjedhur ose të emëruar, personave zyrtarë dhe personave përgjegjës në ndërmarrjet publike, institucioneve publike dhe personave të tjerë juridikë me kapital shtetëror. KSHPK, në nëntë muajt e parë të vitit 2017, paraqiti 12 kërkesa për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente, si dhe 2 iniciativa për ngritjen e procedurës para organeve kompetente për shkarkim, transferim, ndërrim ose zbatim të masave të tjera të përgjegjësisë së personave të zgjedhur ose të emëruar, personave zyrtarë ose përgjegjës ose të personave të tjerë juridikë, si dhe 4 iniciativa për shkarkim për shkak të gjendjes së konstatuar të konfliktit të interesave. Komisioni, gjatë vitit 2017, nuk ka pranuar raport nga prokuroria në lidhje me procedurat e ngritura për korrupsion. Sipas raporteve tremujore nga ndjekja e punës së KSHPK të përpiluara nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) që kanë të bëjnë me më shumë indikatorë të ndryshëm, përmes të cilëve ndiqet përmbushja e obligimeve ligjore, zbatohet kontrolli anti-korrupsion mbi legjislacionin por është pamjaftueshëm aktiv dhe jo i plotë.

Së këtejmi, në periudhën e raportimit korrik-nëntor 2017 një gjë e këtillë është bërë për pesë ligje, ndërkaq filloi edhe për 11 të tjerë. Asnjëri nga 13 propozim-ligjet, të përcaktuar në mbledhjen e Qeverisë nuk i janë dërguar KSHPK-së për kontroll të detyrueshëm. Në këtë tremujor, KSHPK iu përgjigj 916 kërkesave për mendim nga ana e institucioneve shtetërore në lidhje me zbatimin e Ligjit për parandalimin e korrupsionit në procesin zgjedhor, që kanë të bëjnë me ndërmarrjen e procedurave për punësim për kohë të pacaktuar dhe për kohë të caktuar, për procedura për prokurime publike, procedura për dhënie me qira të pronës në pronësi shtetërore dhe lloje të tjera të posedimit në dispozicion të pronës shtetërore, si dhe mendime në lidhje me kërkesat për pagesa të jashtëzakonshme të mjeteve buxhetore ose të fondeve, si dhe posedimi në dispozicion të mjeteve të tjera buxhetore në nivel qendror dhe lokal. KSHPK hapi 18 lëndë për keqpërdorime të mundshme gjatë kohës së zgjedhjeve lokale, në të cilat janë theksuar dyshime për keqpërdorime të mundshme të mjeteve buxhetore, fondeve publike dhe mjeteve të ndërmarrjeve publike dhe personave të tjerë juridikë, të cilët kanë në dispozicion kapital shtetëror nga dita e shpalljes së zgjedhjeve më 6 gusht të vitit 2017. Prej tyre, 16 lëndë janë hapur sipas kundërshtimeve të paraqitura nga persona fizikë, një kundërshtim është paraqitur nga person juridik dhe një kundërshtim nga parashtues i panjohur. Duhet të theksohet se në gjysmën e dytë të vitit 2017 KSHPK manifeston transparencë më të madhe për bashkëpunim me organizatat qytetare, ndërsa Komisioni mbetet jotransparent dhe në nivel të pamjaftueshëm e informon publikun për aktivitetet e veta përmes ueb faqes së tij ose në ndonjë mënyrë tjetër. Nevojitet që KSHPK ta siguroj publikimin e praktikës së tij dhe sqarimet e tij për vendimet, veçanërisht të vendimeve që kanë të bëjnë me financimin politik, konfliktin e interesave dhe me fletë-anketat.¹⁵³

Vetëm në tremujorin e tretë të vitit 2017 deri në KSHPK janë paraqitur dhe janë krijuar gjithsej 19 lëndë për ekzistimin e elementeve të korrupsionit, edhe atë sipas denoncimeve të qytetarëve, të personave juridikë dhe lëndë të hapura sipas bindjes së vet KSHPK. Të dhënat që i përbajnë këto

153 Transparensi Interneshënëll Maqedoni, Sistemi Nacional për Integritet – nota për Maqedoninë, maj 2006, f. 275, i aksesshëm në: http://www.transparency.mk/images/stories/NIS_mk.pdf

lëndë kanë të bëjnë me dyshime për ekzistimin e elementeve korruptive gjatë kryerjes së autorizimeve publike, të prokurimeve publike, kryerjes së punëve me interes publik etj., ndërsa procedimi i tyre është akoma në rrjedhë e sipër.

Azhurnimi i Regjistrimit të fletë-anketave të personave të zgjedhur dhe të emëruar edhe më tutje mbetet njëra nga dobësitë gjatë punës së KSHPK. Sipas të dhënave të QMBN, prej 633 funksionarëve të emëruar, për 468 (70,59%) persona nuk ka informacione të publikuara. Nga ana tjetër, në KSHPK janë paraqitur 755 fletë-anketa pas zgjedhjes së funksionit, 407 fletë-anketa pas ndërprerjes së funksionit, si dhe 64 fletë-anketa për ndryshimin e deklarimeve të gjendjes pronësore. KSHPK ka pasur mundësi, ndërkaq nuk ka ngritur iniciativë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente kundër institucionit ose personit përgjegjës për shkak të mos-përbushjes së obligimeve për mosparaqitjen e të dhënave të nevojshme për azhurnimin e Regjistrimit.

Sa i përket konfliktit të mundshëm të interesave, në periudhën kohore korrik-shtator 2017 Komisioni ka ngritur 33 procedura të reja për përcaktimin e rasteve të këtilla, me ç'rast një personi i është shqiptuar vërejtje publike, ndërkaq kishte edhe një iniciativë për shkarkimin e një anëtarit të Këshillit Drejtues. KSHPK akoma nuk e ka përpiluar raportin e veçantë për keqpërdorimet e mundshme të mjeteve buxhetore për financimin e fushatës zgjedhore ose të aktiviteteve të tjera politike për zgjedhjet parlamentare të mbajtura në dhjetor të vitit 2016.

Njëkohësisht, vërehet pasiviteti në lidhje me ngritjen e iniciativave para organeve kompetente për kontrollin e punës financiare-materiale të partive politike, kështu që asnjë iniciativë e këtillë nuk është ngritur në tremujorin e tretë të vitit 2017.¹⁵⁴

Shteti duhet të ndërmerri hapa serioz në drejtim të implementimit të plotë të rekomandimeve të GREKO-s, me theks të veçantë mbi ato rekomandime që kanë të bëjnë me gjyqësorin.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit përfundimisht dhe në mënyrë konsekuente duhet ta zbatoj Ligjin për parandalimin e korrupsionit në pjesën e publikimit të fletë-anketave dhe ndryshimit të gjendjes pronësore për bartësit e autorizimeve publike, përfshirë këtu edhe anëtarët e tij, në përputhje me nenin 50-a të Ligjit për parandalimin e korrupsionit.

Nevojitet që KSHPK ta siguroj publikimin e praktikës së vet dhe të sqarimeve të veta ndaj vendimeve, veçanërisht ndaj vendimeve që kanë të bëjnë me financimin politik, konfliktin e interesave dhe me fletë-anketat.

Ai duhet të veproj në mënyrë të pavarur, në mënyrë proaktive dhe të paanshme, konform kompetencave të tij ligjore. Njëkohësisht, nevojitet rritja e transparencës së KSHPK përmes organizimit të mbledhjeve të hapura dhe publike dhe përmes zhvillimit të bashkëpunimit të ngushtë me të gjitha organizatat qytetare të cilat punojnë në fushën e luftës kundër korrupsionit, përkundërt tendencës aktuale të punës së mbyllur dhe të izoluar me të cilën cenohet integriteti i këtij institucioni.

154 Të gjitha të dhënat e prezantuara më lartë janë shkëputur nga Raporti tremujor nr. 4 nga ndjekja e punës së KSHPK, i cili ka të bëjë me periudhën kohore korrik-shtator 2017, i aksesshëm në: <http://www.mcms.mk/images/docs/2017/sledenje-na-dsk-kvartalen-izvestaj-br-4.pdf>

Konfiskimi i pronës

Edhe përkrah faktit që korniza ekzistuese nacionale juridike paraqet bazë solide juridike në bashkëpunimin efektiv ndërkombëtar, në hetimet dhe kthimin e mjeteve, megjithatë kjo nuk funksionon në praktikë.

Konfiskimi i pronës së fituar në mënyrë jolegale edhe më tutje është një fushë në të cilën nuk shënohet kurrfarë progresi, pavarësisht numrit të madh të procedurave të ngritura të lëndëve të cilat kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin, duke i përfshirë këtu edhe lëndët e PSP. Në maj të vitit 2017, Gjykata Themelore Shkup 1 nuk pranoi asnjë kërkesë nga PSP për ngrirjen/pezullimin e pronës së VMRO-DPMNE për rastin “Talir”, i cili ka të bëjë me financimin e kësaj partie. U refuzuan të gjitha 12 kërkesat për ngrirjen e pronës, në mesin e të cilave edhe ajo për selinë e partisë.¹⁵⁵

Me qëllim që punët të lëvizin në drejtim pozitiv, me propozim të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Qeveria në mbledhjen e 22-të të mbajtur më datë 09.08.2017 (pika 17) mori vendim për miratimin e Strategjisë së Republikës së Maqedonisë për fuqizimin e kapaciteteve për zhvillimin e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pronës, me Plan Veprim për zbatimin e saj.¹⁵⁶ Duke e pasur parasysh se kjo Strategji është pjesë e agjendës së Planit 3-6-9, Qeveria e ngarkoi Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave (Drejtorinë e të Ardhurave Publike; Drejtorinë e Doganave; Drejtorinë për Polici Financiare; Drejtorinë për Zbulim Financiar), të dërgojnë nominime për anëtarë të Grupit të Punës për hartimin e Strategjisë.¹⁵⁷ Në Ministrinë e Punëve të Brendshme u formua Grupi i Punës, i cili do të punoj në përpilimin e Strategjisë në të cilin marrin pjesë edhe organizata joqeveritare. Pritet që me këtë Strategji të avancohen kapacitetet e hetimeve financiare dhe të sistemit për konfiskim në Republikën e Maqedonisë, në mënyrë plotësuese nevojitet përmes ndryshimeve të dispozitave ligjore të rregullohen aspektet e rëndësishme dhe mangësitë të cilat ekzistojnë në këto fusha.¹⁵⁸

Me Strategjinë duhet të detektohen të gjitha aspektet jokonsekuente në sistemin e konfiskimit të pronës, me qëllim të tejkalimit të të njëjtave.

Strategjia duhet të kompletohet me Strategjinë tanimë ekzistuese Nacionale për luftë kundër pasuritit të parave dhe financimit të terrorizmit, e miratuar për nevojat nga viti 2017 deri në vitin 2020 dhe dokumentet e tjera strategjike.

Nevojitet në mënyrë plotësuese përmes ndryshimit të dispozitave ligjore të rregullohen aspektet e rëndësishme dhe mangësitë të cilat ekzistojnë në këto fusha.

Organizatata joqeveritare në mënyrë aktive duhet ta ndjekin zbatimin e Strategjisë..

155 <https://www.slobodnaevropa.mk/a/28504940.html>, i aksesshëm në: 05.07.2015 r.

156 Komunikatë nga mbledhja e 22-të e Qeverisë së RM-së, e aksesshme në: <http://vlada.mk/node/13212>

157 Ibid.

158 Nga punëtorët e ekspertëve për konfiskimin e pronës dhe dobisë së fituar pasurore e organizuar në kuadër të projektit “Rrjeti 23+” në bashkëpunim me Transparensi Interneshënëll Maqedoni, znj. Sllagjana Taseva i prezantoi dobësitë e specifikuar të sistemit dhe zgjidhjet e parashikuara në draft – Strategjinë për fuqizimin e kapaciteteve për zhvillimin e hetimeve financiare dhe për konfiskimin e pronës. Në këtë punëtori diskutuan përfaqësuesit e sektorit joqeveritar, PSP, gjyqtarë, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Mes tjerash, u përcaktuan dobësitë e deritanishme në sistemin e zbatimit të masës konfiskim, me rekomandime konkrete për tejkalimin e dobësive.

Ligji për mbrojtjen e denoncuesve

Edhe përkrah miratimit të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, më 10 nëntor të vitit 2015, ligj ky i cili duhet të kontribuoj për luftë më efektive ndaj korrupsionit dhe krimin të organizuar, fillimisht përmes mbrojtjes së personave të cilët ofrojnë informacione për sjellje të palejueshme dhe të kundërligjshme, përkatësisht inkurajimi i tyre në këtë drejtim, i njëjti në praktikë implementohet me vështirësi. E vetëdijshme për rëndësinë e këtij Ligji për punën e PSP, Prokurorja speciale publike Katica Janeva në kuadër të fjalës së saj, gjatë shënimit të ditës së denoncuesve, e përkujtoi nevojën e implementimit të rekomandimeve të Komisionit të Venecias në lidhje me Ligjin për mbrojtjen e privatësisë dhe Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve për shkak të problemeve gjatë punës me të cilat vazhdimisht ballafaqohet PSP.¹⁵⁹

Sipas QMBN, KSHPK nuk ka ndërmarrë masa konkrete për zbatimin aktiv të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me obligimet e institucioneve publike para KSHPK. Në këtë aspekt, Komisioni nuk ka ndërmarrë aktivitete konkrete që t'i informoj dhe edukoj institucionet për obligimin e tyre që të caktojnë person për pranimin e denoncimeve nga ana e denoncuesve, si dhe të paraqesin informacione për atë person. Të dhënat flasin se numri i përgjithshëm institucioneve, të cilat kanë dërguar informacione me emër dhe mbiemër të personit të autorizuar për pranimin e denoncimeve nga denoncuesit në periudhën kohore nga muaji janar deri në qershor të vitit 2017, ka qenë 41 institucione, ndërsa nga hyrja në fuqi e këtij Ligji e deri më sot gjithsej 65 institucione e që është 5,03% nga gjithsej 1.291 institucione publike.

Më shumë informacione për vlerësimin e ndikimit të këtij Ligji ofron studimi: “A do të ketë “bilbil-fryrës” në universitetet?”¹⁶⁰, i hartuar nga Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Edukim si pjesë e projektit “Rrjeti 23+”. Në këtë mënyrë do të arrihen efektet nga zbatimi i Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, si dhe mundësitë e zbatimit të tij në parandalimin e korrupsionit në arsimin e lartë. Sipas hulumtimit të realizuar, madje 54% e të anketuarve janë të mendimit se korrupsioni është përhapur gjerësisht në arsimin e lartë. Nga hulumtimi, 70% e të anketuarve nuk e dinë se ekziston Ligj për mbrojtjen e denoncuesve, ndërsa 83% nuk janë të informuar se institucioni në të cilin studiojnë ka person të autorizuar për pranimin e denoncimeve nga denoncuesit.

Për shkak të dobësive evidente të këtij Ligji, veçanërisht në drejtim të implementimit të rekomandimeve të Komisionit të Venecias, si dhe përmirësimi i tij i brendshëm terminologjik, ishte e domosdoshme nevoja e ndryshimit të tij. Në tremujorin e fundit të periudhës raportuese, Ministria e Drejtësisë e vuri në këqyrje të publikut profesionistë Propozim-Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve me të cilat do të bëhen përmirësime të caktuara të kornizës ligjore edhe pse nevojiten përgatitje të konsiderueshme juridike, institucionale dhe praktike për zbatimin e tij, si dhe ndërgjegjësimi i publikut, me qëllim që të sigurohet implementimi i tij efikas.

Një hap pozitiv është fakti se miratimit të këtij ligji i parapriu debat gjithëpërfshirës publik, i cili e nënkupton përfshirjen e përfaqësuesve të të gjitha institucioneve relevante shtetërore, ekspertë të fushës, por edhe përfaqësues të sektorit civil. Njëkohësisht, duhet të theksojmë se me këtë propozim-ligj në të vërtetë janë përfshirë pjesa më e madhe e opinionëve dhe rekomandimeve të Komisionit të Venecias, me ç'rast është sqaruar nocioni “institucione”, janë bërë edhe harmonizime të tjera të propozuara terminologjike, është zgjeruar vëllimi i zbulimit të mbrojtur i informacioneve, është reviduar neni 6, veçanërisht në lidhje me zgjerimin e listës për mbrojtje gjatë denoncimit publik, është precizuar dhe në masë të konsiderueshme është përmirësuar mbrojtja e personit i cili

159 Komunikatë e PSP: <http://www.jonsk.mk/2017/03/24/катица-јанева-со-свое-излагање-на-меѓу/>

160 Analiza është e aksesshme në: <http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/2017-ISIE-Policy-Study-Will-there-be-Whistleblowers-at-the-Universities.pdf>

denoncon, përkatësisht informon, përcaktohet institucioni i cili do të bëjë mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve etj.

Megjithatë, ligji nuk përmban rekomandime dhe qëndrime tjera të rëndësishme të prezantuara në opinionin e Komisionit të Venecias, si vijojnë: nuk përcakton se zbulimi i identitetit të denoncuesit, madje edhe me vendim gjyqësor do të ishte i mundshëm vetëm në rrethana dhe raste të jashtëzakonshme; nuk përmban dispozita me të cilat do të sigurohej ndihmë e përkohshme për denoncuesin derisa zgjatë procedura në gjykatë; në pjesën e procedurës gjyqësore e cila është publike, për shkak të zgjidhjes së problemit me denoncimin e mbrojtur intern dhe ekstern të cilat nuk janë procedura publike nuk bëhet precizimi i nevojshëm i këtyre dispozitave, ndërsa ligji i propozuar njëherësh nuk përmban dispozita të cilat do t'i përkushtojnë vëmendje edhe personit të autorizuar për pranimin e denoncimeve si një element i rëndësishëm në procedurën e përgjithshme, në mënyrë që të sigurohen mekanizma për mbrojtjen e tij nga ndikimet dhe keqpërdorimet.¹⁶¹

Në mënyrë plotësuese, nevojitet edhe ndryshimi i më shumë akteve nënligjore, duke e përfshirë edhe rregulloren për denoncimin e mbrojtur të brendshëm në institucionet e sektorit publik¹⁶² në pjesën e cila i rregullon kriteret e caktimit të personit të autorizuar për pranimin e denoncimeve në institucionet me karakter publik, të cilat janë vendosur lartë dhe u shkaktojnë implikime financiare institucioneve.

Rëndësi të madhe ka harmonizimi i këtij Ligji me nenin 50 të Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar¹⁶³ me të cilin parashikohet se personi i caktuar nga udhëheqësi i subjektit nga sektori publik njofton për parregullsi dhe dyshime për mashtrime ose korrupsion.¹⁶⁴

Ndryshimi, përkatësisht plotësimi i Ligjit për denoncues është një hap pozitiv drejt harmonizimit të tij me rekomandimet e Komisionit të Venecias me qëllim të evitimit të të gjitha mangësive të identifikuar në tekstin aktual ligjor.

Megjithatë, rekomandohet përmirësimi i më tutjeshëm i tekstit të propozim-ligjit përmes inkorporimit të zgjidhjeve tjera të nevojshme.

Ligji për mbrojtjen e denoncuesve dhe aktet nënligjore përkatëse, duhet të zbatohen në mënyrë konsekuente, me ç'rast shteti duhet të bëjë përgatitje të konsiderueshme juridike, institucionale dhe praktike për zbatimin e Ligjit, si dhe ngritjen e vetëdijes publike për kornizën ligjore, me qëllim që të sigurohet implementimi i tij efikas.

161 Megjithatë, sipas informacioneve të pranuar nga ana e përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë, i cili mori pjesë aktive dhe dha kontributin e tij në punëtorinë e ekspertëve për "Raportin në hije", ky aspekt që ka të bëjë me personin e autorizuar për pranimin e denoncimeve do të përfshihet me ndryshimet e Ligjit për parandalimin e korrupsionit. Përveç kësaj, si e dhënë relevante u theksua se parashikohet inkorporimi i veprës së re penale "Pengimi i drejtësisë" në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë.

162 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.46/2016

163 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 90/09, 12/11, 188/13, 192/15, 147/17

164 Mendimi i Rrjetit 23 për propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve.

3

■ Të drejtat themelore

Të drejtat e njeriut

■ Avokati i Popullit

Gjatë vitit 2016 në zyrën e Avokatit të Popullit u pranuan 3.775 parashtresa nga qytetarë, ndërsa 37 parashtresa janë hapur me iniciativë të tij. Në periudhën janar-gusht të vitit 2017 janë pranuar 2.117 parashtresa. Sa i përket bashkëpunimit me institucionet, Avokati i Popullit konstaton pengim të ashpër nga një numër më i madh i institucioneve, siç është Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria Publike, Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe NP "Ujësjellës dhe kanalizime".¹⁶⁵

Puna me lëndë tregon se ka rritje të numrit të ankesave nga ana e qytetarëve në lidhje me trajtimin e pabarabartë, përkatësisht cënimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për rreth 20 për qind, me ç'rast në numër më të madh janë ato që kanë të bëjnë me diskriminimin në marrëdhënien e punës në administratën publike dhe përfshijnë elemente politike. Avokati i Popullit ka konstatuar se funksionimi i sistemit të jurisprudencës edhe më tutje mbetet një problem i madh me një sërë dobësish të cilat kanë pasoja të drejtpërdrejta mbi realizimin dhe mbrojtjen efikase të të drejtave të qytetarëve, veçanërisht gjatë zbatimit të parimit të gjykimit në afat të arsyeshëm. Në mënyrë plotësuese konstatohet se përmes punësimeve grupore (në bazë etnike ose partiake) bëhet manipulim i vrazhdë ndaj qytetarëve, ndërsa administrata, në vend që të jetë në favor të qytetarëve, punon në favor të partive.

Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Avokatin e Popullit, të miratuara në shtator dhe tetor të vitit 2016, kishin për qëllim implementimin e Parimeve të Parisit, si dhe harmonizimin me rekomandimet e Raportit të Pribe-s dhe me Prioritetet e Reformave Urgjente për avancimin e sistemit të mbrojtjes të të drejtave të njeriut. Në përputhje me këto rekomandime, ndryshimet ligjore duhej t'i përforconin autorizimet, përkatësisht ta zgjerojnë mandatin e Avokatit të Popullit me përfshirjen e promovimit të të drejtave të njeriut, të stimulojnë pavarësi më të madhe financiare dhe rritje të kapaciteteve njerëzore, dhe në bazë të kësaj do të krijohen parakushte për akreditimin e Avokatit të Popullit me Status A si institucion nacional për të drejtat e njeriut.

Megjithatë, me zgjidhjet e reja, pjesa më e madhe e rekomandimeve nuk u pranuan. Rekomandim i vetëm i cili u sanksionua në ligj ka të bëjë me mundësinë që Avokati i Popullit të veproj si "mik i gjykatës" me autorizime që në mënyrë aktive të marr pjesë në të gjitha fazat e procedurës, të ketë të drejtë të informohet për seancat e caktuara gjyqësore, t'i mundësohet këqyrje në dokumentet dhe të ketë të drejtë të jap propozime dhe mendime.

165 Raporti vjetor për nivelin e sigurimit të respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, i aksesshëm në: <http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2016/GI-2016.pdf>

Në mënyrë plotësuese u përforcua edhe kontrolli i Kuvendit mbi pushtetin ekzekutiv kur bëhet fjalë për përcaktimin e masave për zbatimin e rekomandimeve për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara në Raportin vjetor të Avokatit të Popullit. Në të ardhmen, Qeveria në çdo gjashtë muaj duhet ta informoj Kuvendin për zbatimin e rekomandimeve, ndërsa trupat punues të Kuvendit njoftimet do t'i shqyrtojnë në prezencë të Avokatit të Popullit dhe përfaqësuesit të Qeverisë.¹⁶⁶

Edhe pas ndryshimeve ligjore, Avokati i Popullit mbeti pa mundësinë të punësoj kuadër profesional për ushtrimin e suksesshëm të funksionit.¹⁶⁷ Sipas kompetencave ligjore, vëllimi i punës dhe sistematizimi i vazhdueshëm i vendeve të punës, zyra e Avokatit të Popullit duhet të ketë më së paku 94 persona të punësuar që në mënyrë efikase dhe efektive të mund të funksionoj dhe t'i mbroj të drejtat e qytetarëve, ndërsa gjendja reale dëshmon se ekipimi kadrovik i institucionit është nën nivelin e nevojshëm dhe ka vetëm 68% të kapaciteteve të parashikuara (64 të punësuar).¹⁶⁸ Në seancën plenare të Kuvendit, në korrik të vitit 2017, u miratua vendimi për dhënien e pëlqimit për aktet e përgjithshme të Avokatit të Popullit dhe u dha pëlqim për punësime të reja në shërbimin e Avokatit të Popullit.¹⁶⁹ Kjo pasoi pasi që në një periudhë të gjatë kohore, duke filluar nga viti 2011 për shkak të mosdhënies së pëlqimit përkatës nga Ministria e Financave nuk ishte e mundur të plotësohen vendet vakante të punës, dhe për këtë shkak në Mekanizmin Parandalues Nacional (MPN) nuk kishte asnjë të punësuar, e që në mënyrë serioze u pasqyrua në përmbushjen e kompetencave të tij ligjore.

Shqetëson pamundësia për punë të mirëfilltë dhe të pavarur, meqë edhe me ndryshimet, buxheti i Avokatit të Popullit, nga aspekti financiar, mbeti i varur nga Ministria e Financave, përkatësisht nga Qeveria. Buxheti i miratuar për vitin 2017 jo vetëm që nuk i përfshinë implikimet financiare të parashikuara për zbatimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Avokatin e Popullit, por ai shpie në drejtim të reduktimit të mjeteve për paga.¹⁷⁰ Sipas kësaj, edhe pse institucioni ka pavarësi të përcaktuar me ligj, Ligji për realizimin e Buxhetit nuk i lejon pavarësi faktike.

Në Raportin e Avokatit të Popullit për vitin 2016 është konstatuar stagnim, ndërsa në disa fusha edhe proces retrograd të të drejtave të njeriut, për çka dëshmon edhe numri i rritur i cenimeve të konstatuara mbi të drejtat dhe liritë e njeriut për 4%.¹⁷¹ Si më alarmante janë theksuar institucionet skajshëm të politizuara dhe jofunksionale prej të cilave një pjesë e tyre i zbatojnë agjendat partiake, veprimi joprofesional dhe brutal i policisë, përdorimi i tepruar i forcës nga ana e policisë së burgjeve ndaj personave të dënuar dhe mungesa e mbrojtjes shëndetësore sistematike në institucionet ndëshkuese-korrektuese, mangësi të sistemit pensional me pasoja të dëmshme mbi personat e siguruar, mjetet e pasiguruara për pagesën e të drejtave të mbrojtjes sociale, cënim i së drejtës së punësimit të personave me aftësi të kufizuar, deportimi i paligjshëm i refugjatëve, përcaktimi i kundërligjshëm i arkëtimit të taksës radiodifuzive dhe ujit, tatimimi i kundërligjshëm i qytetarëve, si dhe joprofesionalizmi gjatë punës së organeve zgjedhore.

Në njoftimin e tij sipas Kërkesës së paraqitur për informata me karakter publik theksohet se ndryshimet ligjore nuk i realizuan tërësisht nevojat për pavarësi financiare të institucionit dhe në të njëjtat nuk janë inkorporuar rekomandimet e Pribe-s për inkorporimin e dënimeve për ata të cilët e pengojnë punën e institucionit, formimin e ad-hok komisioneve anketuese në Kuvend për lëndët që

166 Ibid.

167 Shih më shumë në: <https://sdj.mk/index.php/glasno-za-ombudsmanot/sobranieto-so-nov-zakon-ke-mu-gi-vrze-ratsete-na-narodniot-pravobranitel/>

168 Monitorimi qytetar i Avokatit të Popullit "Ombudsmani – midis mandatit dhe kapaciteteve", raportin numër 2, i aksesshëm në: http://nvoinfo-centar.mk/wp-content/uploads/2017/05/Monitoring-izvestaj-Ombudsman_broj-2.pdf

169 <http://www.sobranie.mk/sessiondetails.nsp?sessionDetailsId=0d46cc3a-68dd-4764-93c8-f3123c09aa17&date=05.7.2017>

170 Raporti vjetor për nivelin e sigurimit të respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, i aksesshëm në: <http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2016/GI-2016.pdf>

171 Komunikatë e Avokatit të Popullit, e aksesshme në: <http://ombudsman.mk/upload/documents/2017/Pres%20GI-2016/Pres%202016-Mk.pdf>

i ka ngritur Avokati i Popullit. Ndryshimet e miratuara nuk e sigurojnë pavarësinë e shërbimit profesional dhe as ndarjen e tij nga administrata shtetërore, ndërkaq ekziston kolizion të dispozitave të Ligjit për Avokatin e Popullit me dispozitat e Ligjit për nëpunës administrativë.

Duhet të përshëndetet nënshkrim i Memorandumit për Bashkëpunim midis Avokatit të Popullit dhe Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut Qendra për mbështetje – LGBTI¹⁷² në dhjetor të vitit 2016, me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve të Avokatit të Popullit, si dhe rritjes së sigurisë juridike dhe mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave komunitetit LGBTI në territorin e RM-së.

Kuvendi ta shqyrtoj seriozisht Raportin vjetor të Avokatit të Popullit dhe në përputhje me ndryshimet e reja ligjore të përcaktoj masa për zbatimin e rekomandimeve të përgjithshme për përmirësimin e sistemit dhe sigurimin e respektimit, avancimit dhe mbrojtjes kualitative të të drejtave të njeriut.

Të sigurohen mjete financiare në mënyrë që Avokati i Popullit të filloj me realizimin e kompetencave të bartura, me qëllim që ndryshimet të mos mbesin vetëm pro-formë të zbatimit të të gjitha rekomandimeve nga institucionet ndërkombëtare.

■ Gjykata Kushtetuese si mbrojtëse e lirive dhe të drejtave të njeriut?!

Numri i kërkesave të parashtruara për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve në Gjykatën Kushtetuese është në rënie të vazhdueshme. Në funksionimin e saj 24 vjeçar, prej rreth 300 kërkesave të pranuar nga ana e Gjykatës Kushtetuese, është pranuar vetëm një e që vë në dukje se ky institut juridik nuk është mjet efektiv juridik.

Gjatë vitit 2016 në këtë Gjykatë janë paraqitur vetëm 8 kërkesa për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave konform nenit 110 alinesë 3 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë. Po atë vit janë zgjidhur vetëm 11 lëndë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive (prej të cilave 7 kërkesa janë pranuar gjatë vitit 2016, 3 gjatë vitit 2015 dhe 1 gjatë vitit 2014). Së këtejmi, vetëm në një rast Gjykata Kushtetuese me vendim e ka hedhur poshtë kërkesën që kishte të bëjë me kinse diskriminimin në lidhje me përkatësinë sociale, ndërsa në të gjitha lëndët e tjera kërkesat janë hedhur poshtë për shkak të jokompetencës ose për shkak të ekzistimit të pengesave procesuale për vendimmarrje.

Edhe pse Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese parashikon mbajtje të seancave publike kur vendoset sipas kërkesave për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, megjithatë në praktikë një gjë e këtillë nuk ndodh. Në këtë drejtim ishte edhe aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin “Selmani dhe të tjerë kundër Republikës së Maqedonisë”, me të cilin u përcaktua cenimi i të drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pikërisht nga aspekti i mosmbajtjes së seancës publike verbale para Gjykatës Kushtetuese.¹⁷³ Me këtë aktgjykim të GJEDNJ u konfirmua joefikasiteti i Gjykatës Kushtetuese në aspektin e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Rasti konkret kishte të bëjë me veprimin dhe vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese për kërkesën e mbrojtjes së lirisë së mendimit dhe shprehjes së lirë të mendimit të paraqitur nga ana e një grupi të gazetarëve, ndërkaq në kontekstin e ngjarjeve në Kuvend më 24 dhjetor të vitit 2012. Vërehet edhe jotransparencë në punë e që në mënyrë të veçantë e konfirmojnë edhe të dhënat për kohëzgjatjen e seancave.

172 http://ombudsman.mk/mk/aktivnosti/231373/potpishan_memorandum_za_sorabotka_pomegju_kancelarijata_na_narodniot_pravobranitel_i_lgbt_centarot.aspx

173 SELMANI AND OTHERS v. THE REPUBLIC OF MACEDONIA (Application no. 67259/14), aktgjykimi i datës 09 shkurt 2017, i cili është i aksesshëm në HUDOC databaza e Këshillit të Evropës.

Më 17 tetor të vitit 2016 u zgjodh Kryetari i ri i Gjykatës Kushtetuese, ndërsa pas skadimit të mandatit të tre gjyqtarëve kushtetues në tetor të vitit 2017, Presidenti i RM-së propozoi dy kandidatë,¹⁷⁴ të cilët u zgjodhën nga Kuvendi më 11 janar të vitit 2018.¹⁷⁵

Edhe përkrah ndryshimeve të propozuara kushtetuese në vitin 2014, akoma nuk është inkorporuar mekanizmi i ankesës kushtetuese, si instancë e nevojshme e fundit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut para mundësisë që të paraqitet aplikim në GJEDNJ.¹⁷⁶

Pasiviteti dhe instrumentalizimi politik i Gjykatës Kushtetuese kontribuon në drejtim të mungesës së vazhdueshme të kredibilitetit dhe besimit të publikut. Gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve duhet të mbahet llogari për profesionalizmin, kompetencën dhe integritetin e gjyqtarëve të sapo zgjedhur e që, në instancë të fundit, duhet ta rris nivelin e Gjykatës Kushtetuese.

Në drejtim të rritjes së besimit transparent në Gjykatën Kushtetuese nevojitet përkufizim i qartë i nocionit "jurist i shquar". Përveç kësaj emrat dhe biografia profesionale e kandidatëve për gjyqtarë kushtetues duhet të diskutohen në publikun më të gjerë profesional para emërimit të tyre, veçanërisht në rastin kur kandidatët propozohen nga Kuvendi i RM-së. Duhet të mendohet edhe për rritjen e shumicës së nevojshme në Kuvend për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Në përputhje me kornizën ekzistuese ligjore zgjedhja bëhet me shumicë absolute e që mund të bëhet zgjedhja e gjyqtarëve edhe në mungesë të opozitës.

Nevojitet inkorporimi i ankesës kushtetuese në drejtim të rritjes së mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të qytetarëve.

■ Tortura dhe llojet e tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues

Gjatë vitit 2016 dhe 2017, në kuadër të aktiviteteve projektuese të Këshillit të Evropës u ndër-morën angazhime plotësuese për vendosjen e mekanizmit efektiv të kontrollit të jashtëm mbi punën e policisë, të cilat janë në linjën e formimit të seksionit të veçantë pranë Prokurorisë Publike, dhe të seksionit në zyrën e Avokatit të Popullit i cili duhet të përfshijë edhe përfaqësues të sektorit qytetar.¹⁷⁷

Krijimi i mekanizmit të jashtëm, i cili duhet të shoqërohet me përforsim adekuat të sistemit ekzistues të kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme i cili u tregua si pamjaftueshëm efikas dhe i pavarur, është përgjigje për përafërsisht dhjetë aktgjykime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që kanë të bëjnë me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ndalimi i torturës). Në të gjitha aktgjykimet është konstatuar joefektiviteti i hetimit, pse nuk ka pasur ose fare nuk ka pasur hetim nga Prokuroria ose nga paditë private të paraqitura nga të dëmtuarit, meqë të njëjtat janë hedhur poshtë.

174 <http://www.akademik.mk/kadriu-i-kostadinovski-izbrani-za-novi-ustavni-sudii/>

175 <https://goo.gl/x1nnCV>

176 The role of the Constitutional Court in protecting the freedom of expression in the Republic of Macedonia, i aksesshëm në: http://www.epi.org.mk/docs/TRAIN%202016_Lea.pdf

177 Më shumë për këtë projekt, i cili sipas informacioneve të fundit, nga muaji korrik i vitit 2017 hasi në mbështetje të fuqishme nga strukturat e reja të MPB (<http://www.coe.int/en/web/skopje/-/meetings-with-the-newly-appointed-minister-of-internal-affairs-and-deputy-minister-of-justice-in-skopje>), i aksesshëm në: <http://www.coe.int/en/web/skopje/enhancing-human-rights-policing>

Në periudhën e raportimit nga ana e GJEDNJ nuk është paraqitur asnjë aktgjykim me të cilin është konstatuar cënimi i nenit 3, por është i konsiderueshëm numri i lëndëve të komunikuar deri te agjenti qeveritar dhe deri te Byroja për përfaqësimin e RM-së para GJEDNJ në të cilat aplikantët e vënë në dukje shkeljen e ndalimit të torturës ose të llojit tjetër të trajtimit jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues. Nga katër lëndë të paraqitura për prononcim të cilat përmbajnë të dhëna ankimore sipas nenit 3, më karakteristike janë dy lëndët e përshkruara në vijim.

Në njërin nga aplikimet, aplikuesi ankohet për cënimi, si në aspektin material ashtu edhe në aspektin procedural të këtij neni, duke theksuar se gjatë një ahengu familjar në Kumanovë ai në mënyrë të dhunshme është nxjerrë nga shtëpia e babait të tij dhe është dërguar në stacionin policor, ku është ekspozuar në keqtrajtim fizik, për çka ka ekzistuar dokumentacioni mjekësor. Parashtesa e tij deri te Sektori për Kontroll të Brendshëm pranë MPB ka përfunduar pa sukses për shkak të kinse mosekzistimit të provave për brutalitetin policor, ndërsa prokurori publik e ka njoftuar aplikuesin se është miratuar "Rezolutë" sipas së cilës nuk ka pasur prova për ekzistimin e veprës penale për të cilën ndiqet sipas detyrës zyrtare.¹⁷⁸

Aplikimi i dytë ka të bëjë me lëndën me të miturin L.R. sipas së cilës një kohë të gjatë u veprua nga ana e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. E njëjta ka të bëjë me trajtimin jonjerëzor dhe degradues në të cilin u ekspozua L. R. të cilit fillimisht gabimisht i është përcaktuar diagnoza mjekësore që në vitin 2008, dhe si rezultat i kësaj është vendosur në institucion jopërkates në të cilin nuk i është ofruar trajtimi dhe përkujdesja adekuate, e që ka kulminuar me lidhjen e tij për krevati me një trajtim krejtësisht johuman. Mosndërmarrja e veprimeve të nevojshme nga shteti, përmes qendrës kompetente për punë sociale, si kujdestar i tij ligjor dhe moszbatim të hetimit efektiv në të dhënat për trajtim jonjerëzor dhe degradues nga Prokuroria ishin shkas për ngritjen e aplikimit të ri në GJEDNJ, procedurë kjo e cila është në rjedhë e sipër.¹⁷⁹

Në mënyrë plotësuese, Komiteti i Helsinkit në vitin 2016 dhe 2017 reagonte në kontinuitet për më shumë raste të cilat mund të trajtohen si cënimi të nenit 3, për të cilat nuk është zbatuar hetim efektiv. Kështu që kah fundi i vitit 2016 në Komitet u paraqit rasti për dhunë fizike mbi një fëmijë me origjinë rome, e cila është kryer mbi të në institucion shëndetësor nga ana e mjekut gjatë vizitës mjekësore, e që për pasoj ka pasur lëndime më të lehta trupore dhe përjetim të dhimbjes shpirtërore tek i dëmtuari. Në këtë rast, ka munguar çdo lloj i hetimit nga ana e autoriteteve kompetente të prokurorive publike.

Në fillim të shtatorit të vitit 2017 Komiteti i Helsinkit dërgoi 49 kërkesa deri te të gjitha prokuroritë themelore publike dhe deri te gjykatat themelore të shtetit që kanë të bëjnë me grumbullimin e informacioneve në lidhje me procedurat e regjistruara dhe të zhvilluara për vepra sipas nenit 142 (Torturë dhe trajtim tjetër brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues) dhe nenit 143 të KP (Keqtrajtim gjatë kryerjes së shërbimit). Informacione kthyesë u pranuan nga gjithsej 24 gjykata themelore dhe 18 prokurori themelore publike.

Sipas përgjigjeve të pranuar nga gjykatat, tek ato kanë qenë të evidentuara vetëm 13 lëndë sipas nenit 143 prej të cilave 3 në Gjykatën Themelore Shkup 1 prej të cilave 2 janë zgjidhur, nga 3 lëndë në Gjykatën Themelore Tetovë, (me ç'rast 2 kanë përfunduar me dënim me kusht, ndërsa 1 lëndë është e pazgjidhur dhe e njëjta është në procedim e sipër), 3 në Gjykatën Themelore Strumicë (1

178 Pasqyra e gjendjes faktike e këtij aplikacioni nr. 59119/15 dhe të dhënat ankimore të aplikuesit mund të gjenden në linkun në vijim të HUDOC, databaza e GJEDNJ [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"languageisocode":\["ENG"\],"respondent":\["MKD"\],"article":\["3"\],"documentcollectionid2":\["COMMUNICATEDCASES"\],"kdate":\["2016-09-20T00:00:00.OZ","2017-09-20T00:00:00.OZ"\],"itemid":\["001-172741"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

179 Lënda, në mënyrë me të cilën e njëjta është dërguar për përgjigje deri te agjenti i Qeverisë, e aksesshme në: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"languageisocode":\["ENG"\],"respondent":\["MKD"\],"article":\["3"\],"documentcollectionid2":\["COMMUNICATEDCASES"\],"kdate":\["2012-09-20T00:00:00.OZ","2017-09-20T00:00:00.OZ"\],"itemid":\["001-166835"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

lëndë është hedhur poshtë, 1 aktgjykim me dënim dhe një procedurë është në rrjedhë e sipër e cila ka të bëjë me të punësuar në SPB Strumicë), 2 lëndë në Gjykatën Themelore Dellçevë (prej të cilave njëra ka përfunduar me dënim me kusht, ndërsa lënda tjetër akoma nuk është zgjidhur), 1 lëndë e sapa pranuar në Gjykatën Themelore Manastir e cila ka përfunduar me aktgjykim me lirim, si edhe 1 lëndë në Gjykatën Themelore Prilep për të cilën nuk u prezantuan informacione të detajuara.

Asnjë lëndë, sipas nenit 142 të KP nuk është regjistruar në asnjërën nga gjykatat themelore prej të cilave pranuar përgjigje, me përjashtim të Gjykatës Themelore Shkup 1 si gjykatë e vetme e specializuar penale në të cilën janë pranuar 2 lëndë, me ç'rast në njërin prej tyre është shqiptuar dënim me kusht për 2 persona, ndërsa në lëndën e dytë procedura është ndërprerë.

Prokuroritë publike themelore kanë vepruar vetëm ndaj 8 lëndëve për torturë nga neni 142 të KP, ndërsa sipas nenit 143 (Këqtrajtim gjatë kryerjes së detyrës) prokuroritë kanë vepruar në gjithsej 44 lëndë, me ç'rast kallëzimi penal është hedhur poshtë në katër raste, akuzë është paraqitur në 32 raste, ndërsa njëri prej rasteve ka përfunduar me shqiptimin e dënimit me kusht. Megjithatë, këto të dhëna duhet të pranohen me një dozë rezerve meqë, përveç numrit të lëndëve ndaj të cilave është vepruar, prokuroritë publike nuk na njoftonin çdoherë për rezultatin e procedurës në fjalë në kuptimin e hedhjes poshtë të kallëzimit penal, paraqitje të propozim akuzës dhe ngjashëm.¹⁸⁰

Është e domosdoshme që organet kompetente ta ndërpresin praktikën e mosndëshkimit për veprimet e torturës ose formave tjera të trajtimit jonjerëzor, nënçmues nga ana e personave të autorizuar zyrtarë. Pasiviteti i Prokurorisë Publike në rastet e torturës, veçanërisht kur ajo kryhet nga ana e nëpunësve policorë edhe më tutje e përforcon prezencën e mosbesimit e cila është e pranishëm tanimë një kohë të gjatë tek qytetarët sa i përket sistemit të jurisprudencës.

Njëkohësisht nevojitet një qasje më serioze ndaj ekzekutimit të aktgjykimeve nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në të cilat është konstatuar shkelja e nenit 3, me mundësi edhe përmes përsëritjes së hetimit çdoherë, kur një gjë e këfillë është e mundshme dhe kur nuk janë krijuar kushtet e parashkrimit të ndjekjes penale.

Krijimi i mekanizmit të jashtëm për kontroll mbi punën e policisë dhe ndjekjen e rasteve të veprimit jopërkatës policor duhet të sigurohet sa më shpejtë, përmes miratimit të kornizës së parashkuar ligjore, si dhe përmes ndërtimit të kapaciteteve të nevojshme institucionale për zbatimin e tij konsekuent.

Viktimat e torturës dhe veprimit jopërkatës policor doemos duhet të kenë mbështetje të garantuar dhe përkatëse juridike, mjekësore, psikologjike dhe sociale, në përputhje me kërkesat e Direktivës së BE 2012/29 për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave nga krimi.

180 Përveç kësaj, duhet të theksohet se nga tre nga prokuroritë themelore publike, të cilat dërguan përgjigje për kërkesën për informata me karakter publikë refuzuan t'i shkëmbejnë të dhënat e kërkuara, duke theksuar se bëhet fjalë për informacione me të cilat ato prokurori nuk disponojnë dhe as nuk i kanë krijuar, duke e marrë parasysh se nuk bëjnë lloj të këfillë të analizave statistike. Së këtejmi, ato krejtësisht në mënyrë të pabazë vendosën ta ndërpresin procedurën sipas kërkesave të paraqitura dhe e privuan këtë raport nga të dhënat e rëndësishme nga domeni i punës së tyre.

■ Burgjet dhe hapësirat e paraburgimit

Sipas përgjigjes ndaj Kërkesës për informacion me karakter publik, të pranuar nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve më datë 29.11.2017, përfundimisht në mes të muajit nëntor të vitit 2017 gjendja në institucionet penitenciare ka qenë e atillë që numri i përgjithshëm i personave të paraburgosur dhe të dënuar, që janë gjetur në ndonjërin nga 13 institucionet e mbyllura të këtij lloji, ka qenë 3045, e që në raport me 3446 persona, sa kanë qenë zyrtarisht të regjistruar përfundimisht në prill të vitit 2016 paraqet një reduktim prej 11.6%. Prej tyre 2809 kanë qenë persona të dënuar të cilët e kanë vuajtur dënimin me burgim, ndërsa 236 persona kanë qenë të paraburgosur.

Në mënyrë plotësuese, në Institucionin Edukues-Korrektues për të mitur “Tetovë”, i cili përkohësisht është transferuar në Burgun në Ohër kanë qenë të vendosur gjithsej 20 persona të mitur. Edhe më tej shqetëson fakti që në vend se të vendosen në institucion të specializuar edukues-korrektues (objekti i cili është në proces shumëvjeçar të ndërtimit në afërsi të fshati Vollkovia të Tetovës) personat e mitur edhe më tutje vendosen në institucionin ndëshkues-korrektues, në të cilin nuk ka kushte përkatëse për arsimin, risocializimin dhe përmirësimin e tyre, në mënyrë që kur të dalin nga ky institucion të mund të integrohen në shoqërinë maqedonase.

Kapaciteti i përgjithshëm për persona të dënuar dhe të paraburgosur është 2576 përkundrejt numrit prej 2809 persona të vendosur e që do të thotë se ekziston mbipopullim prej thuhetse 109%, përkatësisht mesatarisht 109 persona qëndrojnë në një hapësirë të dedikuar për 100 persona. Nga ana tjetër, megjithatë ekzistojnë dallime të caktuara sa i përket nivelit të mbipopullimit nga njëri institucion në institucionin tjetër penitenciar. Së këtejmi, gjendja më alarmante është në INK “Idrizovë” i cili zyrtarisht ka kapacitet për vendosjen e 1094 personave të dënuar, ndërsa në të njëjtin dënimin e vuajnë madje 1786 persona, e që është një tejkalim i konsiderueshëm i kapaciteteve të tij hapësinorë dhe ka mbipopullim prej 163.25%. Aq më shumë, sipas Komitetit për Parandalimin e Torturës kapaciteti real i tij është dyfish më ulët, përkatësisht për 900 persona të dënuar.

Nga krahasimi i të dhënave zyrtare, që kanë të bëjnë me kapacitetet hapësinore krahasuar me numrin e personave të dënuar, të cilët janë vendosur në institucionet ndëshkuese-korrektuese jashtë Shkupit, përfundimisht me datë 17.11.2017 mbipopullim i madh është vërejtur edhe në Burgun e Strumicës (136%), Shtipit (134.6%), dhe Tetovës (126.5%).

Mbipopullimi i burgjeve, mungesa e higjienës dhe kushtet substandarde bashkë me të gjitha rrethanat e tjera marrë në përgjithësi, përfshirë këtu edhe ekipimin e pamjaftueshëm kadrovik të nëpunësve policorë, mos-trajnimi i tyre dhe statusi i keq material-financiar, joprofesionalizmi i shprehur përmes përdorimit të tepruar të forcës dhe dukuritë e korrupsionit, nga njëra anë, si dhe kujdesi i pamjaftueshëm mjekësor, joefikasiteti i ndihmës juridike, moszbatimi i programeve për risocializim përmes aktiviteteve arsimore, të punës, sportive dhe aktiviteteve të tjera e vënë në dukje trajtimin johuman dhe jopërkatës të personave të dënuar, ndërkaq është vërejtur rritja e dhunës midis personave të burgosur.

Sjellja joprofesionale dhe zbatimi i torturës ndaj personave të dënuar, si dhe trajtimi joadekuat shëndetësor (veçanërisht edhe sa u përket të dënuarave), qasja e vështirësuar deri te mjeku dhe shpërndarja jopërkatëse e terapisë mjekësore u theksuan edhe në kuadër të Raportit të Avokatit të Popullit në lidhje me gjendjen me liritë dhe të drejtat e njeriut në vitin 2016, i prezantuar në datën 30 mars të vitit 2017.¹⁸¹ Situata është e ngjashme edhe me personat e mitur, të cilët e vuajnë masën edukuese-korrektuese në institucionin edukues-korrektues – Tetovë, të cilët krejtësisht në mënyrë joadekuate përkohësisht janë vendosur në INK Burgu Ohër.¹⁸²

181 Raporti vjetor për nivelin e sigurimit të respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së lirisë dhe të drejtave të njeriut, i aksesshëm në: <http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2016/GI-2016.pdf>

182 Të dhëna për gjendjen në të cilën gjenden këta persona janë përfshirë në Raportin e posaçëm për kushtet e vuajtjes së masës edukuese-korrektuese referim në institucion edukues-korrektues dhe niveli i realizimit të të drejtave të fëmijëve, i publikuar në maj të vitit 2016 (<http://ombudsman.mk/upload/Istrazuvanja/2016/Informacija%20VPD%20Tetovo-Ohrid-mk.pdf>).

Edhe pse sugjerimet e Avokatit të Popullit rezultuan me veprime konkrete nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe zbatimin e mbikëqyrjes të jashtëzakonshme inspektuese në raste të caktuara, megjithatë, të njëjtat nuk janë obligative dhe nuk kanë ndonjë efekt të madh. Në mënyrë plotësuese mospunimi i mjeteve financiare më shumë se dy vjet, rezultoi me mosfunksionimin e Mekanizmit Parandalues Nacional, i cili në bashkëpunim me organizatat qytetare duhet të ketë rol kryesor në ushtrimin e mbikëqyrjes mbi gjendjet në të gjitha vendet e privimit nga liria, duke i përfshirë edhe institucionet penitenciare dhe psikiatrike dhe dhënie të rekomandimeve përkatëse për tejkalimin e gjendjeve dhe trajtimin e personave të privuar nga liria, në përputhje me standardet relevante ndërkombëtare. Edhe krahas rolit të kufizuar momental të MPN, në realizimin e kompetencave të tij ligjore, ky trup edhe më tutje ka mbështetje dhe funksionon me ndihmën e donacioneve të huaja, gjendje kjo e cila është e patolerueshme dhe si e këtillë duhet të tejkalohej sa më shpejtë.

Veçanërisht shqetësues është numri i madh i rasteve të vdekjes së personave të vendosur në burgje. Vetëm në vitin 2016, Avokati i Popullit në dy raste, me iniciativë të tij ngriti procedurë për vdekjen e dy personave të dënuar të cilët e kanë vuajtur dënimin në INK "Idrizovë", me ç'rast ka kërkuar informatë nga Instituti për Mjekësi Ligjore dhe Kriminalistikë në lidhje me shkaqet e vdekjes së tyre të konstatuara pas obduksionit të kryer, megjithatë procedura akoma është në rrjedhë e sipër.¹⁸³ Sipas njoftimit të fundit, të pranuar nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, vetëm në vitin 2017 dhe përfundimisht me 31 janar të vitit 2018, në të gjitha institucionet ndëshkuese korrektuese janë regjistruar gjithsej 19 raste të vdekjes, prej të cilave 14 në INK "Idrizovë", 2 në INK Shtip dhe nga 1 në repartin e hapur të Burgut në Kumanovë në Kriva Pallankë, në Burgun e Shkupit dhe në Burgun e Prilepit. Së këtejmi, 3 persona kanë ndërruar jetë jashtë institucionit derisa e kanë shfrytëzuar favorin, ndërsa nga 16 personat e tjerë 2 persona kanë ndërruar jetë për shkak të vetëvrasjes me varje, ndërsa 14 persona të tjerë për shkak të gjendjes së përkeqësuar shëndetësore, në disa raste vdekja ka ndodhur në vet institucionin, në disa raste gjatë rrugës për në spital ose në kushte spitalore. Nga të gjithë personat që kanë ndërruar jetë shqetëson fakti se madje 4 persona kanë qenë romë.

Në Raportin e fundit të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës pranë Këshillit të Evropës, i cili u publikua më 12 tetor të vitit 2017 e që i shqyrton konstatimet e vizitës së përfaqësuesve të Komitetit të cilën e realizuan në Republikën e Maqedonisë në dhjetor të vitit 2016, me ç'rast në mënyrë të ashpër kritikohen kushtet e privimit nga liria, si dhe trajtimi i personave të dënuar në Burgun e "Idrizovës" në të cilin janë vendosur përafërsisht 60% e numrit të përgjithshëm të të burgosurve në vend.¹⁸⁴

Duke filluar nga viti 2006, Komiteti vazhdimisht thekson disa çështje strukturore fundamentale, siç është niveli i ulët i administrimit dhe menaxhimit me institucionet komplekse penitenciare në vend, puna e keqe e personelit të burgjeve, si dhe mospasja e sistemit adekuat të mbikëqyrjes dhe kontrollit, si dhe mungesa e përgjegjësisë për rastet e veprimit joadekuat. Komiteti nënvizon se është bërë progres i papërfillshëm, me ç'rast edhe përkrah asaj se problemet e njëjta sistematike edhe më tutje janë të pranishme, ka konstatuar tendencë të përkeqësimit të vazhdueshëm të gjendjeve. Ai e rekomandon qasjen ndaj sistemit të sundimit të së drejtës përmes respektimit të plotë të të drejtave të njeriut, në përputhje me detyrimet e marra ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë.

Në këtë kuptim, Komiteti nënvizon përkujdesje mjekësore krejtësisht joadekuate në "Idrizovë", me ç'rast vihet në rrezik jeta e të burgosurve, mungesa e regjimit përkatës të edukimit të tyre dhe an-

183 Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për nivelin e sigurimit të respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, viti 2016, i aksesshëm në: <http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2016/GI-2016.pdf>, f. 53.

184 Report to the Government of "the former Yugoslav Republic of Macedonia" on the visit to "the former Yugoslav Republic of Macedonia" carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT) from 6 to 9 December 2016, CPT/Inf (2017) 30, i aksesshëm në: <https://rm.coe.int/pdf/168075d656>

gazhimit me punë, si dhe korrupsion endemik, i cili është i pranishëm gjatë dhënies së çdo lloji të shërbimit ose përfitimit të çdo lloji të favorit ose shërbimit, siç është transferimi në qeli tjetër, lëshimi në shtëpi, shfrytëzimi i telefonave celularë, furnizimi me ilaçe dhe droga. Raporti thekson se problemet e vazhdueshme të trajtimit jopërkatës, dhuna midis të burgosurve, korrupsioni dhe mungesa e aktiviteteve ka të bëjë me numrin e pamjaftueshëm të nëpunësve të burgut në “Idrizovë”, si dhe mos-trajnimi i tyre.

Pak më e mirë vlerësohet gjendja në INK Shtip, ku rekomandohet reduktimi i mbipopullimit dhe avancimi i kushteve materiale të privimit nga liria, si dhe vendosja e regjimit të aktiviteteve për personat e dënuar. Sa për krahasim, regjimin, të cilit i janë ekspozuar personat e paraburgosur në burgun hetues Shuto Orizarë, Komiteti e ka kualifikuar si relik nga e kaluara, duke theksuar se personat mbahen nëpër qeli me vetëm një orë aktivitet në ambient të hapur, madje edhe brenda periudhës dy vjeçare.

Një muaj pas publikimit të këtij Raporti, Qeveria e shqyrtoi dhe miratoi propozim-Ligjin për amnisti, me çka u hap rruga për shqyrtimin e tij në Kuvend, me ç'rast i njëjti u miratua më datë 15.01.2018. Në këtë propozim-Ligj theksohet se qëllimi i miratimit të këtij ligji ka të bëjë me risocializimin e kryerësve, me qëllim që në të ardhmen ata të mos paraqiten si kryerës të veprave penale, parandalimin e gjendjeve negative dhe parandalimin e infeksionit kriminal në lidhje me mbipopullimin dhe kushtet e këqija dhe johumane në institucionet ndëshkuese-korrektuese, si dhe me shkarkimin financiar të burgjeve në lidhje me koston e qëndrimit të tyre gjatë vuajtjes së dënimit me burgim.¹⁸⁵

Në këtë ligj të shkurtër janë definuar kategoritë e personave të cilët do të lirohen nga vuajtja e dënimit me burgim, duke i përfshirë edhe personat e dënuar, të cilëve u është shqiptuar dënimi me burgim deri në gjashtë muaj, të cilët lirohen plotësisht nga vuajtja e burgimit, personat të cilëve u është shqiptuar dënimi me burgim mbi gjashtë muaj, të cilët lirohen nga vuajtja me 30% nga dënimi i shqiptuar i përgjithshëm, personat e dënuar të cilëve me vendim të plotfuqishëm u është shqiptuar dënimi i vetëm me burgim të cilët lirohen nga vuajtja me 30% në pjesën e dënimeve individuale të përcaktuara paraprakisht të përfshira me amnistinë. Në ligj prezicohet se nëse në dënimin e vetëm me burgim është përcaktuar burgim për vepër penale të cilën nuk e përfshinë amnistia, të dënuarit do të lirohen nga vuajtja e dënimit me 30% vetëm në pjesën e dënimeve individuale paraprakisht të përcaktuara të përfshira me amnistinë. Neni 3 në mënyrë të qartë e përcakton se amnistia nuk ka të bëjë me personat e dënuar me burgim të përjetshëm dhe i përcakton veprat të cilat do të përjashtohen nga ky proces, si dhe vepra penale Vrasje (neni 123 të Kodit Penal); veprat kundër zgjedhjeve dhe votimit (neni 158-165-v të KP), veprat kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor (neni 186, 187, 188, 189, 191, 193, 193-a, 193-b dhe 194 të KP); veprat kundër shtetit (neni 305-327 të KP); veprat kundër rendit publik (neni 394-a-394-g, të KP); si dhe veprat kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare (neni 403-418-a dhe 418-v deri në 422 të KP).

Gjendja me mbipopullimin e burgjeve dhe trajtimin e të burgosurve është alarmante. Është e domosdoshme urgjentisht të ndërmerren masa përmes ndryshimit të politikës së zbatimit të sanksioneve penale dhe zbatimit të paraburgimit.

Nevojitet implementimi i plotë i rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës për anulimin e mangësive të konstatuara, me theks mbi përmirësimin e kushteve të përgjithshme, sigurimin e mbrojtjes adekuate shëndetësore, parandalimin dhe përgjegjësinë në rastet e trajtimit jopërkatës, si dhe luftimin e praktikave korruptive.

Është i domosdoshëm ndriçimi i rasteve të vdekjes së personave të dënuar në institucionet ndëshkuese-korrektuese.

185 Sipas vlerësimeve, me Ligj, nga vuajtja e dënimit me burgim do të lirohen 670 persona me vendime të plotfuqishme me dënim me burgim deri në 6 muaj, ndërsa 3097 personave do t'u zvogëlohet dënimi me 30%. (http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/2655/Mesecen_IZVESTAJ_za_covekovi_prava-Noemvri_2017_1.pdf)

Urgjentisht duhet të sigurohen të gjitha parakushtet kadrovike, materiale dhe financiare për realizimin papengesë të funksionit të Mekanizmit Parandalues Nacional.

Organizatave joqeveritare t'iu sigurohet vizitë e rregullt dhe e lirë në burgje, me qëllim të konstatimit të gjendjeve dhe dhënien e rekomandimeve konkrete në drejtim të përmirësimit të tyre.

Procesi i zbatimit të Ligjit për amnisti duhet të implementohet me kujdes, dhe të shoqërohet me masa dhe politika përkatëse për risocializimin e personave të amnistuar pas lëshimit të tyre në liri, me qëllim të pengimit të recidivizmit dhe dukurive të tjera negative.

■ Grupet vulnerable dhe parimi i mosdiskriminimit

Edhe pas kalimit të gjashtë vjetëve nga zbatimi i Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe formimit të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi (KMD, Komisioni), akoma nuk mund të flasim për mbrojtje efektive nga diskriminimi, veçanërisht kur bëhet fjalë për grupet e marginalizuara. Çështjet kryesore, që kanë të bëjnë me aksesin në drejtësi të viktimave nga diskriminimi, përkatësisht lirimi i tyre nga shpenzimet gjyqësore për ngritjen e procedurës gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi, pavarësia e Komisionit dhe përfshirja e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si baza të diskriminimit mbeten të pandryshuara.

Njerëzit-LGBTI mbeten subjekt të diskriminimit sistematik, për shkak të mosveprimit të Prokurorisë Publike pas sulmeve të njëpasnjëshme të Qendrës LGBTI, kur ajo dështoi që në mënyrë përkatëse t'i hetoj incidentet në vitin 2013 dhe 2014, ndërsa policia nuk arrestoi një pjesë të madhe të kryerësve. Për shkak të gjendjes së këtyllë të pa ndëshkueshmërisë personat LGBTI nuk kanë besim në institucionet që ta denoncojnë shkeljen e të drejtave të tyre, veçanërisht kur bëhet fjalë për rastet e diskriminimit.

Pas Kërkesës së pranuar për qasje në informacionet me karakter publikë nga data 12.09.2017, u dërgua njoftim se gjatë vitit 2016 deri te KMD janë parashtruar gjithsej 60 parashtrës, ndërsa ky numër përfundimisht me fundin e muajit gusht të vitit 2017 gjithsej ka qenë 36, e që është një zvogëlim i butë i numrit të tyre. Gjatë gjithë kësaj periudhe KMD ka konstatuar diskriminim në 13 raste edhe atë në bazë të moshës, gjendjes shëndetësore, orientimit seksual, gjinisë, ngjyrës së lëkurës, statusit personal ose shoqëror, dhe sipas nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, në të gjitha këto raste Komisioni ka dhënë edhe rekomandim për eliminimin e shkeljes. Njëkohësisht, nga KMD u theksua se nuk mbahet statistikë e veçantë në lidhje me atë se sa prej këtyre rasteve (nuk) kanë qenë me rekomandim. Megjithatë, Komisioni në 2 raste, në të cilat është konstatuar diskriminim ka ngritur iniciativë për hapjen e procedurës para organit kompetent.

Në maj të vitit 2016, Komisioni mori vendim me të cilin konstatohet diskriminim i drejtpërdrejtë dhe i vazhdueshëm në bazë të aftësisë së kufizuar trupore mbi personat e verbër nga ana e bankave, ndërkaq pas parashtrësës së parashtruar nga Komiteti i Helsinkit dhe anëtarëve të Rrjetit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Lidhjes Nacionale të Personave të Verbër dhe Lidhjes Nacionale të Invalidëve Civilë nga Lufta e Maqedonisë. Trajtimi joadekuat ka të bëjë me shfrytëzimin e shërbimeve dhe produkteve bankare për të cilat është i domosdoshëm nënshkrimi i shfrytëzuesit. Në arsyetimin e vendimit, KMD u jep rekomandime konkrete bankave për krijimin e kushteve dhe përshtatje racionale ndaj nevojave specifike të personave të verbër.¹⁸⁶

186 Iniciativën mund ta shihni në: http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/1503/KZD_.pdf

Njëkohësisht, duhet të nënvizohet edhe nevoja e përmirësimit të kushteve në Gjykata, të cilët duhet t'i marrin parasysh standardet për hyrje-dalje gjatë rikonstruimit dhe ndërtimit të objekteve të reja, në mënyrë që të njëjtit të jenë të aksesshëm për të gjithë qytetarët, përkatësisht t'i ndjekin nevojat e personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të rritet pavarësia dhe të përmirësohet cilësia e jetës së tyre.¹⁸⁷

Ekziston nevojë akoma më e madhe për përkufizimin më të gjerë të çështjeve juridike për të cilat mund të kërkohet ndihmë juridike falas në Ligjin e ri për ndihmë juridike falas, nevoja që me të njëjtin të përfshihen të gjithë qytetarët të cilëve u nevojitet ndihma juridike, si dhe të lehtësohen kushtet të cilat duhet t'i plotësoj qytetari që të fitoj NJF.¹⁸⁸

Është i rëndësishëm edhe mendimi i KMD nga muaji qershor i vitit 2016, me të cilin përcaktohet diskriminimi në bazë të identitetit gjinor, sipas parashtrësës së paraqitur nga Komiteti i Helsinkit si përfaqësues i viktimës. Në këtë rast bëhet fjalë për person transgjinor të cilit i është kufizuar qasja në shërbime në bazë të identitetit të tij gjinor, në mënyrë që i është ndaluar hyrja në pishinë, si objekt i cili ofron shërbime publike.¹⁸⁹ Trajtimi diskriminues nga ana e objekteve që ofrojnë shërbime publike vazhdoi edhe në vitin 2017, kur në pishinën Olimpikë në Shkup personit me karrocë invaliditeti iu pamundësua qasja në pishinë. Kjo është në kundërshtim me kërkesat e Konventës së OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, e cila e obligon RM si shtet i cili e ka ratifikuar Konventën të ndërmerr masa përkatëse për sigurimin e entiteteve private të cilat ofrojnë kapacitete dhe shërbime të cilat janë të hapura për publikun, t'i marrin parasysh të gjitha aspektet e aksesit të personave me aftësi të kufizuara. Në mënyrë plotësuese, Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi parashikon se diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike ekziston edhe atëherë kur nuk do të ndërmerren masa për eliminimin e kufizimeve, përkatësisht përshtatje të infrastrukturës dhe hapësirës, shfrytëzimin e resurseve publikisht të aksesshme ose pjesëmarrje në jetën publike dhe shoqërore.

Me disa iniciativa të tij, Avokati i Popullit arriti të luaj rol pozitiv në mbrojtjen e pjesëtarëve të grupeve vulnerable nga diskriminimi. Si rezultat i reagimit të zyrës së tij, me Vendim të Qeverisë, në shtator të vitit 2016 iu kthye e drejta e kompensimit në para personave të sëmurë nga Fibroza cistike,¹⁹⁰ pasi që Avokati i Popullit veproi sipas parashtrësës nga një prind i fëmijës së sëmur nga Fibroza cistike dhe ngriti iniciativë deri te organet relevante shtetërore për ndryshimin e Rregullores për vlerësimin e nevojave specifike të personave me aftësi të kufizuara në zhvillimin fizik ose psikik, e cila këto persona i anashkalon dhe i konsideron si persona të sëmurë kronik. Avokati i Popullit ngriti iniciativë edhe në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale për ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, me qëllim të ndryshimit të zgjidhjes ligjore me të cilën bëhet diskriminim në bazë të gjinisë dhe trajtimit të pabarabartë midis prindërve – në rastet kur nëna nuk i plotëson kushtet e kompensimit për fëmijë të tretë, këtë të drejtë nuk mund ta realizoj babai si prindi tjetër.

Përmbajtje diskriminuese u vërejtën edhe në tekstet shkollore për shkollat fillore, fillimisht në tekstin shkollor "Shoqëria" për klasën e katërt, i cili përmbante përmbajtje të cilat ishin përjashtuese dhe stigmatizuese ndaj të gjithë atyre fëmijëve dhe prindërve që jetojnë në familje jo-tradicionale, si një diskriminim i llojit të vet. Me këtë ishte cenuar Ligji për mbrojtje dhe parandalim nga diskriminimi i

187 Këto konstatime janë përfshirë në analizën "Hapini dritaret" e titulluar "Aksesi dhe inkluziviteti i gjykatave në Maqedoni" e cila është hartuar në kuadër të Projektit "Rrjeti 23+".

188 Më shumë në analizën "Ndihmë juridike falas – sfidat dhe zgjidhjet e shoqatës "Multikultura" e publikuar në kuadër të projektit "Rrjeti 23+" dhe i aksesshëm në: <http://www.multikultura.org.mk/documents/Analiza%20Multikultura%2006.09.2017%20MK.pdf>

189 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Raport vjetor për të drejtat e njeriut për vitin 2016, i aksesshëm në: http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/1659/Mesecen_IZVESTAJ_za_covekovi_prava-JUNI_2016.pdf

190 Qeveria e ktheu pas ndihmën për të sëmurët me Fibrozë cistike, pas reagimit të Avokatit të Popullit, i aksesshëm në: <https://sdk.mk/index.php/makedonija/vladata-ja-vrati-pomoshta-za-bolnite-od-tsistichna-fibroza-po-reaktsijata-na-narodniot-pravobranitel/>

cili në mënyrë eksplicite e ndalon diskriminimin në bazë të gjendjes familjare dhe martesore, si dhe Ligji për familje i cili në mënyrë eksplicite e ndalon diskriminimin e fëmijëve të lindur në dhe jashtë martese. 40 parashtrës nga nënat që jetojnë në familje me një prind, bashkësi jashtëmartesore dhe në bashkësi martesore, ndërsa të mbështetura nga 8 organizata qytetare iu drejtuan Avokatit të Popullit dhe Inspektoratit Shtetëror të Arsimit me kërkesë që të përcaktohet diskriminim dhe ta urdhërojnë Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës ta filloj procedurën për botimin e tekstit të ri bashkëkohor, me përmbajtje inkluzive, dhe pas kësaj, në korrik të vitit 2017, teksti shkollor kontestues u tërhoq. Iniciativa deri te kjo Ministri për tërheqjen e përmbajtjeve diskriminuese, nga ana e Avokatit të Popullit, u parashtrua edhe për tekstin shkollor të lëndës “Edukata qytetare” për klasën e tetë, tekst i cili përmban definicion diskriminues ndaj grave.¹⁹¹

Diskriminim të drejtpërdrejtë në bazë të gjinisë është bërë edhe përmes publikimit të ekipit të Maratonës atletike ndërkombëtare në Ohër, e që kishte të bëjë me shuma të ndryshme të çmimeve për pjesëmarrësit, varësisht nga ajo nëse fituesit janë meshkuj ose femra. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut reagoi ndaj këtij vendimi dhe pas kësaj u kërkua ndjesë, si dhe u bënë korrigjime të çmimeve të cilat u barazuan si për pjesëmarrësit meshkuj ashtu edhe për femrat.

Gjatë vitit 2017 me iniciativë të Shoqatës Maqedonase për Juristë të Rinj, KHAM Dellçevë dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut u organizua debat publik nga Komisioni i Përhershëm Anketues për të Drejtat e Njeriut pranë Kuvendit të RM-së,¹⁹² në lidhje me çështjen e kufizimit të së drejtës së lëvizjes së lirë dhe diskriminimi në pikat e kalimit kufitar ndaj qytetarëve të Bashkësisë etnike rome, me qëllim që të jepen “propozime konkrete dhe të ndërmerren iniciativa konkrete për përmirësimin e kornizës ligjore në drejtim të mbrojtjes të të drejtave dhe lirive tanimë të përcaktuara të qytetarëve, si dhe tejkalim të praktikës sistematike të profilimit racor”. Analiza “Romët në kufijtë maqedonas” e përgatitur nga “Instituti për Politikë Evropiane” dhe “KHAM” Dellçevë vë në dukje se romët janë të mendimit se me ta veprohet ndryshe në krahasim me qytetarët e tjerë të Republikës së Maqedonisë gjatë daljes nga shteti. Ata konsiderojnë se ngjyra e lëkurës, emri dhe mbiemri janë faktorë kryesorë mbi të cilët policët kufitarë e mbështesin vendimin e tyre që t’u mos u lejojnë dalje nga shteti. Praktika e këtillë është veçanërisht serioze, meqë rezulton me cenimin e njëres prej bazave më shumë të mbrojtura - racës. Përveç shkeljes së të drejtave, të cilën gjë e konfirmuan edhe gjykatat maqedonase, kjo praktikë e bartë me vete edhe racizmin për krijimin e perceptimit, nga ana e mediave, se romët janë kërcënim për regjimin pa viza,¹⁹³ si dhe rrezik nga distancimi plotësues i bashkësisë rome nga shteti dhe institucionet e tij, veçanërisht nga policia.¹⁹⁴

Në periudhën nga viti 2011 e deri më sot, praktika diskriminuese nga MPB është konstatuar në një numër të madh të raporteve ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës, si dhe në raportet e aktiviteteve të tjera të shoqatave qytetare. Deri më tani janë paraqitur 50 padi për përcaktimin e të drejtës së trajtimit të barabartë në pikat e kalimit kufitar, me ç’rast pas vendimeve të miratuara negative gjyqësore, prej të cilave 13 vendime të plotfuqishme janë pozitive, 9 janë negative, ndërsa procedurat e tjera gjyqësore janë në rrjedhë e sipër. Nga ana tjetër, për shkak të vendimeve të miratuara negative janë paraqitur 7 aplikime në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkelje të së drejtës së trajtimit të barabartë të shtetasve maqedonas-romë nga ana e RM-së.

191 Teksti shkollor diskriminues për lëndën “Shoqëria” do të tërhiqet, artikulli i aksesshëm në: <https://www.slobodenpecat.mk/naslovna/diskriminatorskiot-uchebник-po-opshtestvo-ke-bide-povlechen/>

192 Iniciativa për organizimin e debatit publikë i Komisionit të Përhershëm Anketues për të Drejtat e Njeriut, e aksesshme në: <http://myla.org.mk/иницијатива-од-граѓанскиот-сектор-за/>

193 Jeta pranë kufirit – njoftim i mediave maqedonase për romët dhe liberalizimi i vizave, i aksesshëm në: <https://goo.gl/Hsx6b7>

194 Romët në kufijtë maqedonas, dhjetor të vitit 2016, Studimi i aksesshëm në: http://epi.org.mk/docs/Osnovna%20studija_Romite%20na%20makedonskite%20granici.pdf

Kur bëhet fjalë për procedimin gjyqësor të lëndëve për diskriminim, përfundimisht në fund të vitit 2016 vetëm në Gjykatën Themelore Shkup 2 janë evidentuar 10 lëndë të regjistruara në bazë të diskriminimit, ndërsa edhe 8 lëndë të këtyra janë regjistruar deri në fund të muajit gusht të vitit 2017.¹⁹⁵ Nga 18 lëndët e theksuara, 11 janë në rrjedhë e sipër, 2 lëndë kanë përfunduar me vendim të plotfuqishëm me të cilin padia e paditësit është hedhur poshtë si e parregullt, 1 lëndë është ndërprerë deri në përfundimin e plotfuqishëm të procedurës tjetër, e cila tanimë ishte ngritur sipas të njëjtës bazë në vitin 2016, ndërsa 4 lëndët e tjera kanë përfunduar, por të njëjtat nuk ishin të plotfuqishme në momentin e hartimit të njoftimit. 10 lëndë shtesë janë evidentuar në sistemin AKMIS në vitin 2016, përkatësisht edhe 4 lëndë të tjera, deri në fund të muajit gusht të vitit 2017, në departamentin për konteste pune pranë kësaj Gjykate, si lëndë në të cilat ka ekzistuar bazë e veçantë për përcaktimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi në kontestet e punës. Në 14 lëndët e fushës së marrëdhënies të punës, vetëm 4 prej tyre kanë përfunduar dhe arkivuar. Numri më i madh i lëndëve të diskriminimit në kontestet e punës kanë të bëjnë me diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike. Gjatë periudhës raportuese Gjykata Themelore Shkup 2 miratoi një kërkesëpadi për mbrojtje nga diskriminimi, me ç'rast ka konstatuar trajtim të pabarabartë për shkak të statusit personal ose familjar, që ka të bëjë me gjendjen shëndetësore (shtatzëni) të paditëses.¹⁹⁶

Në fund, duhet nënvizohet edhe problemi me të cilin ballafaqohen fëmijët, të cilët kthehen nga vendet e Evropës Perëndimore, të cilët kryesisht janë me origjinë etnike rome dhe pas kthimit të tyre ballafaqohen me problemin e riintegrit të tyre në shkollë. Me fjalë të tjera, është e zakonshme praktika që këta fëmijë të kthehen në klasën e njëjtë në të cilën e kanë ndjekur procesin mësimor, para se të largohen me prindërit e tyre në vendet e Evropës Perëndimore edhe krahas faktit se posedojnë dëftesa ose ndonjë lloj tjetër të provës për arsimin e kryer. Një numër i madh i prindërve, për shkak të gjendjes ekonomike, nuk janë në gjendje t'i nostrifikojnë këto dokumente dhe për këtë shkak një numër i madh i fëmijëve e braktisin shkollimin pas kthimit të tyre, ndërsa janë të moshës prej 13-15 vjeç. Sipas kësaj, përqindja e fëmijëve të cilët e kanë braktisur, përkatësisht nuk e kanë vazhduar arsimin fillor dhe të mesëm është e konsiderueshme dhe këto kategori të fëmijëve mbeten tërësisht të përjashtuar nga procesi arsimor dhe nga qasja në arsim.¹⁹⁷ Në këtë drejtim duhet të theksohet se Qeveria në vitin 2010 e miratoi Programin për ndihmë dhe mbështetje gjatë riintegrit të personave që kthehen në Republikën e Maqedonisë në përputhje me marrëveshjet për readmision.¹⁹⁸ Edhe pse në të njëjtin janë parashikuar masa, mekanizma dhe krijimin e trupave të punës për lehtësimin dhe riintegrimin e personave të kthyer, deri më sot asgjë nga kjo nuk është implementuar.

Urgjentisht është i nevojshëm reformimi qënësor i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi në kahje të profesionalizmit të këtij komisioni, me qëllim që në mënyrë më efektive t'i ushtrojë kompetencat e veta për mbrojtje të barabartë të qytetarëve.

Avokati i Popullit të vazhdojë me angazhimet dhe veprimet e tij në luftën kundër diskriminimit në kuadër të mandatit të tij.

195 Të dhënat statistikore të prezantuara këtu të cilat kanë të bëjnë me lëndët për diskriminim u morën nga gjykatat kompetente civile, ndërkaq me kërkesë të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

196 Sa u përket gjykatave të tjera themelore, të cilat iu përgjigjën Kërkesës për informacione me karakter publik, rezultoi se në numrin më të madh të tyre nuk janë evidentuar padi mbi bazë të diskriminimit, nuk mbahet statistikë për bazën (madje edhe në gjykatat më të mëdha themelore siç janë ato në Manastir dhe Veles), apo numri i tyre ka qenë i pakonsiderueshëm (për shembull, një padi e këtillë në Gjykatën Themelore Resnjë). Nga ana tjetër, Gjykata Themelore në Berovë, në dy lëndë, konstatoi ekzistim të diskriminimit.

197 Informacionet e këtyra u shpërndanë nga ana e përfaqësuesit të Institutit për të Drejtat e Njeriut, i cili punon në këtë problematikë, ndërkohë që ishte i pranishëm në diskutimin e Fokus Grupit të datës 15.09.2017.

198 Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Programi për ndihmë dhe mbështetje gjatë riintegrit të personave të kthyer në Republikën e Maqedonisë, në përputhje me marrëveshjen për riadmission, i aksesshëm në: <http://www.migrant-service-centres.org/userfile/PROGRAMA%20ZA%20POMOS%20I%20PODDRSKA%20PRI%20REINTEGRACIJA%20NA%20POVRATNICI%20VO%20REPUBLIKA%20MAKEDONIJA%20SOGLASNO%20REA.pdf>

Në kuadër të ndryshimeve të propozuara të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, të përforcohet qasja deri te drejtësia e viktimeve të diskriminimit në drejtim të lirit të tyre nga shpenzimet gjyqësore për ngritjen e procedurës gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi, pavarësisht Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe përfshirja e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si baza për diskriminim.

Urgjentisht të jepet përgjigje për hetimin kundër sulmuesve të Qendrës për Mbështetje të LGBTI dhe njerëzve-LGBTI, meqë mosndëshkimi i sulmuesve paraqet diskriminim ndaj njerëzve LGBTI si grup i marginalizuar, e që plotësisht e rrënon besimin ndaj institucioneve.

Nevojitet përkufizim më gjithëpërfshirës të çështjeve juridike për të cilat mund të kërkohet ndihmë juridike falas dhe përkufizimi preciz i të njëjtave në Ligjin e ri për ndihmë juridike falas, si dhe nevoja që të përfshihen të gjithë qytetarët të cilëve u nevojitet ndihma juridike, si dhe lehtësimi i kushteve të cilat qytetari duhet t'i plotësojë që të fitoj NJF.

Liria e tubimit dhe shoqërimit

Në vitin 2016 disa herë u kufizua e drejta e tubimit të lirë gjatë mbajtjes së tubimeve të qeta dhe protestave publike. Vendimi i Presidentit Ivanov për abolicion për të gjithë politikanët, për të cilët zhvillohet hetim ose është paraqitur akuzë, përkatësisht ndërprerje të të gjitha procedurave penale kundër 56 personave nga pushteti dhe opozita, në prill të vitit 2016, shkaktoi revolt tek publiku. Në kuadër të protestave kundër vendimit të këtillë vërehej prezencë e madhe e nëpunësve policorë me pajisje të plotë dhe shpërndarjen e tyre në kordon policor të cilët e pengonin të drejtën e lëvizjes së lirë të qytetarëve të cilët protestonin. Edhe përkrah ambientit të qetë gjatë kohës së protestave, nga ana e MPB u vërejtën praktika tendencioze, siç është regjistrimi i paautorizuar i qytetarëve të cilët protestonin, thirrje në biseda informative të një numri të madh të demonstruesve dhe aktivistëve për të drejtat e njeriut për shkak të “pjesëmarrjes në protesta” dhe praktika të ngjashme të cilat ishte më se evidente se kishin për qëllim t'i frikësojnë pjesëmarrësit e protestave, duke e pasur parasysh se e drejta e tubimit publik është e drejtë e garantuar në nenin 21 të Kushtetutës dhe është rregulluar me ligjin e veçantë për tubime publike. Në këtë drejtim, si dhe në protestat që pasuan pas revokimit të amnistisë nga ana e Presidentit, në qershor të vitit 2016, nëpunësit policorë filluan t'i legjitimojnë dhe ndalojnë demonstruesit pas përfundimit të protestave,¹⁹⁹ e që rezultoi edhe me paraqitjen e kallëzimeve penale ose akuzave për demonstruesit.

Zbatimi i forcës joproporcionale dhe pengimi i tubimit publik, u vërejt edhe në protestat e studentëve para selisë së Parlamentit Studentorë të Universitetit “Shën Cirili e Metodi”, fill pas votimit të kryetarit të ri të PSUCM, me çka ishin kryer dy vepra penale: “Pengim i tubimit publik” (neni 155 paragrafi 2 të KP) dhe “Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës” (neni 143 të KP). Për këtë rast, Komiteti i Helsinkit paraqiti kallëzim penal në Prokurorinë Themelore Publike kundër personave udhëheqës të MPB,²⁰⁰ megjithatë Prokuroria Publike akoma nuk ka vepruar.

Edhe pas ndërrimit të pushtetit u vërejtën disa raste të izoluara të veprimit jopërkatës policor, në aspektin e pengimit të kundërligjshëm dhe të njëanshëm të së drejtës së tubimit të lirë dhe shprehjes së protestës, me çka u pengua edhe e drejta e lirisë dhe sigurisë. I këtillë ishte rasti i ndalimit të një grupi të vogël aktivistësh të “Levica” të cilët në korrik të vitit 2017, mbajtën protestë në sheshin e Shkupit gjatë kohës së prezantimit të pajisjes ushtarake të ushtrisë së SHBA dhe ARM. Përmes pengimit të së drejtës së protestës së qetë, si dhe ndalimit të kundërligjshëm përmes zbatimit të

199 Ndalohen aktivistët Pavle Bogoevski dhe Simona Spirovska, i aksesshëm në: <http://novatv.mk/privedeni-aktivistite-pavle-bogoevski-i-simona-spirovska/>

200 Komiteti i Helsinkit paraqiti kallëzime penale kundër policëve të cilët rrahën studentë, <http://24vesti.mk/helsinshki-komitet-podnese-krivichni-prijavi-policajcite-koi-tepaa-studenti>

mjeteve për lidhje (Pranga) nga ana e nëpunësve të autorizuar policorë, në rastin konkret u bë shkelje flagrante e Kushtetutës, Ligjit për tubime publike, Ligjit për polici, Rregullores për kryerjen e punëve policore dhe të standardeve relevante ndërkombëtare.²⁰¹ Me këtë procedurë, policia në mënyrë të hapur veprimi në dëm të qytetarëve, ndërsa pastaj kontribuoi për rritjen e tendencës së mosbesimit të qytetarëve.²⁰²

Nga ana tjetër, u shfaqën edhe sfida serioze në funksionimin e organizatave qytetare. Lëvizja Qytetare “Stop - operacionit Soros” e formuar në janar të vitit 2017 ishte fokusuar kundër organizatave joqeveritare të financuara nga Fondacioni Shoqëria e Hapur Maqedoni. Me këtë u bë një atak i drejtpërdrejtë mbi kredibilitetin dhe reputacionin e organizatave qytetare dhe mbrojtësve të lirisë të njeriut. Njëkohësisht, procedurat gjyqësore kundër aktivistëve qytetarë, pjesëtarë të Revolucionit të Laramantë, të akuzuar për pjesëmarrje në turmë, e cila do ta kryej veprën penale nga neni 385 të Kodit Penal, akoma janë në rrjedhë e sipër madje deri në momentin e hartimit të këtij Raporti.

Me vendim të GJEDNJ nga 16 nëntori i vitit 2017 u konstatua shkelja e nenit 11 (liria e tubimit dhe shoqërimin) në lidhje me nenin 9 (liria e mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si pasojë e refuzimit të autoriteteve kompetente që të regjistrohet Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (KOO) si komunitet i veçantë fetar.²⁰³ GJEDNJ konstatoi se kërkesat e KOO për regjistrim janë refuzuar për shkaqe formale, por edhe për dy shkaqe të tjera: se shoqata-aplikant është formuar nga një kishë ose shtet i huaj, si dhe se emri i saj i propozuar qenka problematik, veçanërisht nga aspekti i asaj se ky emër ka qenë shumë i ngjashëm me emërtimin e “KOM-Kryepeshkopata e Ohrit”, e cila ka të drejtë historike, religjioze dhe morale në kontinuitet ta përdor këtë emër. Edhe krahas hapësirës së gjerë për vlerësimin e shtetit në këtë fushë, GJEDNJ me vendimin e saj e vuri në dukje obligimin e shtetit që të jetë neutral dhe i paanshëm në marrëdhëniet e tij me grupet e tjera religjioze dhe fetare, si dhe të mbaj llogari për ruajtjen e pluralizmit religjioz. Gjykata e Strasburgut në mënyrë eksplicite e dënoi marrjen e masave preventive kundër lirisë së shoqërimi në një shoqëri demokratike.²⁰⁴

Shteti duhet ta siguroj respektimin e të drejtës së tubimit në mënyrë që e njëjta nuk do të kufizohet as nga policia, as nga një grup tjetër i qytetarëve – kundër-protestues në rastet kur bëhet fjalë për protestë të paralajmëruar me rregull, në përputhje me Ligjin për tubime publike.

Hapja e procedurave penale kundër këtyre personave mund të konsiderohet edhe si paralajmërim për qytetarët e tjerë të cilët kanë dëshirë të marrin pjesë në protesta, e që është në kundërshtim me nenin 21 të Kushtetutës së RM-së, nen me të cilin përcaktohet se qytetarët kanë të drejtë të tubohen dhe të manifestojnë protestë publike pa paralajmërim paraprakë dhe pa leje të veçantë, ndërsa shfrytëzimi i kësaj të drejte mund të kufizohet vetëm në kushte të gjendjes së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme, e që nuk është rast në këtë situatë.

Të ndërmerren masa përkatëse disiplinore ndaj të gjithë nëpunësve policorë të cilët aplikojnë forcë joproporcionale ndaj pjesëmarrësve në protesta të qeta, si dhe ndaj urdhërdhënësve të tyre.

201 Dënohet pengimi i të drejtës së protestës, komunikatë e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, e aksesshme në: <http://mhc.org.mk/announcements/618?locale=mk#.WcNdScgjHIU>

202 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut hapi procedurë me qëllim të përcaktimit të rrethanave në këtë rast, me ç'rast rekomandoi ndër-marrjen e masave konkrete nga ana e Departamentit për kontroll të brendshëm, hetime kriminale dhe standarde profesionale për përcaktimin e përgjegjësisë së nëpunësve të involvuar policorë, të cilët pa bazë kanë aplikuar mjete të forcës. Njëkohësisht, nga strukturat kompetente të MPB-së u kërkua të ndërmerren masa dhe aktivitetet të domosdoshme dhe të veprimi në linjë e standardeve ligjore universale dhe ndërkombëtare të veprimit policor.

203 Procedura në Strasburg u iniciua me aplikimin e paraqitur nga ana e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

204 Shih: <http://www.mhc.org.mk/announcements/666?locale=mk#.WmObXkxFxPZ>. Përndryshe, aktgjykimi i GJEDNJ i miratuar në këtë rast është i aksesshëm në: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER"\],"chamber":\["CHAMBER"\],"itemid":\["001-178890"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

■ Liria e shprehjes dhe pluralizmit në media

Ambienti jodemokratik, i cili ndikon mbi pengimin e lirisë së shprehjes, u pasqyrua edhe në aktgjykimin e GJEDNJ në rastin “Selmani dhe të tjerë kundër RM”²⁰⁵ me të cilin u konstatua shkelje të nenit 10 të Konventës në kontekstin e largimit me forcë të gazetarëve nga galeria e Kuvendit më 24 dhjetor të vitit 2012, me ç’rast ata u pamundësuan që ta ndjekin seancën plenare dhe të raportojnë në mënyrë përkatëse në lidhje me ngjarjet në Kuvend.

Praktika e shkeljes së Ligjit për Media dhe Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizive vazhdoi edhe gjatë vitit 2016 dhe 2017. Gjatë vitit 2016 në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (ASHMAA) gjithsej janë paraqitur 18 parashtresa dhe propozime, ndaj të cilave Agjencia ka vepruar konform Ligjit, ndërsa numri i tyre, gjatë gjithë vitit 2017, ishte 12. Nga gjithsej 25 parashtresa dhe propozime të paraqitura, përfundimisht me datën 31 gusht të vitit 2017, 16 janë paraqitur nga persona juridikë (shoqata të qytetarëve dhe nga persona të tjerë juridikë), ndërsa 9 parashtresa janë paraqitur nga persona fizikë. Sipas raportimit të ASHMAA, vetëm gjatë vitit 2017 janë paraqitur gjithsej 5 parashtresa dhe kërkesa në bazë të diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes.

Raportimi për protestat nga Platforma “Protestoj” dhe për kundër-protestat e Shoqatës RDQM, e pasqyroj ndarjen në blloqe të mediave. Nga njëra anë ishin televizionet me orientim pro-qeveritar (radiodifuzerët më të mëdhenj nacional: Sitel, Alfa, Kanal 5, si dhe TV Nova), të cilat në lidhje me Lëvizjen “Protestoj” dhe protestat e Revolucionit të Laramantë me këmbëngulje dhe në mënyrë të sinkronizuar e përsëritnin frazën “huliganët e LSDM dhe të Soros-it”, ndërsa kundër-protestat e Lëvizjes RDQM ishin quajtur “qytetare” dhe tubime të “popullit”. Nga ana tjetër, shtëpitë televizive neutrale-kritike shumë rrallë raportojnë për tubimet e RDQM, ndërsa më shpesh për protestat e Revolucionit të Laramantë. RTVM në dy serviset e tij raportonte në mënyrë informative dhe të balancuar për të dyja lëvizjet.

Marrëveshja e katër partive politike nga 20 korriku i vitit 2016 përfshiu edhe disa dispozita të reja nga fusha e funksionimit të mediave, në mesin e të cilave edhe caktimin e redaktorit të ri të servisit publik me propozim të opozitës, i cili këtë funksion do ta marr njëqind ditë para zgjedhjeve, formimi i autoritetit ad-hok për monitorimin e raportimit mediatik nga ana e ASHMAA (Komisioni i përkohshëm për monitorimin e prezantimit mediatik). Puna me lëndë e këtij autoriteti parashikonte miratim të rekomandimeve, të cilat duhet t’i ndjek Këshilli i Agjencisë për Media, në bazë të të cilave Këshilli do t’i paralajmëroj ose dënoj mediat. Sipas marrëveshjes, katër partitë politike u obliguan që të miratojnë ndryshime të ligjeve për mediat në përputhje me Prioritetet e Reformave Urgjente dhe Raportit të Pribe në afat prej gjashtë muajsh pas zgjedhjeve. Megjithatë, këto pjesë të Marrëveshjes së Përzhinos konsiderohen si zgjidhje kontestuese, të miratuara vetëm në funksion të zgjedhjeve të cilat nuk i garantojnë pavarësi afatgjate servisit publik.²⁰⁶

Sipas propozimeve të paraqitura nga Komisioni i Përkohshëm për Monitorimin e Prezantimit Mediatik, i cili si autoritet ad-hok u formua gjatë negociatave politike në Përzhino, në korrik të vitit 2016, ASHMAA kërkoi ngritjen e procedurave për kundërvajtje me shqiptimin e paralajmërimeve dhe gjobave kundër servisit të parë programor televiziv të RTVM për shkak të transmetimit të reklamave të financuara nga Buxheti i RM: TV Sitel, TV Nova dhe TV Alfa për shkak të raportimit të pabalancuar dhe të njëanshëm dhe TV Alfa për prezantim zgjedhor mediatik të subjektit politik përmes aktiviteteve të organeve shtetërore. Agjencia konstatoi mosrespektim të dispozitave ligjore

205 SELMANI AND OTHERS v. THE REPUBLIC OF MACEDONIA (Application no. 67259/14), Aktgjykimi i datës 9 shkurt 2017, i cili është i aksesshëm në HUDOC databazë e Këshillit të Evropës.

206 Marrëveshja për mediat nuk e zgjidh problemin, artikulli i aksesshëm në: <https://www.slobodnaevropa.mk/a/27880809.html>

për reklamim të paguar politik tek TV Nova si dhe tek Alsat-M dhe tek Radio Kanali 77 SHPKNJ Shtip. Në mënyrë plotësuese në Agjenci u paraqitën propozime për veprim nga Komisioni i Përkohshëm për Monitorimin e Prezantimit Mediatik edhe atë sipas tri kërkesave për ngritjen e procedurave për kundërvajtje për shqiptimin e sanksionit për kundërvajtje – gjobë dhe pesë kërkesa për ngritjen e procedurave për kundërvajtje për shqiptimin e sanksionit për kundërvajtje - paralajmërim. Pas përfundimit formal të procesit zgjedhor Agjencia mori vendim për shpërndarjen e Komisionit të përkohshëm.

Konkluzion i përgjithshëm për imazhin mediatik në lidhje me pluralizmin politik në Maqedoni konsiston me atë se gjendja është përmirësuar pak, e që është veçanërisht evidente nga “zbutja” e dukurive negative të cilat paraprakisht ishin shumë të pranishme edhe atë arbitrarisht, raportimi propagandistik, demonizimi i subjekteve politike, inkorporimi i marketingut politik si pjesë e lajmeve.²⁰⁷ Pas përfundimit të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, imazhi mediatik mbeti i njëjtë si edhe para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, ndërsa numri më i madh i shtëpive televizive iu kthyen politikës të tyre standarde redaktuese.²⁰⁸

Gjatë vitit 2017 jashtëzakonisht shqetësuese ishte tendenca në rritje e sulmeve dhe dhunës fizike mbi gazetarët.²⁰⁹ Shumica e institucioneve të cilat punojnë në fushën e mediave, në mënyrë të ashpër i dënuan sulmet dhe kërkuan ndjekje penale të kryerësve. Kryetari Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, Naser Selmani përgjegjës për dhunën ia adresoi liderit të VMRO-DPMNE, Nikolla Gruevskit. Nga Ministria e Punëve të Brendshme u ndaluan 12 persona me dyshimin e përdorimit të dhunës mbi ekipin gazetaresk të A10N, ndërsa pastaj u paraqit edhe kallëzim penal kundër një personi. Kjo tendencë e përdorimit të dhunës mbi gazetarët është problem serioz i cili nuk guxon të neglizhohet. Gazetarëve jo vetëm që nuk u mundësohet të raportojnë papengesë për ngjarjet dhe ndodhitë aktuale, por u është rrezikuar jeta dhe siguria.

Në planin qeveritar “3-6-9”, i paralajmëruar në korrik të vitit 2017, Qeveria u obligua t’i mbroj punonjësit mediatik nga sulme të këtilla dhe pa-prolongim kryerësit t’i ballafaqoj me drejtësinë, me ç’rast do të sigurohet mbrojtje efikase të së drejtës për shprehje të lirë dhe raportim të lirë gazetaresk. Në mënyrë plotësuese, në pjesën që ka të bëjë me punën mediatike janë përfshirë edhe kërkesat për Reformat Urgjente të pesë shoqatave/organizatave dhe Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizive nga marsi i vitit 2016, e që ishte objekt i analizës dhe dhënies së rekomandimeve nga ana e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive e cila me qëndrime dhe mendime të veta u prononcua deri te Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë.

207 Instituti për studime të komunikimit, Raport nga monitorimi i lajmeve televizive të datës 5-16 shtator 2016, i aksesshëm në: <http://respublica.edu.mk/attach/MODEM/final.pdf>

208 Instituti për studime të komunikimit, Raport nga monitorimi i lajmeve televizive (periudha nga 16-27 janar të vitit 2017), i aksesshëm në: <http://respublica.edu.mk/attach/MODEM-izvestaj-januari-MK-2017.pdf>

209 Në muajin shkurt të vitit 2017, gjatë kohës së tubimit të qytetarëve “Për një Maqedoni të Përbashkët”, fizikisht u sulmua një gazetar dhe një kameraman nga mediami elektronik “A10N”, muajin tjetër pasuan një sërë sulmesh mbi më shumë gazetarë, edhe atë: gazetari i TV “24 Vesti” u sulmua fizikisht nga një demonstrues duke raportuar drejtpërdrejtë nga protesta e kësaj iniciative; ekipi i gazetarëve të televizionit “Telma” u sulmua verbalisht në përpjekje për t’i transmetuar qëndrimet e një pjesë të të pranishmëve në tubimet e iniciativës; një gazetar publikisht u përçmua dhe nënçmua gjatë kohës së drekës në një restorant. Gjatë kohës së transmetimit të sulmit të dhunshëm në Kuvend më datë 27 prill të vitit 2017, fillimisht verbalisht dhe pastaj edhe fizikisht me goditje dhe zvarritje u sulmua gazetarja e “Nova TV”, ekipi gazetaresk i së cilës u sulmua edhe në muajin gusht të vitit 2017. MPB e përcaktoi identitetin e sulmuesit, ndërsa PTHP – Shkup për këtë ngjarje formoi lëndë, me ç’rast nga ana e prokurorit të caktuar janë lëshuar urdhra dhe orientime të cilat kanë për qëllim zbardhjen e plotë të ngjarjes, pas çka pasoi vendimi meritor i Prokurorisë Publike.

Duhet të zbatohen reformat në sektorin mediatik e që konform Marrëveshjes së Përzhinos 2 ishin dakordësuar për periudhën pas formimit të Qeverisë së re. Propozimet për ndryshime urgjente të ligjeve duhet të bëhen në një proces transparent të konsultimeve me organizatat qytetare, para se të dërgohen për miratim në mbledhje të Qeverisë.

Nevojitet ndryshim urgjent i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizive, me qëllim që të ndalohet reklamimi me pagesë nga ana e shtetit, si dhe të sigurohet pavarësia dhe depolitizimi i trupit rregullator - ASHMAA.

Radiodifuzerët në mënyrë strikte t'u përbahen parimeve profesionale për ushtrimin e veprimtarisë dhe të raportojnë në mënyrë objektive dhe të paanshme duke i siguruar të gjitha pikëpamjet relevante të cilat do t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë.

Gazetarët/et duhet të kenë kujdes që as ato por as bashkëbiseduesit të mos përdorin fjalor diskriminues i cili nxit urrejtje, ofendime, shpifje ose dezinformacione.

Gazetarët t'i zbatojnë standardet themelore profesionale në rastet kur raportojnë për temat me rëndësi më të madhe shoqërore, duke raportuar në mënyrë të saktë, të balancuar dhe të ndershme dhe duke mbajtur llogari për autenticitetin, relevancën, besimin dhe kredibilitetin e teksteve të tyre.

Shoqatat e gazetarëve dhe organizatat e gazetarëve duhet t'i intensifikojnë angazhimet e tyre në mënyrë që të sigurojnë kushte që gazetarët dhe profesionistët e tjerë mediatik t'i kryejnë detyrat e tyre të punës në mënyrë profesionale dhe të çliuar nga frika dhe presionet.

Duhet të bëhet ndryshimi i Ligjit për përgjegjësi qytetare nga shpifja sa i përket definicioneve (harmonizim me nenin 10 të GJEDNJ), si dhe ndryshim të rregullave procedurale për përjashtimin e rasteve me vlerë të vogël dhe përdorimi i ndërmjetësimit.

E drejta e respektimit të jetës private dhe familjare dhe komunikimeve

Edhe pse në korrik të vitit 2015 u ndërpre plotësisht procesi i lustracionit, ai mbeti aktiv për të gjithë personat për të cilët deri atëherë janë miratuar aktvendime, e deri në përfundimin e plotfuqishëm të procedurës. Me këtë, në të vërtetë, u morën parasysh rekomandimet dhe vërejtjet e institucioneve relevante ndërkombëtare, duke e përfshirë edhe Komisionin e Venecias të cilët e vinin në pah rrezikun që procesi të shndërrohet në “gjah të shtrigave”, përkatësisht përndjekje klasike të oponentëve politikë, veçanërisht duke e pasur parasysh se i njëjti u zbatua në mënyrë me të cilën u shkelën disa nga parimet dhe garancitë themelore të gjyqimit të drejtë, me ç'rast u mohua edhe e drejta e mbrojtjes së personave të prekur.

E gjithë kjo rezultoi me një grumbull aplikime të paraqitura kundër shtetit para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga ana e personave të lustruar, të cilët kryesisht ankoheshin për shkelje të nenit 6 (e drejta e gjyqimit të drejtë), si dhe të nenit 8 (e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Defektet e konstatuara sistematike gjatë zbatimit të lustracionit u reflektuan edhe në konstatimet e GJEDNJ të cilat i përmban aktgjykimi i rastit “Karajanov kundër Republikës së Maqedonisë”.²¹⁰ Në të, në lidhje me procedurën e lustrimit të aplikantit, GJEDNJ konstaton shkelje të së drejtës së tij për procedurë të ndershme, meqë ai nuk ka pasur mundësi në mënyrë efektive ta prezantoj rastin e tij, ndërsa të dy instancat gjyqësore, të cilat kanë vepruar në kontestin administrativ të ngritur nga ai

210 KARAJANOV v. THE REPUBLIC OF MACEDONIA (App.no.2229/15), aktgjykimi i datës 6 prill 2017, i cili është i aksesshëm në HUDOC databaza e Këshillit të Evropës.

nuk e kanë realizuar kompetencën e tyre të plotë sa i përket përcaktimit të fakteve dhe zbatimit të së drejtës, përkatësisht diskutim meritore për lëndën, e as që kanë ekzistuar rrethana të jashtëzakonshme të cilat do ta arsyetonin mos-mbajtjen e diskutimit verbal në prezencë të aplikuesit në cilëndo qoftë fazë të procedurës, duke e pasur parasysh se bëhet fjalë për çështje kontestuese faktike dhe juridike të cilat nuk kanë qenë të natyrës së pastër teknike, ndërsaq përveç kësaj, vendimet administrative gjyqësore nuk kanë pasur as arsytim të mjaftueshëm.

Ajo që është akoma më e rëndësishme nga aspekti i mbrojtjes së privatësisë së aplikuesit është se GJEDNJ gjeti shkelje të nenit 8 nga Konventa për shkak të publikimit të Aktvendimit të Komisionit të Lustracionit në ueb faqen e Komisionit që në ditën e miratimit të tij, përkatësisht para se ai të bëhet përfundimtar dhe i plotfuqishëm. Gjatë vendimmarrjes së tij GJEDNJ veçanërisht e ka marrë parasysh atë se justifikimi i atillë nuk i ka shërbyer asnjërit nga qëllimet legjitime për mbrojtjen e sigurisë nacionale, sigurisë publike, mirëqenies ekonomike të vendit dhe të drejtat dhe liritë e të tjerëve, si dhe mosha 77 vjeçare e aplikantit, fakti që ai nuk ka qenë bartës e as kandidat për funksion publik, qëndrimi i Komisionit të Venecias pranë Këshillit të Evropës nga 17 dhjetori i vitit 2012 për atë se dispozita ligjore për publikimin e emrave të personave të lustruar, para plotfuqishmërisë së aktvendimeve për lustrim, është në kundërshtim me nenin 8 të Konventës dhe mund të ketë pasoja të dëmshme ndaj reputacionit të personit të cilat nuk mund të evitohen me korrigjim të mëvonshëm, si dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë U.nr.42/2008 nga 24 marsi i vitit 2010.

Edhe pse i miratuar, megjithatë në praktikë mungon zbatimi i Ligjit për mbrojtjen e privatësisë i cili u miratua në periudhën paraprake të raportimit, me qëllim që të parandalohet dhe ndalohet çfarëdo qoftë publikimi publik të materialeve të përgjuara në mënyrë jolegale, të krijuara në periudhën kohore nga viti 2008 deri në vitin 2015, përveç atyre të cilat tanimë janë publikuar nga ana e partisë së atëhershme opozitare LSDM. Duke e pasur parasysh se ky Ligj u miratua në mënyrë skajshëm jotransparente, pa debat publik përkatës me të cilin u parashikuan dënime Venecias për domosdoshmërinë e “revidimit të tij të thellë”. Në këtë drejtim, pjesa më e madhe e sektorit civil angazhohet për revokimin e tij të plotë, përkatësisht anulimin e tij.

Në bazë të pikëpamjeve dhe konstatimeve të organizatave qytetare edhe më tutje janë të mundshme abuzime në sistemin e ndjekjes së komunikimeve, duke e pasur parasysh bazën ligjore, e cila lejon ndjekje të komunikimeve për një spektër mjaft të gjerë të veprave penale, pa vlerësim adekuat nëse cënimi i privatësisë është proporcional me rëndësinë e veprës penale për të cilën bëhet fjalë dhe provave të cilat pritet të grumbullohen me masat e veçanta hetimore, përkatësisht me ndjekjen e komunikimeve. Së këtëjmi, propozohet që zbatimi i masës së këtillë të lejohet vetëm për vepra penale për të cilat parashikohet dënim minimal me burgim prej katër ose më shumë vjet.²¹¹

Në nëntor të vitit 2017, MPB e publikoi Propozimin-ligjin e ri për ndjekjen e komunikimeve, për të cilin u theksua se me miratimin e tij do të kryhet realizimi i rekomandimeve të Pribe, ligj i cili duhet të fillojë të zbatohet më së voni deri më 1 nëntor të vitit 2018. Me këtë propozim-ligj rregullohen procedurat e zbatimit të masës së veçantë hetimore “ndjekje dhe regjistrim të komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike”; kushtet dhe procedura e zbatimit të masave për ndjekjen e komunikimeve për shkak të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit; obligimet e operatorëve dhe të Agjencisë Operative Teknike (AOT), e cila është parashikuar të formohet jashtë strukturave të MPB, si shërbim i cili nga aspekti teknik duhet ta mbështes procesin e ndjekjes së ko-

211 Studim për politikë publike “Drejt Panoptikumit qytetar: Baraspeshë më e mirë midis mbrojtjes së privatësisë dhe nevojës për ndjekjen e komunikimeve”, i përgatitur nga ana e “Aksionit të Grave” dhe i publikuar në vitin 2017 në kuadër të projektit “Rrjeti 23+”. I njëjti është i aksesshëm në: http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Kon-gragjanski-panoptikon-ramnoteza-pomegju-sledenjena-komunikacite-i-privatnosta_MK.pdf

munikimeve, si dhe monitorimin dhe kontrollin mbi zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve. Ajo që mbetet problematike është mënyra se si do të vendoset mekanizmi qytetar për monitorimin e punës së AOT, si dhe mosekzistimi i garancive përkatëse se AOT nuk do të instrumentalizohet në dëm të privatësisë së qytetarëve. Nga ana tjetër, me sa duket as me zgjidhjet e reja ligjore nuk është avancuar kontrolli i Kuvendit mbi AOT. Përveç kësaj, veçanërisht shqetëson mundësia që përmes masave, për ndjekjen e komunikimeve për shkak të mbrojtjes dhe sigurisë që rregullohet me ligj, të kemi shkelje masive të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Sistemi i ri i ndjekjes së komunikimeve përmes AOT duhet të ofroj garanci të mjaftueshme kundër shfrytëzimit të saj arbitrar në dëm të privatësisë së qytetarëve, ndërsa në këtë drejtim duhet të mundësohet një rol më i fuqishëm të organizatave qytetare dhe Kuvendit në kontrollin efikas mbi funksionimin e AOT.

Zbatimi i ndjekjes së komunikimeve, si masë e veçantë hetimore, duhet të kufizohet në një kategori të caktuar të veprave penale (për shembull, vetëm për ato vepra për të cilat është parashikuar dënim minimal me burgim prej katër ose më shumë vjetësh).

Nevojitet të përcaktohen në mënyrë më restriktive kushtet në të cilat lejohet ndjekja e komunikimeve në bazë të urdhrit gojor, konform zgjidhjes së vjetër ligjore nga Ligji për ndjekjen e komunikimeve.

Duhet të kufizohet kohëzgjatja e ndjekjes së komunikimeve, përmes rishikimit të afateve të përcaktuara të gjata maksimale për ndjekjen e komunikimeve dhe të përcaktohet obligimi për organin që do ta zbatoj ndjekjen që ta ndërpres masën kur do të arrihen qëllimet për shkak të të cilave janë përcaktuar masat e veçanta hetimore. Njëkohësisht, të përcaktohet obligimi që personat e prekur të njoftohen për masat e veçanta të ndërmarra hetimore ndaj tyre pas ndërprerjes së tyre.

Nevojitet të pamundësohet qasja e drejtpërdrejtë deri te përmbajtja e komunikimeve nga ana e shërbimeve, përkatësisht organet kompetente të kenë obligim paraprakisht ti njoftojnë operatorët dhe të dërgojnë urdhër gjyqësor për ndjekje para se operatori ta mundësoj qasjen deri te komunikimet të personave të përfshirë. Në këtë kuptim, është me rëndësi të mbahet evidencë për personat e punësuar tek operatori, të cilët u janë qasur të dhënave dhe përmbajtjes së komunikimeve dhe për të punësuarit të cilët e kanë të drejtën e qasjes, me çka do të mundësohet ndëshkimi i tyre në rast të qasjes së paautorizuar deri te të dhënat.

Është e domosdoshme të përforcohet kontrolli i brendshëm i MPB në mënyrë që ai të bëjë kontroll edhe mbi rastet në të cilat është keqpërdorur autorizimi për ndjekjen e komunikimeve.

Garanci mbrojtëse procedurale

■ E drejta e lirisë dhe sigurisë

Sa i përket privimit nga liria dhe kufizimit të të drejtës së lirisë dhe sigurisë, periudha raportuese u karakterizua me dy praktika të ndryshme të veprimit, edhe atë: 1) numri i madh i propozimeve të refuzuara për shqiptimin e masës paraburgim nga ana e Gjykatës Themelore Shkup 1 që kanë të bëjnë me funksionarë të dyshuar për vepra penale të cilat rezultuan nga materialet e përgjuara, për të cilat veproi PSP, përkundrajt 2) përgjegjësishë së manifestuar për shqiptimin e paraburgimit ndaj një numri më të madh të personave të dyshuar për vepra të kryera në lidhje me ngjarjet në Kuvend nga 27 prilli i vitit 2017.

Refuzimi, përkatësisht të qenit i përmbajtur që të përcaktohet masa paraburgim nga ana e Gjykatës penale në Shkup ishte precedent, meqë në disa vitet e kaluara pikërisht kjo Gjykatë, në asnjë rast, ndaj krimit të organizuar nuk e ka refuzuar masën paraburgim të propozuar nga PPNKOK.²¹² Kjo e përforcoi konstatimin për qasje selektive dhe standarde të dyfishta gjatë veprimit varësisht nga kategoria e qytetarëve të cilës i përkasin personat e dyshuar. Praktika jokonsistente e gjykatave dhe pavendosmëria e tyre të caktojnë paraburgim në raste që kanë të bëjnë me politikanë ose persona të afërt me establishmentin politik e vë në dukje pushtetin e kapur gjyqësor dhe në mënyrë drastike rrezikohet parimi i sundimit të së drejtës në vend.

Një precedent tjetër i paparë juridik deri më tani, në historikun e jurisprudencës maqedonase janë aktvendimet e Këshillit të Gjykatës Supreme me të cilat u refuzuan ankesat e mbrojtësve të Goran Grujovskit dhe Nikolla Boshkovskit, të dyshuar për shkatërrimin e paligjshëm të pajisjes në DSK, me të cilat konfirmuan aktvendimet e Apelit për paraburgim, por pasi që u mundësua veprimi i prolonguar (suspensiv) të ankesës, kështu që u mundësua edhe arratisja e personave.

Kjo praktikë gradualisht filloi të ndryshohet në favor të përcaktimit të paraburgimit gjatë tre mujorit të fundit të vitit 2017, kur u përcaktua paraburgim të pandehurit Edmond Temelko, i dyshuar për një sërë parregullsi zgjedhore në lidhje me zgjedhjet lokale të vitit 2013. Njëkohësisht, me kritika disa mujore për zvarritjen e procedurës para-hetimore, e cila zhvillohej në PPNKOK për përcaktimin e fakteve në lidhje me ngjarjet në Kuvend, nga 27 prilli i vitit 2017, më datë 28 nëntor të vitit 2017 u arrestuan gjithsej 36 persona, në mesin e të cilëve edhe një numër i caktuar i deputetëve, me ç'rast për të gjithë këta u përcaktua masa paraburgim me përjashtim të gjashtë personave të cilëve Gjykata Themelore Shkup 1 ua përcaktoi masën arrest shtëpiak.²¹³ Në ndërkohë, Komisioni për Çështje të Rregullores, Mandatit dhe Imunitetit mbajti mbledhje në të cilën unanimisht u vendos për heqjen e imunitetit të deputetëve të përfshirë me masën e paraburgimit.²¹⁴

Duke vepruar sipas parashtrës së parashtruar nga Grupi parlamentar i VMRO-DPMNE dhe Koalicionit "Për një Maqedoni më të mirë", Avokati i Popullit konstatoi se gjatë ndalimit të tre deputetëve është shkelur e drejta e imunitetit të deputetit dhe prezumimi i pafajësisë për shkak të mosrespektimit të nenit 19 të Rregullores për kryerjen e punëve policore nga ana e policisë, e cila parashikon se nëse personi i cili ndalohet thirret në statusin imunitet, nëpunësit policorë pas verifikimit të autenticitetit të statusit të këtyre do ta ndërpres ndalimin dhe për këtë menjëherë do ta njoftoj nëpunësin udhëheqës të drejtpërdrejtë policor. Avokati i Popullit informoi se i është dërguar rekomandim Ministrit të Punëve të Brendshme për shqyrtimin e veprimit të nëpunësve policorë në rastin konkret.²¹⁵

212 Raporte vjetore për punën e prokurorive publike në Republikën e Maqedonisë për vitet 2012, 2013 dhe 2014, të publikuara në ueb faqen e PPRM http://jorm.gov.mk/?page_id=31.

213 Plotësimi i Komunikatës për publikun, e aksesshme në: <https://goo.gl/59uMKm>

214 Shihni linqet në vazhdim: <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=2f6ebb9c-af48-459f-8489-265b77153355> dhe http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04802/mk/Mreza-23-mesecen-pregjed-noemvri-2017_MKD.pdf

215 Ombudsmani ka konstatuar shkelje të imunitetit të deputetëve të burgosur, artikull i aksesshëm në: <https://www.slobodnaevropa.mk/a/28943871.html>

Është e domosdoshme të ndryshohet praktika e Prokurorisë Publike dhe gjyqësore në lidhje me paraburgimin në drejtim të zbatimit konsekuent të Ligjit për procedurë penale dhe të standardeve të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Njëkohësisht mbrojtja e të drejtës së lirës dhe sigurisë në mënyrë të barabartë dhe joselektive, në raport me të gjithë qytetarët e shtetit, e imponon adresimin e përgjegjësive konkrete individuale të gjyqtarëve të caktuar dhe prokurorëve publikë të cilët kanë pasur qëndrim arbitrar dhe e kanë abuzuar Ligjin gjatë (mos) zbatimit dhe (mos) shqiptimit të masës paraburgim.

Masa kundër racizmit dhe ksenofobisë dhe gjuhës së urrejtjes

Në periudhën kohore nga 1 janari deri më 31 dhjetor të vitit 2016, Komiteti i Helsinkit regjistroi gjithsej 70 vepra të kryera nga urrejtja dhe po aq incidente ishin konstatuar edhe gjatë vitit 2017.²¹⁶ Nëse bëjmë një krahasim me incidentet e regjistruara në vitin 2015 dhe 2016, atëherë dallimi më i madh në vitin 2017 ka të bëjë me përkatësinë politike si motiv për vepra të kryera nga urrejtja. Për fat të keq, shqetëson numri i incidenteve të kryera për shkak të përkatësisë etnike maqedonase ose shqiptare të kryerësit/viktimës. Në vitin 2013, këto incidente ishin në nivel prej 84% nga numri i përgjithshëm i incidenteve, në vitin 2014 përqindja ishte 61%, në vitin 2015 kjo tendencë shënoi reduktim në 34%, gjatë vitit 2016 ka pasur thuaja se 50% incidente të këtilla, ndërsa në vitin 2017, 43 % nga të gjitha incidentet e regjistruara të cilat kanë ndodhur midis maqedonasve etnikë dhe shqiptarëve etnikë.

Edhe krahas përdorimit evident të gjuhës së urrejtjes në jetën publike dhe në përditshmëri, numri i rasteve të denoncuara për përdorimin e gjuhës së këtillë mbetet relativisht i vogël. Mos-denoncimi i rasteve është pasojë e mos-detektimit të gjuhës së urrejtjes dhe elementëve të saj kryesor, si dhe mosnjohja e qytetarëve sa u përket kompetencave të institucioneve dhe obligimeve për veprim në rastet e gjuhës së urrejtjes. Numri i vogël i rasteve të akuzave të ngritura për gjuhën e urrejtjes nga ana e Prokurorisë Publike dhe thuaja se numri inekzistent i personave të dënuar dhe të gjobitur, të cilët e kanë përdorur gjuhën e urrejtjes, është shkak për mos-denoncimin e rasteve të këtilla nga ana e qytetarëve.

Gjatë vitit 2016 dhe 2017 u shënuan më shumë raste të gjuhës së urrejtjes të cilat si pasojë e drejtpërdrejtë u shndërruan në vepra nga urrejtja. Veçanërisht shqetëson fakti se gjuha e urrejtjes vjen nga funksionarë të lartë, nga persona publikë dhe nga udhëheqësit e institucioneve dhe se e njëjta nuk sanksionohet. Kështu që, në protestën para KSHZ nga 15 dhjetori i vitit 2016, përderisa Komisioni i shqyrtonte dhe diskutonte për kundërshtimet e paraqitura nga ana e partive politike për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, para selisë së Komisionit u organizua protestë në të cilën morën pjesë simpatizantë, anëtarë dhe funksionarë të VMRO-DPMNE dhe Koalicionit, fjalimet e të cilëve përmbanin elemente të veprave penale Nxitje të urrejtjes, përçarje ose mostolerancë në bazë nacionale, racore, fetare apo tjetër baze diskriminuese dhe Rrezikim të sigurisë ndaj më shumë personave, të ndëshkueshme sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë.²¹⁷

216 Incidentet e verifikuara dhe të paverifikuara, janë të aksesshme në portalin: <http://www.zlostorstvaodomraza.mk/>.

217 Drejtoresha e Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze, duke iu drejtuar të pranishmëve në protestë drejtoi kërcënim ndaj opozitës dhe KSHZ-së të jetë e kujdesshme gjatë vendimmarrjes për kundërshtimet dhe të mos u shkoj mendja të marrin vendim për suspendimin e vullnetit të popullit, sepse në të kundërtën do të ndodh "Nata e thikave të gjata", duke aluduar në masakrën e oponentëve politikë e cila ndodhi në Gjermani në vitin 1934. Deputeti Amdi Bajram, në fjalimin e tij i dërgoi mesazh kërcënues liderit të LSDM, duke bërë thirrje për vdekjen e tij. Gjatë gjithë kohës së protestës para KSHZ brohoritej "shqiptarë të mallkuar", ndërsa drejtori i Arkivit Shtetëror e drejtoi kërcënimin ndaj njëri nga ambasadorët në vend.

MPB dhe Prokuroria Publike të ndërmarrin masa urgjente dhe të paprolongueshme për ndjekjen e gjuhës së urrejtjes, meqë pandëshkueshmëria e përhapjes dhe promovimit të gjuhës së urrejtjes në hapësirën publike nënkupton tolerancë dhe arsyetim të gjuhës së urrejtjes.

Personat publikë dhe përfaqësuesit e lartë politikë duhet të përmbahen nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe ta dënojnë përdorimin e saj. Detyrimisht duhet të respektohen standardet etike dhe profesionale në gazetari, që do ta pamundësojë përdorimin e gjuhës së urrejtjes në hapësirën mediatike.

Të merret në konsideratë përvoja e vendeve anëtare të BE-së për zgjerim në kuadër të legjislacionit të tyre penal, sa i përket përfshirjes së veprave penale për krime nga urrejtja dhe përfshirje të motiveve të tjera të njëanshmërisë në këto vepra.

Të ndërmerren masa përkatëse që të lehtësohet denoncimi i krimeve nga urrejtja nga ana e viktimeve dhe sa më shumë që është e mundur të fuqizohen shoqatat për mbështetjen e tyre, përfshirë këtu edhe masa për ndërtimin e besimit tek policia dhe tek institucionet e tjera shtetërore.

Krimi nga urrejtja

Rritja e numrit të incidenteve nga urrejtja, të kryera për shkak të përkatësisë politike ose bindjes politike të kryerësve/ viktimeve, veçanërisht vërehet para dhe gjatë cikleve zgjedhore. Rritja e incidenteve të këtilla u regjistrua para dhe gjatë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2016, ndërsa të njëjtat vazhduan edhe pas përfundimit të tyre. Gjatë rrethit të parë dhe të dytë të fushatës së zgjedhjeve lokale, në tetor të vitit 2017 përsëri u vërejt rritja e numrit të incidenteve të këtilla.²¹⁸

Incidenti i parë, për shkak të përkatësisë politike ose bindjes politike, u krye në ditën e fillimit të fushatës parazgjedhore në shtator të vitit 2017 dhe ai, si edhe shumica e incidenteve të tjera të regjistruara, përfshiu demolim të shtabit partiak. Deri në fund të tetorit, dëmtimi i shtabeve partiake vazhdoi për çdo ditë, me ç'rast u dëmtuan shtabet partiake të më shumë partive politike, ndërsa gjatë fushatës zgjedhore u shënuan edhe incidente të cilat përfshinin dhunë fizike. Kështu që gjatë sulmit fizik u lëndua kandidati për kryetar të Komunës së Shuto Orizarës, ndërsa në mbrëmje, më 15 tetor, në ditën e zhvillimit të rrethit të dytë të zgjedhjeve lokale u regjistrua rasti i një personi i cili me thikë iu kërcënua kandidatit për kryetar të Komunës së Karposhit, si dhe qytetarëve të tubuar para shtabit partiak. Në Sveti Nikollë një çift bashkëshortor u sulmua fizikisht dhe u lëndua fill pas krenimit të partisë politike LSDM në qendër të qytetit.

MPB të angazhohet në drejtim të zbulimit të kryerësve të veprave të regjistruara penale, dhe të veproj në mënyrë preventive për parandalimin e incidenteve të këtilla në të ardhmen.

Të merret në konsideratë përvoja e vendeve anëtare të BE-së për zgjerim në kuadër të legjislacionit të tyre penal, sa i përket përfshirjes së veprave penale për krime nga urrejtja dhe përfshirjes së motiveve të tjera për njëanshmëri në këto vepra.

Të sigurohet hetim në kohë dhe efikas dhe ndjekje të krimeve nga urrejtja, duke i marrë parasysh motivet e njëanshmërisë gjatë gjithë procedurës penale.

218 Gjatë muajt shtator 2017 u regjistruan tetë vepra penale nga urrejtja, nga të cilat pesë ishin për shkak të përkatësisë politike ose bindjes politike, ndërsa gjatë muajt tetor u regjistruan 18 vepra penale nga urrejtja, nga të cilat katërbëdhjetë, përkatësisht thuhet se 80 për qind e numrit të përgjithshëm të incidenteve të regjistruara në këtë muaj u kryen për shkak të përkatësisë politike ose bindjes politike.

Mbrojtja e minoriteteve dhe të drejtave kulturore

Kundërthënie të mëdha në publik shkaktoi fakti që në rend dite të Komisionit për Çështje Evropiane si dhe të Komisionit për Sistem Politik ishte caktuar propozim-ligji për përdorimin e gjuhëve me të cilin, në masë të konsiderueshme, zgjerohet përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe në vend. Krahas insisitimeve nga ana e përfaqësuesve qeveritar dhe përfaqësuesve të shumicës parlamentare se bëhet fjalë për projekt ligjor, miratimi i shpejtë i të cilit është i domosdoshëm dhe në linjën e harmonizimit me kërkesat e Bashkimit Evropian, fitohet përshtypja se iu qas një procedure me nxitim për miratimin e një ligji kaq të rëndësishëm, i cili e rregullon një materie mjaft komplekse dhe të ndjeshme.

Në vend të kësaj, me sa duket, nevojitet një debat publik gjithëpërfshirës dhe inkluziv në të cilin do të përfshihen si publiku profesionistë ashtu edhe ai akademik, por edhe përfaqësuesit e sektorit joqeveritar. Së këtejmi, miratimi i tij doemos duhet të jetë rezultat i një procesi plotësisht demokratik dhe transparent, në kuadër të të cilit do të zbatohet edhe një analizë rrënjësore të implikimeve financiare të implementimit të tij konsekuent mbi Buxhetin e RM-së. Përfundimisht, do të ishte mirë miratimi i këtij ligji të pasoj pas pranimi të opinioneve dhe rekomandimeve relevante të Komisionit të Venecias, me çka do të mundësohej inkorporimi i tyre i plotë në tekstin e ligjit dhe evitimin e kundërthënive të mëtutjeshme të cilat në vend që të na shpjen drejt avancimit të të drejtave të bashkësive do të na shpinin drejt tensioneve të mëtutjeshme dhe të panevojshme ndëretnike dhe drejt mosbesimit ndërmjet qytetarëve. Pas miratimit të këtij ligji në 11 janar të vitit 2018 dhe mosnënshkrimit të Dekret-Ligjit nga ana e Presidentit Ivanov më 17 janar të vitit 2018, i njëjti u kthye për vendimarrje në Kuvend, me ç'rast numri i paarsyeshëm i madh i amendamenteve të propozuara nga opozita përsëri e problematizuan këtë Ligj, si nga aspekti i mënyrës së miratimit ashtu edhe nga aspekti i përmbajtjes së zgjidhjeve të propozuara ligjore.

Në shtator të vitit 2016, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e njoftoi agjentin qeveritar për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë në GJEDNJ me ankesën e paraqitur nga 53 persona me origjinë etnike rome të cilët me dhunë janë shpërngulur nga Lagjja e egër "Poligon" e cila gjendet rrëzë Kalasë së Shkupit në verën e vitit 2016, me ç'rast i lanë në çadra dhe strehimore të improvizuara në periferinë e kryeqytetit.²¹⁹ Ministria për Punë dhe Politikë Sociale u angazhua që këta persona të vendosen në objekte përkatëse derisa të zgjidhet përgjithmonë çështja e tyre e banimit, megjithatë procedura është akoma në rrjedhë e sipër para GJEDNJ në pritje të epilogut përfundimtar.

Mbrojtja e të dhënave personale

Në përputhje me njoftimet me shkrim të pranuar nga Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DMDHP), ajo gjatë vitit 2016 dhe 2017 përfundimisht me 31 gusht të vitit 2017 gjithsej ka pranuar 578 parashtrësia nga qytetarët, me ç'rast ka kryer 187 mbikëqyrje inspektuese sipas iniciativës së saj, prej të cilave 55 në tetë muajt e vitit 2017 e që është reduktim drastik në krahasim me vitin 2015 kur ka realizuar madje 394 mbikëqyrje të këtilla inspektuese. Sipas të dhënave zyrtare, të cilat i ka në dispozicion, gjatë kësaj periudhe Drejtoria ka konstatuar shkelje të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në 196 raste, prej të cilave 50 brenda periudhës së vitit 2017, përfundimisht me fundin e muajit gusht të vitit 2017.

Në mënyrë plotësuese deri në fund të vitit 2017 u realizuan gjithsej 297 mbikëqyrje prej të cilave 155 të rregullta, 132 të jashtëzakonshme dhe 10 kontrole.²²⁰

219 Pasqyra e gjendjes faktike e rastit Bekir and Others v. the Republic of Macedonia, Application no. 46889/16, e cila iu dërgua për deklarim deri te Agjenti qeveritar është i aksesshëm në linkun në vijim: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"languageiso": "ENG"}, "respondent": \["MKD"\], "documentcollectionid2": \["COMMUNICATEDCASES"\], "itemid": \["001-167970"\]](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

220 Kjo e dhënë u shkëmbye nga ana përfaqësuesve të Drejtorisë, gjatë punëtorisë tematike eksperte për Raportin në hije që u mbajt më datë 7 shkurt të vitit 2017.

Nga aspekti i rëndësisë së mbrojtjes të të dhënave personale gjatë ndjekjes së komunikimeve mund të konstatohet se ekziston hapësirë për përmirësim të konsiderueshëm në këtë fushë, edhe atë si nga aspekti i përmirësimit të kornizës ligjore ashtu edhe në aspektin e pjesës së rritjes së rolit institucional të DMDHP dhe të obligimeve dhe përgjegjësisë të operatorëve të komunikimeve elektronike.²²¹

Mbetet nevoja që Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ta përforcoj rolin e saj të mbrojtësit të qytetarëve dhe në këtë drejtim në mënyrë më aktive të përfshihet në mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të qytetarëve.

Drejtoria ta përforcoj rolin e saj mbikëqyrës edhe sa u përket të dhënave nga ndjekja e komunikimeve nga organet kompetente, dhe të ngarkohet për ndjekjen e zbatimit të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave edhe në këto raste.

Nevojitet të rishqyrtohen nenet 255 dhe 263 të LPP në mënyrë që të sigurohet se të dhënat e grumbulluara nga ndjekja e komunikimeve kanë të bëjnë me dedikimin për të cilin është lëshuar urdhri dhe se janë grumbulluar të dhënat dhe të njëjtat nuk mbahen një kohë tepër të gjatë.

Në mënyrë ligjore të sigurohet siguria e të dhënave të grumbulluara nga ndjekja e komunikimeve sikur në shkatërrimin e tyre në rastet kur më nuk janë të nevojshme për qëllimin për të cilin janë grumbulluar.

Të zhvillohet praktikë e dëmshpërblimit të personave në rastet kur atyre u janë shkelur të drejtat përmes ndjekjes së komunikimeve nga ana e organeve kompetente.

Ofruesit shërbimeve elektronike të komunikimit duhet të ndërmarrin masa adekuate teknike dhe organizative me të cilat do të sigurojnë se qasje në të dhënat personale kanë vetëm personat e autorizuar, t'i mbrojnë të dhënat personale nga çdo formë e paligjshme ose e paautorizuar të përpunimit, dhe të sigurojnë zbatimin e politikës së sigurisë gjatë përpunimit të të dhënave personale.

221 Studimi për politikë publike "Drejt Panoptikumit qytetar: Baraspeshë më e mirë midis mbrojtjes së privatësisë dhe nevojës për ndjekjen e komunikimeve", i hartuar nga ana e "Aksioni i grave" dhe i publikuar në vitin 2017 në kuadër të projektit "Rrjeti 23+" i theksuar më lartë në Raportin në hije.

Bibliografia

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë 2017, Plan i për Prioritetet e Reformave Urgjente “3 - 6 – 9”, i aksesshëm në: <http://vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/Plan%203-6-9%20MKD.pdf>
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Pasqyrë faktografike e statusit të implementimit të masave të parashikuara në Planin 3-6-9, përfundimisht me datë 15.11.2017, i aksesshëm në: <https://goo.gl/KPQrWX>
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Programi për ndihmë dhe mbështetje gjatë riintegritimit të personave të kthyer në Republikën e Maqedonisë konform marrëveshjeve për riadmission, i aksesshëm në: <http://www.migrantservicecentres.org/userfile/PROGRAMA%20ZA%20POMOS%20I%20PODDRSKA%20PRI%20REINTEGRACIJA%20NA%20POVRATNICI%20VO%20REPUBLIKA%20MAKEDONIJA%20SOGLASNO%20REA.pdf>
- GREKO Komiteti pranë Këshillit të Evropës, Fourth Evaluation Round- Corruption Prevention in respect of members of Parliament, judges and prosecutors, Compliance report „the former Yugoslav Republic of Macedonia“, i aksesshëm në: https://www.ecoi.net/file_upload/1226_1478595492_grecorc4-2016-8-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-en.pdf
- Komisioni Evropian, Republika e Maqedonisë: Rekomandime nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë për probleme sistemore në fushën e sundimit të së drejtës që kanë të bëjnë me përgjimet e komunikimeve, të publikuara në pranverën e vitit 2015, i aksesshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf
- Komisioni Evropian, Prioritetet e Reformave Urgjente për Republikën e Maqedonisë (qershor të vitit 2015), i aksesshëm në: http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_urgent_reform_priorities.pdf []
- Ministria e Drejtësisë, viti 2017, Strategjia për reforma në sektorin e jurisprudencës për periudhën kohore të viteve 2017-2022, me Plan Veprim, i aksesshëm në: <http://www.pravda.gov.mk/documents/%D1%F2%F0%EO%F2%E5%E3%E8%BC%EO%20%E7%EO%20%F0%E5%F4%EE%FO%EC%EO%20%ED%EO%20%EF%FO%EO%E2%EE%F1%F3%E4%ED%E8%EE%F2%20%F1%E5%EA%F2%EE%FO%202017-2022.pdf>
- Grupi i Ekspertëve, Vlerësimi dhe rekomandime të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë për çështje sistemore lidhur me sundimin e së drejtës 2017, i aksesshëm në: <https://goo.gl/JFhEkH>
- Avokati i Popullit, Raporti vjetor për nivelin e sigurimit të respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, viti 2016, i aksesshëm në: <http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2016/GI-2016.pdf>
- Propozimi i organizatave qytetare për reforma urgjente demokratike, i aksesshëm në: http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/2375/Blueprint_2017_MK-01.pdf
- Instituti për Politikë Evropiane, 2017, Statusi i realizimit të Prioriteteve të Reformave Urgjente. Shkup: Maqedoni – BE Qendra e Resurseve (MERC), i aksesshëm në: <http://www.merc.org.mk/status-na-realizacija-na-itni-reformski-prioriteti>
- Instituti për Politikë Evropiane, Mendimi i Institutit për Politikë Evropiane në lidhje me Draft-Strategjinë për reforma të sektorit të jurisprudencës, gusht 2017, i aksesshëm në: http://www.epi.org.mk/docs/EPI_StrategjiaPravosudstvo_public.pdf
- Instituti për të Drejtat e Njeriut, Raporti numër 1 për periudhën nga muaji nëntor i vitit 2016 deri në janar të vitit 2017, i aksesshëm në: [http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04763/mk/IHR-Izvestaj-01-\(web\)-MK.pdf](http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04763/mk/IHR-Izvestaj-01-(web)-MK.pdf)

Instituti për të Drejtat e Njeriut, Shoqata Maqedonase e Juristëve dhe Rinj dhe Instituti për Politikë Evropiane, Raporti i Parë i Monitorimit “Reforma në gjyqësor – nga Pribe 1 deri në Pribe 2 dhe më pas”, i aksesshëm në: <https://goo.gl/Bqq7P6>

Instituti për të Drejtat e Njeriut, Shoqata Maqedonase e Juristëve dhe Rinj dhe Instituti për Politikë Evropiane, Raporti i monitorimit të Dytë “Reforma në gjyqësor – tetor-dhjetor 2017” <http://epi.org.mk/docs/Vtor%20monitoring%20izvestaj%20-%20itni%20reformi%20vo%20sudstvoto.pdf>

Instituti për Politikë Evropiane (EPI), “Statusi i Prioriteteve të Reformave Urgjente”, maj 2017, i aksesshëm në: http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04771/mk/Status-na-ltni-reformski-prioriteti_Maj2017_MK.pdf

Instituti për Politikë Evropiane, “Raporti i Pribe dy vjet më vonë: Qeveri e re dhe mundësi të reja për zgjidhjen e problemeve të vjetra, i aksesshëm në: http://epi.org.mk/docs/1.%20Izvestajot%20na%20Pribe%20dve%20godini%20potoa_MK.pdf

Instituti për të Drejtat e Njeriut, Raporti i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor, i aksesshëm në: [http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04763/mk/IHR-Izvestaj-01-\(web\)-MK.pdf](http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04763/mk/IHR-Izvestaj-01-(web)-MK.pdf)

Instituti për Politikë Evropiane, Raporti tematik i projektit “Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë (JuDGMenT)” MBËSHETETJA E ZAK: PËRMIRËSIMI I KORNIZËS LIGJORE PËR ZGJIDHJEN ALTERNATIVE TË KONTESTEVE DHE MUNDËSIMI I BASHKËPUNIMIT JURIDIK DHE INSTITUCIONAL ME SISTEMIN GJYQËSOR DHE SISTEMIN PËR EKZEKUTIM, i aksesshëm në: [http://epi.org.mk/docs/\(APC\)мониторинг_извештај.pdf](http://epi.org.mk/docs/(APC)мониторинг_извештај.pdf)

Instituti për Politikë Evropiane, romët në kufijtë maqedonas, dhjetor viti 2016, Studimi, i aksesshëm në: http://epi.org.mk/docs/Osnovna%20studija_Romite%20na%20makedonskite%20granici.pdf

The role of the Constitutional Court in protecting the freedom of expression in the Republic of Macedonia, i aksesshëm në: http://www.epi.org.mk/docs/TRAIN%202016_Lea.pdf

Report to the Government of “the former Yugoslav Republic of Macedonia” on the visit to “the former Yugoslav Republic of Macedonia” carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT) from 6 to 9 December 2016, CPT/Inf (2017) 30, i aksesshëm në: <https://rm.coe.int/pdf/168075d656>

MODEM (Monitorimi i demokracisë në Maqedoni), 2016, Instituti për Studime të Komunikimit, Raporti i monitorimit të lajmeve televizive nga 5-16 shtatori i vitit 2016, i aksesshëm në: <http://respublica.edu.mk/attach/MODEM/final.pdf>

MODEM (Monitorimi i demokracisë në Maqedoni), 2017, Instituti për Studime të Komunikimit, Raporti i monitorimit të lajmeve televizive (periudha 16-27 janar të vitit 2017), i aksesshëm në: <http://respublica.edu.mk/attach/MODEM-izvestaj-januari-MK-2017.pdf>

“Rrjeti 23+”. Hulumtimi i mendimit publik për Kapitullin 23, i aksesshëm në: http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/public_opinion_24_04_17/Istrazuvanje-na-javno-misljenje-poglavje-23-kratka-verzija.pdf

“Rrjeti 23+”. Koalicioni: Të gjithë për gjykim të drejtë, implementimi i standardeve ndërkombëtare për gjykim të ndershëm dhe të drejtë, maj 2017, i aksesshëm në: http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Megunarodni-standardi_fer-i-pravicno-sudenje.pdf

“Rrjeti 23+”. Shoqata e Punonjësve Financiar – SHPF, Raport për gjendjet e konstatuara, praktikat dhe rekomandimet për financim më të mirë të gjykatave në Republikën e Maqedonisë, i aksesshëm në: http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/01238/mk/Analiza_ZFR.pdf

"Rrjeti 23+". Aksioni i grave, Studimi për politikë publike "Kah qytetarët Panoptikum: Baraspeshë më e mirë midis mbrojtjes së privatësisë dhe nevojës për ndjekjen e komunikimeve, i aksesshëm në: http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Kon-gragjanski-panoptikon-ramnoteza-pomegju-sledenje-na-komunikaciite-i-privatnosta_MK.pdf

"Rrjeti 23+". Hapini dritaret "Aksesi dhe inkluziviteti i gjykatave në Maqedoni, i aksesshëm në: <http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Pristapnost-i-inkluzivnost-na-sudovite-vo-Makedonija.pdf>

"Rrjeti 23+". Multikultura, "Ndihmë juridike falas – sfida dhe zgjidhje", i aksesshëm në: <http://www.multikultura.org.mk/documents/Analiza%20Multikultura%2006.09.2017%20MK.pdf>

"Rrjeti 23+". Instituti ZIP, "Kush punëson, partia ose komuna", i aksesshëm në: <https://goo.gl/V7M-kDB>

"Rrjeti 23+". Instituti për hulumtime strategjike dhe edukim, "A do të ketë bilbilfryrës në universitete", i aksesshëm në: <http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/2017-ISIE-Policy-Study-Will-there-be-Whistleblowers-at-the-Universities.pdf>

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Raporti tremujor nr. 4 nga monitorimi i punës së KSHPK për periudhën kohore korrik-shtator të vitit 2017, i aksesshëm në: <http://www.mcms.mk/images/docs/2017/sledenje-na-dsk-kvartalen-izvestaj-br-4.pdf>

OJQ Info Qendra dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Monitorimi qytetarë i Avokatit të Popullit, "Ombudsmani – midis mandatit dhe kapaciteteve", Raporti numër 2, i aksesshëm në: http://nvoinfocentar.mk/wp-content/uploads/2017/05/Monitoring-izvestaj-Ombudsman_broj-2.pdf

Transparensi Interneshënëll Maqedoni, Sistem nacional për integritet – nota për Maqedoninë, maj 2016, i aksesshëm në: http://www.transparency.mk/images/stories/NIS_mk.pdf

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Raporti mujor për të drejtat e njeriut për muajin qershor të vitit 2016, i aksesshëm në: http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/1659/Mesecen_IZVESTAJ_za_ovekovi_prava-JUNI_2016.pdf

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Raporti mujor për të drejtat e njeriut për muajin nëntor 2017, i aksesshëm në: http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/2655/Mesecen_IZVESTAJ_za_covekovi_prava-Noemvri_2017_1.pdf

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të RM-së, 2017. RAPORT I VEÇANTË PËR VEPRA PENALE TË IDENTIFIKUARA DHE TË MUNDSHME TË KRYERA GJATË KOHËS SË DHUNËS NË KUVEND MË DATË 27 PRILL TË VITIT 2017, i aksesshëm në: http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/2282/Poseben_izvestaj_Sobranie_27_04_17.pdf

Transparensi Interneshënëll Maqedoni, Sistemi nacional për integritet – nota për Maqedonisë, maj 2016, i aksesshëm në: http://www.transparency.mk/images/stories/NIS_mk.pdf

Ueb-faqet e shfrytëzuara:

Institucione

Gjykata Kushtetuese e RM www.ustavensud.mk
 Gjykata Supreme e RM www.vsrn.mk
 Prokuroria Publike e RM www.jorm.mk
 Prokuroria Speciale Publike www.jonsk.mk
 Këshilli Gjyqësor i RM www.ssrn.mk
 Këshilli i Prokurorëve Publikë www.sjorm.gov.mk
 Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup: www.osskopje1.mk
 Gjykata Administrative Shkup www.uskopje.mk
 Shoqata e Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë <http://www.mja.org.mk/>
 Kuvendi i RM www.sobranie.mk
 Qeveria e RM www.vlada.mk
 Ministria e Drejtësisë www.pravda.gov.mk
 Avokati i Popullit i RM www.obmudsman.mk
 Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale e RM www.avmu.mk
 DISHQ – Sindikata e drejtorisë, jurisprudencës dhe shoqatave të qytetarëve <http://www.upoz.org.mk>

Platforma

MERC www.merc.mk
 Platforma për luftë kundër korrupsionit www.mcms.org.mk
 Krime kundër urrejtjes <http://www.zlostorstvaodomraza.mk/>
 HUDOK Databaza e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut <https://hudoc.echr.coe.int/>

Media

A10N <http://a10n.mk/>
 Akademik <http://www.akademik.mk>
 Telma www.telma.com.mk
 Makfaks <http://makfax.com.mk>
 24 Vesti <http://www.24vesti.mk>
 Gjyqësori <http://www.sudstvo.mk/2017/12/19/каде-е-извештајот-за-злоупотреба-на-а/>
 “360 shkallë” (Alsat-M) <http://360stepeni.mk>
 Sakam da kazham <https://sdk.mk>
 Sloboden pečat <https://www.slobodenpecat.mk>
 Nova TV <http://novatv.mk>
 Evropa e Lirë <https://www.slobodnaevropa.mk>
 Libertas <http://www.libertas.mk/>

